



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 526 Akti

Nr. 690 Vendimi  
Tiranë, më 24.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Brunilda Bekteshi** Kryesuese  
**Roland Ilia** Relator  
**Pamela Qirko** Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 20.7.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Vladimir Skënderi**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), aktualisht<sup>1</sup> Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në muajin qershor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Brunilda Bekteshi. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve e rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 29.6.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Pas kësaj date, subjekti i rivlerësimit u njoftua se afati për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave në raport me barrën e provës është data 14.7.2023. Subjekti, pasi mori njoftimin,

---

<sup>1</sup> Referuar hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10/2023, datë 2.2.2023 “Për informacionin e klasifikuar”, në datën 9.3.2023, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, bazuar në nenin 63 të këtij ligji emërtimi i DSIK-së ka ndryshuar në Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

shfrytëzoi të drejtën e tij për të marrë kopje elektronike dhe fizike të dosjes dhe në datën 11.7.2023 subjekti iu drejtua me kërkesë<sup>2</sup> Komisionit, ku kërkoj: *“Pezullimin e procedurës administrative të Vetting-ut, deri në përfundimin e shqyrtimit në Gjykatën e Lartë të rekursit të paraqitur për çështjen civile me palë paditëse Dh. B. dhe të paditur K.M.SH”*. Trupi gjykues i Komisionit, pasi mori kohën e duhur në lidhje me shqyrtimin e kësaj kërkesë, vendosi<sup>3</sup> ta refuzojë atë si të pabazuar në ligj.

**8.** Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare nëpërmjet shërbimit postar pranë Komisionit në datën 18.7.2023. Po në këtë datë, subjekti, krahas shpjegimeve të tij përfundimtare në lidhje me rezultatet e hetimit, ka adresuar<sup>4</sup> pranë trupit gjykues edhe disa kërkesa<sup>5</sup> me natyrë procedurale, për të cilat Komisioni ka marrë vendim<sup>6</sup>, ku ka vendosur refuzimin e këtyre kërkesave si të pabazuara në ligj.

**9.** Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Vladimir Skënderi në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, nëpërmjet njoftimit të bërë në rrugë elektronike.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**10.** Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, në datën 20.7.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

**11.** Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, së bashku edhe me përfaqësuesen e tij kërkoj nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**12.** Subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**13.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*. Ky proces kryhet me

<sup>2</sup> Shihni kërkesën e subjektit me nr. \*\*\*prot., datë 11.7.2023.

<sup>3</sup> Shihni vendimin nr. 3, datë 12.7.2023, të trupit gjykues të Komisionit.

<sup>4</sup> Shihni shpjegimet e subjektit me nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2023, të paraqitura pranë Komisionit.

<sup>5</sup> Shihni kërkesat e cituara të subjektit, të paraqitura në Komision, së bashku me shpjegimet e tij përfundimtare mbi rezultatet e hetimit.

<sup>6</sup> Shihni vendimin nr. 4, datë 18.7.2023, të trupit gjykues në prani të vëzhguesit ndërkombëtar.

qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**14.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**14.1** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**14.2** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**14.3** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**15.** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>7</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**16.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike vjetore të dorëzuara ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituara nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

---

<sup>7</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**17.** Bazuar në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja përfundoi kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë dhe, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive;*
- *ka mosdeklarime të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**18.** Z. Vladimir Skënderi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave privatë: para fillimit të detyrës 2003; periodike/vjetore 2003 – 2017; deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

**18.1** Për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, ILDKPKI-ja ka krahasuar deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar, jobankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**19.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore dhe dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

**20.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2003 – 2017, në raport me të dhënat në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*;

- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruar nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

**Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar pasuritë, si vijojnë:**

### **1. Truall dhe ndërtim në K**

**1.1** Në deklaratën *Vetting* lidhur me këtë pasuri subjekti ka deklaruar: “*Pasuri nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truall me sip. 600 m<sup>2</sup>, në K, mbi të cilin, ndërtim për banim me sip. 103.9 m<sup>2</sup>, për aktivitet 79.4 m<sup>2</sup>, kryer në vitet 1996 – 2000.*

*Pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truall me sip. 600 m<sup>2</sup>, në K, mbi të cilin, ndërtim për banim me sip. 103.9 m<sup>2</sup>, për aktivitet me sip. 79.4 m<sup>2</sup>, kryer në vitet 1996 – 2000 me kursimet nga paga etj., të ardhura realizuar nga unë e bashkëshortja në vitet 1983 – 2000. Ndërtimi i kryer nga ne bashkëshortët me ndihmën e vëllezërve e të afërmve, kurse trualli me sip. 600 m<sup>2</sup>, dhuruar nga babai M.S me kontratë noteriale nr. \*\*\*, datë 7.1.2007, vlerësuar 1.159 m<sup>2</sup> = 210,000 lekë. Vlera e ndërtimit llogaritur me raport vlerësimi datë 24.1.2017 (trualli me sip. 600 m<sup>2</sup> = 108.714 lekë; banesa me sip. 103.9 m<sup>2</sup> = 5,287,415 lekë; godina me sip. 79.4 m<sup>2</sup> = 2,893,980 lekë)”.*

**1.2 Burimi i krijimit:** kursimet nga paga, si dhe të ardhura të realizuara nga subjekti dhe bashkëshortja në vitet 1983 – 2000.

**1.3** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se ky ndërtim është kryer prej tij dhe bashkëshortes me ndihmën e vëllezërve e të afërmve. Trualli me sip. 600 m<sup>2</sup>, dhuruar nga babai M.S me kontratën e datës 7.1.2007 (vlerësuar 1159 m<sup>2</sup> = 210,000 lekë). Vlera e ndërtimit, llogaritur me raport vlerësimi datë 24.1.2017, kurse vlerësimi i truallit nga noterja datë 7.1.2007.

- *trualli me sip. 600 m<sup>2</sup> = 108,714 lekë;*
- *banesa me sip. 103.9 m<sup>2</sup> = 5,287,415 lekë;*
- *godina me sip. 79.4 m<sup>2</sup> = 2,893,980 lekë.*

**1.4** Subjekti i rivlerësimit, për të provuar deklaratimet e tij, i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë disa dokumente<sup>8</sup>.

**1.5** ILDKPKI-ja, në raportin e saj për këtë pasuri, ka konstatuar:

- *Mosdeklarim i sipërfaqes reale të ndërtimeve në K; deklaruar sipërfaqe për banim me sip. 103.9 m<sup>2</sup> dhe për aktivitet me sip. 79.4 m<sup>2</sup>, sipas lejes së legalizimit rezulton në total për banim*

<sup>8</sup> Shihni dokumentet bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 7.10.2013, për truall me sip. 600 m<sup>2</sup>, nga i cili ndërtesë me sip. 103.9 m<sup>2</sup> + 79.4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, K, Tiranë, në pronësi të z. Vladimir Skënderi; kartelë pasurie për truall me sip. 600 m<sup>2</sup>, me përshkrimin “Leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 25.7.2013 për godinë banimi 2 kate + papafingo, godinë shërbimi 2 kate + 1 kat nëntokë, me sipërfaqe parcele 600 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 103.9 m<sup>2</sup> + 79.4 m<sup>2</sup>”; hartë treguese e regjistrimit; raport vlerësimi i datës 24.1.2017 nga eksperti vlerësues B.O për pronë të z. Vladimir Skënderi: truall dhe ndërtesë me sipërfaqe trualli 600 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 103.9 m<sup>2</sup> dhe 79.4 m<sup>2</sup>, si dhe tokë arë me sip. 559 m<sup>2</sup>, në K, Tiranë, ndodhur në z. k. \*\*\*, përkatësisht me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, dhe nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*.

360.4 m<sup>2</sup> dhe për aktivitet 238.2 m<sup>2</sup>, pasi godinat janë përkatësisht 2 kate + papafingo dhe 2 kate + 1 kat nëntokë.

- Mosdeklarim i shumës reale të investuar për ndërtimet në K, pasi subjekti ka deklaruar bazuar në aktin e vlerësimit të një eksperti vlerësues pronash, në total rreth 8,200,000 lekë. Shuma e deklaruar ndër vite për ndërtimin në K është rreth 5,600,000 lekë, shumë e deklaruar pjesë-pjesë, sipas investimeve të kryera vit pas viti, deri në vitin 2006, megjithëse në Vetting deklarohet se ndërtimi është kryer gjatë periudhës 1996 – 2000.

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me vlerën e investuar realisht në ndërtimin në K, si dhe burimin financiar të saj. Nga fotot e aktit të ekspertimit të vlerësuesit të pronave, gjykohet që vlera e investuar të jetë më e madhe nga sa është vlerësuar dhe/ose subjekti ka investuar në vazhdimësi për objektet.

- Mospërputhje të deklaramëve të subjektit sa i përket truallit të përdorur për ndërtimin e banesës, pasi referuar deklaramit “Për herë të parë 2003” ka deklaruar se ka blerë tokë bujqësore me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, në vlerën 160,000 lekë, me kursime, ndërsa sipas deklaratës Vetting rezulton se e ka përfituar nëpërmjet dhurimit nga babai i tij.

- Nuk është i qartë burimi financiar i babait për blerjen e sipërfaqes prej 7.000 m<sup>2</sup> në K me çmim 1,155,000 lekë në vitin 1996.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**1.6** Rezultoi se këto pasuri janë deklaruar për herë të parë nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, me përshkrimin: “Tokë bujqësore 1000 m<sup>2</sup>, vlera 0,16 milion lekë, K, Tiranë, me burim kursimet në vite, e paregjistruar; shtëpi banimi e ndërtuar mbi tokën bujqësore 100 m<sup>2</sup>, 3 milionë lekë, K, Tiranë, e paregjistruar, ndërtuar në vitet 1997 – 1999 me të ardhurat e realizuara në vite dhe lavazh për larje makinash pranë shtëpisë 0,12 milion lekë, K, Tiranë, ndërtuar në vitin 1998, nga puna”.

**1.7** Në vitet pasuese, subjekti ka deklaruar ndryshimet edhe transformimet e ndodhura të pasurisë si rezultat i investimeve të vazhdueshme. Kështu, në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar se ka ndërtuar me blloqe një ahur të mbuluar me llamarinë, me vlerë 200,000 lekë dhe një garazh automjeti, i cili i ka kushtuar 300,000 lekë. Në DPV-në e vitit 2005 deklaroi se ka ndërtuar dy dhoma në banesën ekzistuese, me vlerë 500,000 lekë. Në DPV-në e vitit 2006 deklaroi se një dhomë të madhe e ka ndarë me bylme në dy të vogla, 50,000 lekë vlera e bylmes dhe mbi garazhin deklaroi se ka ndërtuar me para borxh një lokal, me vlerë 10,000 euro, hua pa interes e pa afat kthimi, nga kunati i tij P. K., i cili nuk ka përfunduar. Në DPV-në e vitit 2009 deklaroi se është pajisur me certifikatë pronësie për tokën në K.

**1.8** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se pas marrjes së detyrës si gjyqtar ka ndërtuar katin e dytë dhe papafingon e banesës njëkatëshe që kishte në K dhe gjithë shtëpia (dy kate + papafingo) i ka kushtuar rreth 6 milionë lekë. Kati i parë është ndërtuar që në vitin 1998 (para emërimit si gjyqtar), ndërsa kati i dytë dhe papafingoja janë ndërtuar në periudhën 2000 – 2005 (pas emërimit si gjyqtar). Vlera e pjesës së ndërtuar pas emërimit si gjyqtar është 3,500,000 lekë. Për sa i përket hakut të punës, subjekti ka deklaruar se shtëpinë e ka ndërtuar me ndihmën reciproke të vëllezërve, si dhe me punën e tij dhe të bashkëshortes, krahas punës së punëtorëve me pagesë.

**1.9** Për ndërtimin e shtëpisë subjekti deklaroi se ka përdorur kursimet nga puna e tij e mëparshme si llogaritar e revizor në minierën e K, B, të ardhurat nga shitja e banesës në B, si dhe të ardhurat e deklaruara nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

**1.10** Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar se pranë shtëpisë në K ka ndërtuar në periudhën 2006 – 2008 objekt ndërtimor, garazh automjeti dhe, mbi të, një ambient shërbimi që kanë kushtuar 2 milionë lekë. Për këtë ndërtim i ka marrë hua kunatit (vëllait të bashkëshortes, z. P.K), shumë 10,000 euro, i cili sapo ishte kthyer nga emigracioni në Itali, shumë që është deklaruar dhe pranon se e ka shlyer gradualisht.

**1.11** Për ndërtimet e mësipërme, subjekti ka paraqitur një akt ekspertimi (të vitit 2017 dhe shtesë akti të vitit 2023) për përcaktimin e vlerës së ndërtimit nga eksperti, inxh. B. O., për banesën në total (duke mos e ndarë më vete ndërtimin e katit të parë të banesës para se të bëhej gjyqtar). Por, subjekti paraqet rezerva për mënyrën e vlerësimit të kostos së ndërtimit, kryer nga eksperti B. O., për shkak se sipas subjektit, eksperti nuk ka mbajtur parasysh se në kohën e ndërtimit vlera e materialeve të ndërtimit ishte më e ulët sesa në kohën e kryerjes së aktit të ekspertimit, si dhe eksperti nuk ka mbajtur parasysh se punimet i ka kryer vetë me vëllezërit e tij (duke marrë ustallarë vetëm për procese të specializuara të shkëputura).

**1.12** Lidhur me tokën mbi të cilën është kryer ndërtimi, subjekti ka deklaruar se në vitin 1996, babai i tij ka blerë 7 dynym tokë dhe këtë pasuri ia ka ndarë djemve të tij sipas zakonit të zonës nga vinin (Dibra) dhe vetëm disa vite më vonë, ndarja (dhurimi) u formalizua me kontratë dhurimi te noteri J. V.

**1.13** Sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 20.5.1996, rezultoi se shtetasi M.S, babai i subjektit, ka blerë nga shtetasit me mbiemër C tokë me sip. 7.000 m<sup>2</sup> në K, me çmim 165 lekë/m<sup>2</sup> ose në total 1,155,000 lekë, të cilën ua ka shpërndarë 5 djemve të tij, përfshirë edhe subjektin. Në vitin 2007, shtetasi M.S nënshkruan kontratë dhurimi nr. \*\*\*, datë 7.1.2007, sipas së cilës i dhuron 5 djemve të tij pasuri të ndodhura në z. k. \*\*\*, K, Tiranë, ndër të cilat i dhuron subjektit Vladimir Skënderi tokë arë<sup>9</sup>.

**1.14** ZVRPP Tiranë ka konfirmuar të regjistruar<sup>10</sup> në emër të z. Vladimir Skënderi pasurinë me nr. \*\*\*, truall me sip. 600 m<sup>2</sup> dhe pasurinë me nr. \*\*\* tokë arë me sip. 559 m<sup>2</sup>, në K, Tiranë.

**1.15** Rezultoi se subjekti bashkë me familjen e tij kanë ndërtuar mbi këtë pasuri tokë arë shtëpi dhe njësi shërbimi. Subjekti ka paraqitur një situacion punimesh (jo të periudhës së ndërtimit) në vlerën 5,287,415 lekë për banesën dhe 2,893,980 lekë për njësinë e shërbimit. Vlerësimi është bërë sipas subjektit, bazuar në koston e ndërtimit të periudhës 1996 – 2000, si dhe duke pasur parasysh faktin se për ndërtimin, një volum i madh punimesh me krahë pune është bërë nga pronari bashkë me vëllezërit e tij.

### **Lidhur me vlerën e tokës dhe ndërtimit, si dhe burimet financiare**

**1.16** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se e ka përfitur nga dhurimi që babai i ka bërë atij 1.159 m<sup>2</sup> (600 m<sup>2</sup> truall + 559 m<sup>2</sup> arë). Në deklarinimin për herë të parë (viti 2003),

<sup>9</sup> Me sip. 1159 m<sup>2</sup>, vlerësuar nga eksperti vlerësues 210,000 lekë.

<sup>10</sup> Shihni dokumentet bashkëlidhur: kartelë pasurie për truall me sip. 600 m<sup>2</sup>, nga i cili ndërtesë me sip. 103.9 m<sup>2</sup> + 79.4 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, K, në emër të z. Vladimir Skënderi. Tek rubrika “Përshkrimi i veçantë” është shënuar: “Leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 25.7.2013 për godinë banimi 2 kate + papafingo, godinë shërbimi 2 kate + 1 kat nëntokë, me sipërfaqe parcele 600 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 103.9 m<sup>2</sup> + 79.4 m<sup>2</sup>.”



subjekti ka deklaruar tokë bujqësore 1.000 m<sup>2</sup> në vlerën 0,16 milion lekë nga kursimet. Konstatohen mospërputhje lidhur me këto dy deklarime si për sipërfaqen, ashtu edhe për mënyrën e fitimit të pronësisë.

**1.17** Për vlerën e investuar në ndërtimin e shtëpisë dhe njësisë së shërbimit mbi këtë pasuri, subjekti ka deklaruar vlera të ndryshme, në kohë të ndryshme, si vijon:

➤ Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se ka kryer ndërtimin në vitet 1996 – 2000, në vlerën në total 8.200.000 lekë (banesa 5,287,415 lekë dhe godina 2,893,980 lekë), vlerë e cila përfshin kostot e llogaritura nga eksperti vlerësues.

➤ Ndërsa shuma e deklaruar ndër vite, deri në vitin 2006 është 5,400,000 lekë, nga këto 3 milionë lekë, deklaruar në vitin 2003 shtëpi banimi, ndërtuar në vitet 1997 – 1999 dhe 0,12 milion lekë lavazh për larje automjetesh, ndërtuar në vitin 1998; 200,000 lekë një ahur dhe 300,000 lekë garazh automjeti, ndërtuar në vitin 2004; 500.000 lekë dy dhoma, ndërtuar në vitin 2005 dhe 50,000 lekë, shtuar një dhomë dhe ndërtuar një garazh me para borxh 10,000 euro, në vitin 2006.

➤ Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaroi se në total për banesën, garazh automjeti e ambientin e shërbimit ka shpenzuar rreth 8,000,000 lekë (6 milionë + 2 milionë lekë).

**1.18** Me anë të pyetësorit nr. 2<sup>11</sup>, subjektit të rivlerësimit iu kërkua: të provonte me dokumentacion justifikues ligjor mundësitë financiare të babait të tij për blerjen e tokës me sip. 7.000 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 1,155,000 lekë, në vitin 1996 (nga e cila subjektit i është dhuruar 1.159 m<sup>2</sup>); të deklaronte dhe saktësonte mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, kohën e ndërtimit dhe burimin financiar të krijimit të kësaj pasurie: si dhe të provonte me dokumentacion justifikues ligjor mundësitë financiare të kumatit të tij si huadhënës i shumës 10,000 euro në vitin 2006, si dhe burimin dhe mundësitë e kthimit të kësaj shume.

**1.19** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit<sup>12</sup>, ka deklaruar se:

- Toka në K realisht është aq sa është deklaruar në deklaratën *Vetting*, pra 1.159 m<sup>2</sup>.
- Burimi i krijimit të tokës së mësipërme është dhurimi nga babai datë 7.1.2007.
- Burimet për blerjen e tokës nga prindërit në vlerën 1,155,000 lekë, janë: kursimet nga puna e tyre; shitja e shtëpisë dykatëshe në Gj<sup>13</sup>; kultivimi i tokës dhe mbarështimi i bagëtive.
- Vlera reale e investimit për ndërtimet e realizuara mbi tokën në K për periudhën 1996 – 2000, është 8,181,395 lekë.
- Në pyetësorin standard kam deklaruar vlerën 8,000,000 lekë. Kjo ka ndodhur sepse e kam plotësuar pyetësorin standard, me përfaqësi, pa u referuar në dokumentet përkatëse.
- Eksperti ka përpiluar raportin e vlerësimit të datës 24.1.2017 dhe aktin e ekspertimit shtesë të datës 21.2.2023, sa i përket banesës me sip. 103,9 m<sup>2</sup> bërë përcaktimet përkatëse:

<sup>11</sup> Shihni pyetësorin nr. 2, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

<sup>12</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. 2.

<sup>13</sup> Për të provuar këtë shitblerje në mungesë të kontratës noteriale të shitblerjes, subjekti paraqet vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2023, të Njësisë Administrative Gj.

- **kati 1** 1,403,545 lekë -238,602 (17% puna e krahut) =1,164,943: 8 vite = 145,618 lekë/vit;
- **kati 2** 82,305 lekë -139,911 (17% puna e krahut) = 683,094: 2 vite =341,547 lekë/vit;
- **papaf.** 521,985 lekë – 887,370 (17% puna e krahut) = 433,248: 1 vit =433,248 lekë/vit;
- **rifiniturë** 2,538,880 lekë – 431,610 (17% puna e krahut) = 2107270: 9 vite =234,141 lekë/vit.

Shumat 5,287,415 -898,860 4,388,555 lekë

- Ndërsa në lidhje me huan 10,000 euro të marrë nga shtetasi P.K për ndërtimin e godinës së shërbimit, sikurse provohet me deklaratën e datës 15.8.2022, shpjegohet se në vitet 2004 – 2005 ka qenë emigrant klandestin në Itali, ku ka punuar në bujqësi e ndërtim për dy vite. Ai ka punuar në të zezë dhe nuk disponon dokument për të ardhurat e realizuara prej tij në Itali.

**1.20** Pas administrimit të dokumentacionit përkatës dhe përgjigjeve të dërguara nga subjekti, Komisioni konstatoi se:

- Bazuar në përgjigjen e subjektit të rivlerësimit në këtë pyetësor dhe duke e krahasuar me deklaratën *Vetting*, deklarimet në deklaratat periodike, si dhe në përgjigje të pyetësorit standard, deklarimet e subjektit rezultuan të pasakta në lidhje me kohën e ndërtimit dhe vlerat financiare të deklaruara po nga vetë ai.
- Në lidhje me shumën e përfituar si hua në vitin 2006 në vlerën 10,000 euro, subjekti nuk paraqiti dokumentacion provues lidhur me mundësitë e huadhënësit (kumatit të tij). Vlera e pretenduar prej 10,000 euro si hua nuk u bë pjesë e analizës financiare për shkak se subjekti nuk ka provuar ekzistencën e marrëdhënies së huas, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume nga huadhënësi.
- Lidhur me fitimin e pronësisë së tokës nga babai i subjektit rezultoi se ky fitim pronësie është bërë në vitin 1996 me kontratë noteriale, shumë kohë para se subjekti të fillonte detyrën si gjyqtar, prandaj edhe Komisioni nuk hetoi më tej për mundësitë e krijimit të kësaj pasurie nga babai i subjektit, M. S.

### **1.21 Vlerësimi në lidhje me kohën e ndërtimit të objekteve**

- ✓ Në deklaratat periodike vjetore ka deklaruar se ka ndërtuar shtëpi banimi në vitet 1997 – 1999 dhe lavazh për larje automjetesh në vitin 1998 dhe në deklaratat e viteve pasuese deklaroi se ka ndërtuar deri në vitin 2008.
- ✓ Në deklaratën *Vetting* deklaroi se ndërtimi është kryer gjatë periudhës 1996 – 2000.
- ✓ Në përgjigje të pyetësorit standard deklaroi se kati i parë është ndërtuar që në vitin 1998, ndërsa kati i dytë dhe papafingoja janë ndërtuar në periudhën 2000 – 2005 dhe deri në vitin 2008 garazh automjeti dhe, mbi të, një ambient shërbimi.
- ✓ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se ka ndërtuar nga viti 1996 deri në vitin 2015.

**1.22** Pra, rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar saktë ndër vite periudhën e ndërtimit të këtyre dy objekteve ndërtimore në K dhe, për këtë arsye, Komisioni iu referua ortofotove<sup>14</sup> si e vetmja mënyrë verifikimi e saktësimi i kohës së ndërtimit të objekteve (shtëpi banimi dhe godinë shërbimi) nga subjekti dhe bashkëshortja e tij ndër vite.

**1.23** Bazuar në këto ortofoto në vitin 1999, duket se nuk ka ndërtime të kryera në pronën e subjektit. Nga ortofotot e viteve 2002 – 2003 rezulton që subjekti të ketë ndërtuar vetëm një kat shtëpi banimi. Nga ortofotot e vitit 2004 rezulton e përfunduar shtëpi banimi e mbuluar me çati. Për periudhën tetor 2004 – qershor 2007 nuk ka ortofoto të publikuara, ndërsa, nga ortofotot e vitit 2007 rezulton e përfunduar edhe godina e shërbimit.

**1.24** Në vitin 2006 subjekti ka paraqitur vetëdeklarim për legalizim<sup>15</sup> të objektit shtëpi banimi 2 kate me çati me tjegull dhe sip. ndërtimi ahur 32 m<sup>2</sup>, mure rrethuese 130 m<sup>2</sup> dhe garazh 49 m<sup>2</sup> dhe në vitin 2013 është pajisur nga ALUIZNI me leje legalizimi për këto dy objekte: shtëpi banimi dy kate + papafingo dhe godinë shërbimi dy kate dhe një kat nëntokë, sipërfaqe përkatësisht 360.4 m<sup>2</sup> dhe 238.2 m<sup>2</sup>. Sipas këtij formulari vetëdeklarimi për legalizim subjekti ka deklaruar se viti i ndërtimit të objekteve është qershor 2000. Pra, në momentin e paraqitjes së kërkesës për legalizim (viti 2006) duket se dy objektet ndërtimore kanë qenë të përfunduara.

**1.25** Nisur nga të dhënat e mësipërme: deklaramet e subjektit, dokumentacioni nga ASHK-ja, dokumentacioni i subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe ortofotot e objekteve, Komisioni vlerësoi se subjekti ka ndërtuar shtëpinë e banimit, katin e parë në vitin 2002 – 2003; katin e dytë dhe papafingo në vitin 2004 dhe si kohë ndërtimi të godinës së shërbimit periudhën 2004 – 2006.

**1.26** Bazuar në përgjigjen e subjektit të rivlerësimit dhe duke e krahasuar me deklaramet në deklaratat periodike, në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve, Komisioni konstatoi se deklaramet e tij janë të pasakta në lidhje me vitet e ndërtimit të dy objekteve.

### **1.27 Vlerësimi lidhur me vlerën e ndërtimit**

Në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se vlera reale e ndërtimit të shtëpisë dy kate + papafingo dhe godinës së shërbimit dy kate + kat nëntokë është 8,181,395 lekë, sipas përlllogaritjes nga eksperti në raportin e vlerësimit të datës 24.1.2017 (sipas kostos së ndërtimit për periudhën që ato janë ndërtuar në vitet 1996 – 2000).

Subjekti pretendon se nga ajo vlerë duhet zbritur puna e krahut që është kryer nga vëllezërit, kjo sipas shtesës së aktit të ekspertimit të datës 21.2.2023. Kjo vlerë, sipas subjektit, duke zbritur punën e krahut (17% të vlerës së përgjithshme), shkon në 4,388,555 lekë.

**1.28** Nisur nga fakti se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues të kohës së ndërtimit të objekteve (leje ndërtimi, situacion punimesh, preventiv etj.), atëherë Komisioni bëri vlerësimin duke u bazuar në praktikën e ndjekur për vlerësimin e objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi. Për këtë, Komisioni iu referua të dhënave të miratuara nga Këshilli i Ministrave lidhur me kostot e ndërtimit të hartuara dhe të llogaritura nga Enti Kombëtar i Banesave.

<sup>14</sup> Sipas të dhënave të publikuara nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe nga aplikacioni "Google Earth Pro".

<sup>15</sup> Shihni praktikën e dërguar nga ASHK-ja lidhur me aplikimin dhe dosjen e legalizimit.

**1.29** Duke marrë parasysh kostot e ndërtimit për metër katror sipërfaqe ndërtimi sipas Entit Kombëtar të Banesave, Komisioni bëri llogaritjen e kostos së ndërtimit të objekteve për vitet 2002 – 2006.

Viti	Kosto/m <sup>2</sup>	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )	Kosto	Përshkrimi
2002 – 2003	22,383 lekë/m <sup>2</sup>	103.9	2,325,542 lekë	Kati 1
2004	24,446 lekë/m <sup>2</sup>	232.8	5,691,029 lekë	Kati 2 + papafingo
2004	24,446 lekë/m <sup>2</sup>	79.4	1,941,012 lekë	Garazh
2006	25,262 lekë/m <sup>2</sup>	158.8	4,011,606 lekë	Lokal 2 kate
<b>TOTAL KOSTO NDËRTIMI K.</b>			<b>13,969,189 lekë</b>	

**1.30** Vlerat e kostos së ndërtimit të pasqyruara në tabelën e mësipërme përfshihen si investime të bëra në pasurinë e subjektit në vitet përkatëse në analizën financiare.

**1.31** Referuar rezultatit negativ financiar në të gjithë periudhën 1994 – 2006<sup>16</sup>, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kishin mundësi financiare për krijimin e pasurive (ndërtimeve) të deklaruara, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera në këtë periudhë kohore.

**1.32** Në këtë analizë financiare janë përfshirë të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortes nga viti 1994 deri në vitin 2006.

**1.33** Subjekti nuk arriti të provojë të ardhurat e pretenduara nga shitja e banesës në B. sepse ai nuk arriti të provojë realizimin e kësaj shitjeje me anë të ndonjë kontrate. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti paraqiti vetëm një deklaratë noteriale<sup>17</sup> të tij dhe shtetasit H. T. Sipas kësaj deklarate, subjekti i ka shitur shtetasit H. T. një banesë në vitin 1997 në çmimin 90,000 lekë. Gjithashtu, rezultoi se as pasuria në fjalë dhe as ndryshimi i pronësisë së saj nuk janë regjistruar në ASHK. Si rrjedhim, këto të ardhura të pretenduara nuk u përfshinë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të periudhës 1994 – 2006.

**1.34** Analiza për periudhën 1994 – 2002 është bërë në bllok, pasi në atë kohë subjekti nuk ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së. Ndërsa, analiza financiare e periudhës 2003 – 2006 është bërë vit pas viti, meqenëse subjekti ka deklaruar çdo vit pranë ILDKPKI-së.

### **1.35 Në përfundim të hetimit Komisioni doli në konkluzionet si vijon:**

- Në analizë të deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar për këtë pasuri, rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar dhe provuar me vërtetësi dhe saktësi mënyrën, kohën e fitimit dhe vlerën e investuar për dy objektet ndërtimore në K, Tiranë.
- Komisioni konstatoi problematika për këtë pasuri në raport me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për sa i përket mënyrës, kohës dhe vlerës së ndërtimit të këtyre pasurive të paluajtshme.
- Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion të kohës vitin/et e ndërtimit të objekteve ndërtimore dhe nuk ka paraqitur situacion/preventiv apo fatura të kohës për të provuar vlerat financiare të shpenzuara për këto ndërtime në K.

<sup>16</sup> Shihni analizën financiare në pikën 13 të këtij vendimi.

<sup>17</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.5.2023.

### 1.36 Për sa më sipër u konstatua edhe se:

- Ka mospërputhje të deklaratës *Vetting* me DPV-të dhe përgjigjet e pyetësorëve lidhur me blerjen e truallit dhe, më pas, deklarimit si dhurim nga babai i subjektit.
- Ka mospërputhje të deklaratës *Vetting*, me DPV-të dhe përgjigjet e pyetësorëve lidhur me kohën e ndërtimit të objekteve ndërtimore.
- Bazuar në ortofotot konstatohet se për periudhën e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* (1996 – 2000) nuk ka pasur objekte ndërtimore të ndërtuara dhe rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting* lidhur me vitet e ndërtimit.
- Ka mospërputhje të deklaratës *Vetting* me DPV-të dhe përgjigjet e pyetësorëve lidhur me vlerat e deklaruara për ndërtim dhe vlerat financiare të shpenzuara gjatë viteve për objektet ndërtimore.
- Subjekti është gjendur në kushtet e pamundësisë financiare për krijimin e këtyre dy objekteve ndërtimore<sup>18</sup>.
- Subjekti nuk ka provuar ekzistencën e marrëdhënies së huadhënies, si dhe mundësitë financiare të huadhënësit (kumatit të tij P. K.) për shumën e përfituruar si hua në vitin 2006, në vlerën 10,000 euro.

1.37 Për të gjitha gjetjet e konstatuara subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit<sup>19</sup>

1.38 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se:

- *Konkluzionet e nxjerra nga ILDKPKI-ja janë pjesërisht të drejta. Për pjesën që ato nuk qëndrojnë janë kontestuar në Gjykatën Administrative Tiranë, ku është fituar gjyqi, vendim ky që sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile është i detyrueshëm për të gjitha gjykatat... institucionet.*
- *Nuk ka pasuri të padeklaruara, por është i vetëdijshëm për ndonjë pasaktësi në deklaram, shkaktuar nga plotësimi i shkujdesur i deklaratave periodike vjetore, si dhe për sa i përket mungesës së dokumentacionit ligjor për burimin financiar rast pas rast duhet mbajtur parasysh informaliteti në të cilin ka funksionuar Shqipëria në periudhën e kontrolluar.*
- *Toka në K është blerë nga babai në vitin 1996 e më pas u është dhuruar fëmijëve të tij. Kontrata e dhurimit të tokës është bërë më vonë sesa dhurimi sepse zona nuk ishte e azhurnuar në ZVRPP. Që në vitin 1997 është filluar të ndërtohet banesa në K. Kostot e ndërtimeve të kryera janë llogaritur me ekspert.*
- *Që nga qershori 1998 kanë jetuar në banesën 1+1 në K, e cila më vonë është modifikuar si serrë perimesh, kurse në vjeshtën e vitit 2002 është përfunduar si karabina ndërtimi i banesës i përbërë nga dy kate dhe papafingo, gjë që provohet me ortofoton datë 16.2.2003.*
- *Viti i ndërtimit të karabinasë është i ndryshëm nga viti i përfundimit të të gjithë ndërtimit ku duhen marrë parasysh punimet e brendshme. Të ardhura për të realizuar ndërtimet, të*

<sup>18</sup> Shihni analizën financiare më poshtë për periudhën deri në vitin 2003 dhe 2003 – 2006.

<sup>19</sup> Shihni përgjigjen e plotë të subjektit mbi rezultatet e hetimit.

*cilat janë realizuar në pjesën më të madhe para vitit 2003 dhe përbëheshin nga të ardhurat nga puna, nga shitja e banesës në B, nga aktiviteti tregtar, të ardhura nga kultivimi i tokës, nga lavazhi etj.*

- *Sa i përket mundësisë financiare të huadhënësit (kumatit P. K.) për shumën e përfituar si hua në vitin 2006 në vlerën 10,000 euro, sqarohet se ai në ato vite ka qenë emigrant i paligjshëm në Itali, ku ka punuar në ndërtim e në bujqësi dhe ka siguruar të ardhura shumë më të mëdha sesa huaja e dhënë.*

**1.39** Në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, në seancën dëgjimore të datës 20.7.2023, subjekti i ka kërkuar Komisionit të mbajë në konsideratë faktin se deri në vitin 2002 ishte vënë pjesa dërrmuese e pasurisë së tij të paluajtshme, provuar kjo me ortofoton e datës 16.2.2003, të cilën e kishte depozituar bashkë me dokumentet e tjera bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare. Në vitin 2003 e në vijim, subjekti thotë se ka shtuar vetëm çatinë (papafingon) e banesës, si dhe lokalin.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**1.40** Komisioni, krahas shpjegimeve të subjektit dhe provave të dërguara gjatë hetimit administrativ, analizoi edhe dokumentet e sjella nga ana e tij në cilësinë e provave, në përgjigje të barrës së provës, nga ku i rezultoi se vendimi i formës së prerë nr. \*\*\*, datë 24.2.2022, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i sjellë nga subjekti (për sa i përket dispozitivit të tij), nuk përmbush kushtet dhe kriteret e provës shkresore, e cila të mund të përmbyste barrën e provës së lënë subjektit sepse periudha për të cilën ILDKPKI-ja ka vendosur masën administrative gjobë, që gjykata e ka shfuqizuar, përfshin kontrollin e deklaratave periodike vjetore për periudhën 2017 – 2020, për subjektin Vladimir Skënderi, periudhë kjo jashtë periudhës së rivlerësimit<sup>20</sup>.

**1.41** Gjithashtu, vlen të theksohet se Komisioni është institucion i pavarur kushtetues që ka për qëllim rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve me anë të kryerjes së një hetimi administrativ të drejtë, të paanshëm e ligjor, proces i cili nuk gjen përplasje me një akt apo vendim gjyqësor të asnjë gjykate të vendit tonë. Aq më pak, shkeljet e listuara në urdhrin gjobë të ILDKPKI-së nuk përkojnë me çështjen e trajtuar në këtë kre të këtij vendimi.

**1.42** Lidhur me periudhën e ndërtimit, Komisioni i qëndron gjetjeve të bëra në rezultatet e hetimit duke u bazuar në ortofotot sipas periudhave përkatëse. Bazuar në këto ortofoto rezultoi se për periudhën e deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* (1996 – 2000) nuk ka pasur objekte të ndërtuara mbi tokën e subjektit. Subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës lidhur me vitet e ndërtimit të objekteve ndërtimore. Lidhur me periudhën e ndërtimit të objekteve, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*.

**1.43** Në lidhje me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.7.2023, të sjellë nga subjekti me qëllim provueshmërinë e kryerjes së ndërtimit me punë krahu nga subjekti dhe vëllezërit e tij, duke pretenduar reduktim shpenzimesh për sa i takon kostos së ndërtimit të shtëpisë së banimit dhe godinës së shërbimit në K, Komisioni vlerësoi se ky dokument (deklaratë noteriale) është i njëanshëm, marrë për qëllim *Vetting*-u dhe nuk ka vlerë ligjore duke qenë se nuk i përket kohës së kryerjes së ndërtimit dhe nuk përbën një dokumentim real të kryerjes së një prej proceseve të ndërtimit siç është puna e krahut. Në këto kushte, Komisioni

<sup>20</sup> Periudha e rivlerësimit shtrihet deri në datën 31.12.2016.

nuk konsideroi pretendimin e subjektit për reduktimin e vlerës së ndërtimit lidhur me realizimin e ndërtimit me punë krahu nga ai e vëllezërit e tij, duke lënë vlerën e përcaktuar sipas Entit Kombëtar të Banesave për vitet 2002 – 2006.

**1.44** Trupi gjykues, në vlerësim edhe të arsytimit të Kolegjit për rastin e përlllogaritjeve sipas kostove të ndërtimit sipas EKB-së për vitet përkatëse, si dhe duke vlerësuar faktet dhe rrethanat në këtë rast, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për periudhën 1994 – 2006 në vlerën prej 12,915,688 lekë<sup>21</sup>.

**1.45** Gjithashtu, Komisioni konstaton se edhe nëse do të zbritej nga vlera totale e kostove të ndërtimit të përlllogaritura sipas referencave të EKB-së, pjesa që i përket punës së krahut të pretenduar nga subjekti në masën 17% të kostos totale të ndërtimit, subjekti përsëri do të gjendej me një bilanc negativ për vitet 1994 – 2006, me një mungesë të burimeve financiare në vlerën prej 10,540,926 lekësh.

**1.46** Komisioni ka vlerësuar nga pikëpamja ligjore dhe financiare ndërtimin e godinës së banimit dhe godinën e shërbimit, por nuk ka qenë në dijeni të faktit se subjekti ka jetuar në një objekt tjetër të ndërtuar në vitin 1998, për sa kohë ai nuk e ka deklaruar asnjëherë më parë. Por, edhe nëse Komisioni do ta përfshinte në analizën financiare këtë objekt, duke e llogaritur me çmimet e EKB-së, kjo do të rëndonte analizën financiare të subjektit për periudhën 1998 – 2002. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti duhej ta kishte deklaruar ndërtimin e këtij objekti si pasuri dhe adresë banimi të tij deri në përfundimin e godinës së banimit. Subjekti ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me këtë objekt, i cili sipas tij ka shërbyer si banesë për të jetuar.

**1.47** Subjekti në prapësimet e tij nuk arriti të provojë të ardhura të tjera të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore përkatëse, që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive objekt ndërtimor deri në vitin 2003 (të ardhura të pretenduara nga aktiviteti tregtar, kultivimi i tokës dhe nga lavazhi).

**1.48** Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të përmbysë edhe barrën e provës lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit (kumatit të tij) në shumën 10,000 euro. Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor aftësitë e tij pagueuse, duke mos sjellë asnjë dokument provues të krijimit të të ardhurave nga ana e tij, por është mjaftuar vetëm me deklarimin se ai ka qenë emigrant.

**1.49** Në vlerësimin përfundimtar lidhur me këtë pasuri (shtëpi banimi e godinë shërbimi) dhe burimin e krijimit, Komisioni arriti në përfundimin se:

- Subjekti ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me vlerat dhe vitet e ndërtimit.
- Subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare për krijimin e saj me burime të ligjshme financiare dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë.
- Lidhur me pamundësinë financiare për krijimin e këtyre pasurive shihni analizën financiare (pika 13 e këtij vendimi) për periudhën 1994 – 2006.

---

<sup>21</sup> Shiko analizën financiare per periudhën 1994-2006 në pikën 13 të këtij vendimi

- Subjekti nuk arriti të provojë mundësinë financiare të huadhënësit, kumatit të tij (P. K.) lidhur me mundësitë e tij për dhënien e huas me burime të ligjshme.

**1.50** Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

## **2. Tokë arë me sip. 559 m<sup>2</sup>, në K.**

**2.1** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar *tokë arë me sip. 559 m<sup>2</sup>, në K*, dhuruar nga babai M.S me kontratë noteriale nr. \*\*\*, datë 7.1.2007, vlerësuar  $1.159 \text{ m}^2 = 210,000$  lekë, pra  $559 \text{ m}^2 = 101,285$  lekë. Pjesa takuese: 50%.

**2.2** Subjekti e ka deklaruar si pasuri më vete, por kjo pasuri është pjesë përbërëse e sipërfaqes prej  $1.159 \text{ m}^2$  ( $600 + 559 \text{ m}^2$ ), dhuruar nga babai i tij në vitin 2007, trajtuar në pikën 1 të këtij vendimi.

## **3. Tokë dhe ndërtesë në Gj. e E., Bulqizë**

**3.1** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: *“Tokë në Gj e E, Bulqizë, z. k. \*\*\*, fituar me AMTP-në datë 15.5.1998, sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. Zotërimi: 50%”*.

- *Pasuria me sip. 437 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 60 m<sup>2</sup>.*
- *Pasuria me sip. 280 m<sup>2</sup> arë.*
- *Pasuria me sip. 700 m<sup>2</sup> arë.*

*Vlera e ndërtesës dhe tokës është llogaritur përkatësisht me nga 402,000 lekë dhe 87,400 lekë.*

**3.2** Subjekti për të provuar deklaramet e tij i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente shkresore<sup>22</sup>.

**3.3** ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se: *“Subjekti ka deklaruar tokën bujqësore të përfituar nga zbatimi i ligjit nr. 7501 dhe ka paraqitur AMTP dhe dokumentet hipotekore, por gjithashtu ka deklaruar edhe vlerën e saj bazuar në raportin e një eksperti vlerësues të pronave. Pasuria e përfituar përbëhet nga arë, truall dhe një ndërtesë”*.

## **Hetimi i Komisionit për këtë pasuri**

**3.4** Rezultoi se në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar: *“Tokë bujqësore 1.000 m<sup>2</sup>, në Gj, Dibër, viti 1996, fituar me ligjin nr. 7501; shtëpi banimi 1+1, me sip. 32 m<sup>2</sup>, në Gj, Dibër, trashëguar, ndërtuar para vitit 1990 dhe trualli me sip. 1.000 m<sup>2</sup>, mbi të cilin është ndërtuar*

<sup>22</sup> Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*: certifikatë për vërtetim pronësie datë 31.7.2008 për arë + truall me sip. 437 m<sup>2</sup>, ku trualli me sip. 300 m<sup>2</sup>, nga i cili ndërtesa me sip. 60 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në Bulqizë, Gj. e E., në pronësi të z. Vladimir Skënderi; certifikatë për vërtetim pronësie datë 31.7.2008 për arë me sip. 280 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në Bulqizë, Gj. e E., në pronësi të z. Vladimir Skënderi; certifikatë për vërtetim pronësie datë 31.7.2008 për arë me sip. 700 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në Bulqizë, Gj. e E., në pronësi të z. Vladimir Skënderi; AMTP datë 25.5.1998 e fshatit Gj., Bulqizë, për përfitimin nga familja e z. Vladimir Skënderi të tokës me sipërfaqe të përgjithshme 1.884 m<sup>2</sup>, nga e cila 474 m<sup>2</sup> pemëtores dhe 500 m<sup>2</sup> truall; raport vlerësimi i datës 24.1.2017 nga eksperti vlerësues B. O. për pronë të z. Vladimir Skënderi; arë + truall dhe ndërtesë, përfituar nga ligji nr. 7501, datë 15.5.1998, me sipërfaqe totale 1.717 m<sup>2</sup>, nga ku sipërfaqe trualli 300 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtesë 60 m<sup>2</sup>, në fshatin Gj. e E., Bulqizë.



*shtëpia me sip. 32 m<sup>2</sup>, në Gj, Dibër. Pasuri e trashëguar*". Subjekti ka bashkëlidhur disa dokumente<sup>23</sup>.

**3.5 ZVRPP Bulqizë<sup>24</sup>** ka konfirmuar se në emër të z. Vladimir Skënderi është përfituar sipas AMTP-së datë 25.5.1998, fshati Gj., Bulqizë, tokë me sipërfaqe të përgjithshme 1.884 m<sup>2</sup>, nga e cila 474 m<sup>2</sup> pemëtoare dhe 500 m<sup>2</sup> truall.

**3.6 Në lidhje me sipërfaqen e tokës dhe të shtëpisë:** në deklaratën *Vetting* subjekti deklaron 1.417 m<sup>2</sup> sip. tokë dhe 60 m<sup>2</sup> shtëpi banimi (hipotekuar në vitin 2008); në DPV-në e vitit 2003 deklaron 2000 m<sup>2</sup> tokë dhe 32 m<sup>2</sup> shtëpi banimi, ndërtuar para vitit 1990. Nga AMTP-ja e lëshuar në vitin 1998 në fshatin Gj., rezulton 1.884 m<sup>2</sup> sipërfaqe toke e përfituar.

**3.7** Nga deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting*, në DPV-në e vitit 2003 dhe në përgjigje pyetësores rezultoi se ka mospërputhje për sa i përket sipërfaqes së tokës së përfituar, sipërfaqes së shtëpisë së banimit dhe kohës së ndërtimit të kësaj banese.

**3.8 Në lidhje me kohën e ndërtimit të shtëpisë:** në DPV-në e vitit 2003 subjekti deklaron se shtëpinë e banimit e ka ndërtuar para vitit 1990, kurse në përgjigje të pyetësorit standard (në ndryshim me DPV-në e vitit 2003) deklaroi se shtëpinë në Gj. e ka ndërtuar në vitet 1990.

**3.9** Subjekti e ka deklaruar pasurinë në Gj, Dibër, si pronë të trashëguar, ndërkohë ajo rezulton e përfituar nga subjekti si përfaqësues i familjes bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501/1991, "Për tokën" dhe e hipotekuar në vitin 2008.

**3.10** Subjekti ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga toka në Gj. dhe në DPV-të e viteve 2011, 2012 dhe 2013 deklaron të ardhura edhe nga banesa gjithashtu, por subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë shpenzime për ndonjë investim të kryer për zhvillimin e tokës bujqësore ndër vite dhe as investime apo shpenzime për shtëpinë, qoftë edhe shpenzime mirëmbajtjeje. Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar vetëm shpenzime për mobilim.

**3.11** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësojë mënyrën e përfitimit të tokës bujqësore dhe shtëpisë në fshatin Gj., sipërfaqen e saktë të tyre, vitin e ndërtimit të shtëpisë, vlerën e shpenzuar për investim dhe/ose mirëmbajtjen e tokës bujqësore dhe shtëpisë, e ndarë sipas viteve dhe burimet financiare përkatëse.

**3.12** Subjekti, në përgjigje të pyetësorit<sup>25</sup>, ka deklaruar se: "*Sipërfaqja e saktë e tokës që posedojmë në Gj. është 1.884 m<sup>2</sup>, aq sa është shënuar në AMTP-në e datës 15.5.1998.*

*Në deklaratën Vetting deklarimi është bërë sipas 3 certifikatave të pronësisë, të cilat nuk janë të sakta, për shkak të gabimeve të punonjësve të ZVRPP-së Bulqizë.*

*Kjo tokë de jure është ndarë sipas ligjit nr. 7501, sikurse është shënuar edhe në AMTP, por de facto në Dibër nuk ka vepruar ligji nr. 7501, por secili ka marrë tokën e gjyshërve sipas kufijve të vjetër<sup>26</sup>. Kjo është arsyeja që e kam deklaruar si pronë të trashëguar.*

<sup>23</sup>Shihni dokumentet bashkëlidhur DV: AMTP datë 25.5.1998 e fshatit Gj., Bulqizë, për tokë me sipërfaqe të përgjithshme 1.884 m<sup>2</sup>, nga e cila 474 m<sup>2</sup> pemëtoare dhe 500 m<sup>2</sup> truall, e cila i jepet familjes së V. S.; kartelë pasurie për arë me sip. 200 m<sup>2</sup> në emër të V. S., sipas LN rezulton 280 m<sup>2</sup>; kartelë pasurie për arë + truall me sip. 974 m<sup>2</sup>, nga e cila 500 m<sup>2</sup> truall, në emër të V. S., sipas LN rezulton 437 m<sup>2</sup>, nga e cila truall me sip. 300 m<sup>2</sup> dhe kartelë pasurie për arë me sip. 615 m<sup>2</sup> në emër të Vladimir Skënderit, sipas LN 700 m<sup>2</sup>.

<sup>24</sup> Shihni përgjigjen e ZVRPP-së Bulqizë në dosjen e Komisionit dhe të ILDKPKI-së.

<sup>25</sup> Shihni përgjigjen e plotë të subjektit mbi pyetësorin nr. 2.

<sup>26</sup> Për të provuar këtë subjekti ka sjellë procesverbalin e datës 1.12.1994, me të cilin është bërë ndarja e tokës së trashëguar midis vëllezërve e prindërve.

*Nuk kam investuar para për tokën, mbjelljen e pemëve apo kultivimin e perimeve, sepse i kemi bërë me punë krahu ne si familje.*

*Në lidhje me kohën e ndërtimit të banesës me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup> në Gj., ajo është ndërtuar me punë krahu nga unë e bashkëshortja ime me ndihmën e të afërmeve në vitet 1991 dhe 1992.*

*Në lidhje me investimet e kryera në atë banesë sqaroj se në vitin 2022 i kam riparuar suvanë e çatinë dhe lyer. Vlera totale e këtyre punimeve është 250,000 lekë dhe burimi i këtyre parave është nga të ardhurat e familjes sime”.*

**3.13** Referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni, si dhe përgjigjes së subjektit, evidentohet se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”, në vitin 1998, vit kur ata nuk ishin me banim në Gj., Dibër, çka bën të diskutueshëm procesin e ndarjes së tokës në zbatim të ligjit “Për tokën” në favor të subjektit të rivlerësimit, duke u nisur nga pozita e tij si magjistrat dhe pritshmëritë për zbatimin rigoroz të dispozitave të ligjit të sipërcituar<sup>27</sup> në veçanti dhe të legjislacionit në përgjithësi. Por, për sa kohë kjo pasuri rezultoi e certifikuar, përfituar nga ligji nr. 7501/1991 para fillimit të detyrës, Komisioni nuk hetoi më tej.

**3.14** Për sa i përket kohës së ndërtimit të shtëpisë prej 60 m<sup>2</sup>, subjekti, në përgjigje pyetësori ka deklaruar se e ka ndërtuar në vitet 1991 – 1992. Referuar vërtetimit të cituar në pikën 1 të këtij vendimi, me nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2023, të Njësisë Administrative Gj., thuhet se *shtetasi M.S (babai i subjektit) ka qenë banor i fshatit Gj. dhe është shpërngulur bashkë me djemtë e tij në vitin 1996. Shtëpinë dykatëshe dhe tokën ia ka shitur D. S., kohë në të cilën (në vitin 1996) prindërit e subjektit kanë blerë tokën në K dhe sipas kësaj logjike duket se ndërtimi i banesës (60 m<sup>2</sup>) nga subjekti të jetë ndërtuar pas vitit 1996.*

**3.15** Ndërsa, për sa i përket kostos së ndërtimit të kësaj banese, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se shtëpinë në Gj. e ka ndërtuar me punë krahu dhe përsëri nuk ka deklaruar asnjë vlerë për ndërtimin e saj, përveçse shpenzimit të kryer në vitin 2022 (në vlerën 250,000 lekë).

**3.16** Subjekti nuk arriti të paraqesë dokumentacion provues lidhur me vitin e ndërtimit të kësaj pasurie, shtëpi banimi në Gj. dhe, për pasojë, nuk u mundësua as llogaritja e vlerës së ndërtimit. Por, Komisioni, bazuar në ortofotot e para të vitit 1999, konstatoi se ky objekt duket se ishte i ndërtuar para fillimit të detyrës së subjektit si gjyqtar.

**3.17** Sa më sipër, Komisioni në rezultatet e hetimit i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime lidhur me gjendjen aktuale të shtëpisë, përdorimin e saj, shpenzimet e kryera ndër vite, si dhe të paraqesë foto aktuale të saj.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**3.18** Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës, foto të bëra në muajin qershor të vitit 2023, të shtëpisë dhe tokës në Gj.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**3.19** Në lidhje me këtë pasuri (shtëpi dhe tokë në Gj.) dhe burimin e krijimit të saj, Komisionit nuk i rezultuan problematika thelbësore. Mënyra e aplikimit dhe zbatimit të ligjit nr. 7501/1991,

---

<sup>27</sup> Duke parë një prej kushteve të përfitimit nga ky ligj, siç është fakti i të qenit banor në zonën përkatëse (fshatin Gj), në momentin e ndarjes së tokës bujqësore.

“Për tokën” është tanimë një çështje që ka krijuar diskutime dhe konflikte të shumta në vendin tonë, në lidhje me zbatimin e tij, çka vërteton edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit që këto kërkesa të këtij ligji më shumë janë përshtatur me kërkesat e individëve të veçantë në vend të zbatimit rigoroz të tij.

**3.20** Komisioni konstatoi se kjo pasuri tokë është fituar me AMTP-në datë 15.5.1998 dhe se objekti ndërtimor bazuar në ortofoto rezultoi i ndërtuar para fillimit të detyrës së subjektit si magjistrat.

Nuk u konstatuan problematika për këto pasuri (tokë dhe ndërtesë) të deklaruara nga subjekti.

#### **4. Automjet tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\***

**4.1** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar automjet tip “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*, blerë nga shoqëria “P” sh.p.k., datë 13.4.2011, në vlerën 15,000 euro, ndërsa si burim të blerjes së këtij automjeti subjekti deklaroi kredi nga Alpha Bank dhe kursimet e tij.

**4.2** Në DPV-në e vitit 2011 subjekti deklaroi si burim të blerjes së automjetit kredi bankare nga Alpha Bank. Nuk janë deklaruar kursimet si burim për blerjen e kësaj pasurie në këtë DPV.

**4.3** Për burimin e blerjes së këtij automjeti subjekti ka paraqitur kontratë huaje të datës 20.4.2011, sipas së cilës ai ka marrë hua pranë Alpha Bank shumën 10,500 euro, me qëllim financimin<sup>28</sup> për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, me afat 7-vjeçar.

**4.4** DPSHTRR-ja konfirmon<sup>29</sup> të regjistruar në pronësi të subjektit automjetin me targë \*\*\*<sup>30</sup>.

**4.5** Konstatohet se vlera e automjetit është 15,000 euro ku, nga këto, vlera e kredisë është 10,500 euro dhe pjesa tjetër prej 4,500 euro është nga kursimet e subjektit, të cilat janë të paspecifikuara.

**4.6** Nga hetimi rezultoi se me anë të kontratës së huas nr. \*\*\*, datë 20.4.2011, subjekti ka marrë shumën 10,500 euro, me qëllim blerje automjeti tip “\*\*\*\*”. Kësti i pagesës ka qenë 169.69 euro/muaj, pranë Alpha Bank. Huaja ka qenë me afat 7-vjeçar. Kjo hua është akorduar në prill 2011 dhe do të mbaronte në prill 2018. Nga deklarata e Alpha Bank, datë 23.1.2017, konfirmohet se në datën 31.12.2016 ka qenë pa shlyer shuma 2,696 euro.

**4.7** Ndërsa në lidhje me financimin pjesor të blerjes së automjetit në vlerën 4,500 euro, Komisioni i kërkoi subjektit të saktësonte dhe të provonte me dokumentacion justifikues ligjor burimin e shumës 4,500 euro, që ka shërbyer për blerjen e tij.

**4.8** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se burimi i shumës 4,500 euro janë kursime nga pagat dhe të ardhurat nga qiraja, nga fruta-perimet, etj. Shpjegimi i subjektit i referohet edhe përgjigjeve të dërguara në pyetësorin nr. 2, ku kursimet e familjes në vitet 2009 dhe 2010 kanë qenë në vlerën 1,200,000 lekë.

**4.9** Komisioni analizoi mundësinë e krijimit të këtyre kursimeve, nga ku rezultoi se sipas rezultatit financiar negativ të vitit 2010, në të cilin deklarohen për herë të parë kursime *cash* në vlerën 1,200,000 lekë, duket se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kishin burime të ligjshme

<sup>28</sup> Shihni dokumentet bashkëlidhur DV: Plani i shlyerjes së huas dhe marrëveshje për shitje automjeti datë 13.4.2011, sipas së cilës z. Vladimir Skënderi ble nga shoqëria “P” sh.p.k. automjetin tip “\*\*\*\*” kundrejt çmimit 15,000 euro.

<sup>29</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2017 dhe datë 9.8.2017, të DPSHTRR-së.

<sup>30</sup> Shihni dokumentet bashkëlidhur: faturë tatimore shitjeje datë 21.4.2011, nga shoqëria “P” sh.p.k. për z. Vladimir Skënderi, i cili blen automjetin tip “\*\*\*\*” me çmim 15,000 euro.

të mjaftueshme për krijimin e tyre, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të këtij viti. Si rrjedhim, kursimet e deklaruara si burim për blerjen e automjetit në vitin 2011 nuk konsiderohen burim i ligjshëm për shkak të pamjaftueshmërisë financiare për krijimin e tyre.

**4.10** Komisioni analizoi mundësinë e krijimit të shumës 4,500 euro me kursime nga të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortes për periudhën 1.1.2011 – 19.4.2011 dhe nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamjaftueshmëri për pagesën e shumës 4,500 euro për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës në shumën 747,238 lekë.

**4.11** Në këtë analizë financiare nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme të ardhurat e pretenduara nga qiraja e lavazhit, lokalit dhe kultivimi i tokës, për shkak se nuk u vërtetua nga subjekti ligjshmëria e këtyre të ardhurave.

**Analiza financiare e mundësisë së blerjes së automjetit tip “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*, në vlerën 15,000 euro**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Kredi në Alpha Bank	10,500 €
Kursime familjare	0 €
<b>Të ardhura totale</b>	<b>10,500 €</b>
Blerë automjet tip “****” – ***	15,000 €
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-4,500 €</b>

**4.12** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e vlerës totale 15,000 euro, për automjetin tip “\*\*\*\*” të blerë në vitin 2011

**4.13** Në përfundim hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se:

- Ka mospërputhje të DPV-së së vitit 2011 me deklaratën *Vetting* lidhur me burimin për krijimin e kësaj pasurie.
- Subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë automjet tip “\*\*\*\*”.

**4.14** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**4.15** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se në vitet 2009 dhe 2010 është pasqyruar gjendja e parave *cash* në banesë në shumën 1,200,000 lekë, që përbëhet nga kursimet e pagës, qiraja e lavazhit dhe lokalit e të ardhurave nga kultivimi i tokës etj. Këto kursime janë përdorur pjesërisht për: kryerjen e punimeve të brendshme (suvatime, instalime etj.) në banesën në K; pagesën e shumës 4,500 euro në vitin 2011; blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*”, me targë \*\*\* etj. Këto të ardhura subjekti i pretendoi si burime të ligjshme që kanë shërbyer edhe për blerjen e pasurisë automjet.

## Vlerësimi i Komisionit

**4.16** Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti si burim për krijimin e shumës 4,500 euro, këto të ardhura nuk janë konsideruar si të ligjshme për shkak se nuk u arrit të provohet pagimi i detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion provues për të kundërshtuar gjetjen e Komisionit dhe pagimin e detyrimeve tatimore. Si rrjedhim, Komisioni nuk i kategorizoi këto të ardhura të deklaruara si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë automjet.

**4.17** Lidhur me kursimet *cash* të deklaruara në DPV-në e vitit 2010, referuar rezultatit financiar negativ të vitit 2010<sup>31</sup>, në të cilin deklarohen për herë të parë kursime *cash* në vlerën 1,200,000 lekë, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e tyre, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të tjera të këtij viti. Prandaj kursimet *cash* të vitit 2010 nuk u konsideruan si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit në vitin 2011.

**4.18** Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare të mundësisë së krijimit të shumës 4,500 euro, me të cilën subjekti paguan një pjesë të vlerës së automjetit në vitin 2011, referuar reduktimit të shpenzimeve të jetesës, sipas pikës 13.7 të paraqitur në vijim në vendim.

### Analiza financiare e mundësisë së kursimit të shumës 4,500 euro – 19.4.2011

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga subjekti 1.1.2011 – 19.4.2011	300,420
Të ardhura nga paga bashkëshortja 1.1.2011 – 19.4.2011	152,304
<b>Të ardhura totale 1.1.2011 – 19.4.2011</b>	<b>452,724</b>
Shpenzime jetese 1.1.2011 - 19.4.2011	198,201
Shpenzime arsimimi fëmijët	68,560
Shpenzim për kurs gjuhe në Angli - 1,425 \$	149,739
Shpenzime udhëtimi 1.1.2011 – 19.4.2011	47,268
<b>Shpenzime totale 1.1.2011 – 19.4.2011</b>	<b>463,768</b>
Ndryshim likuiditeti 31.12.2010 - 19.4.2011	72,960
Pagese për automjet - 4,500 € - 19.4.2011	622,350
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>(-706,354)</b>

**4.19** Nga analiza financiare, përsëri rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e shumës 4,500 euro për blerjen e automjetit tip “\*\*\*”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të periudhës.

**4.20** Sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie automjet, blerë në vitin 2011, si dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e saj, në vitin 2011, në vlerën -706,354 lekë.

## 5. Gjendje *cash* e subjektit të rivlerësimit

**5.1** Subjekti deklaroi në DPV-në e vitit 2010: “Kursime nga pagat (imja dhe bashkëshortes) dhe të ardhura te tjera të familjes (qira etj.) të vitit 2009, 2010 - 1,200,000 lekë”.

**5.2** Në vitet 2011 – 2014, subjekti nuk deklaroi ndryshime në kursimet familjare në deklaratimet e tij periodike vjetore. Por, në DPV-në e vitit 2011, subjekti, tek rubrika e pasurive deklaroi:

<sup>31</sup> Shihni analizën financiare në pikën 13 të këtij vendimi.

*“Për efekt të marrjes së vizës amerikane për kursin njëmuor 1 - 30.6.2011, kam depozituar përkohësisht nga kursimet e mia në Credins Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank 5,000 \$ dhe 3,500 \$, llogari të cilat janë hapur e mbyllur gjatë vitit 2011”.*

**5.3** Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaroi: *“Më 31.12.2015 kisha gjendje në shtëpi cash, të cilat i mbaj për çdo të papritur, sëmundje, fatkeqësi, etj. - 300,000 lekë”.*

**5.4** Në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: *“Më 31.12.2016 kisha gjendje në shtëpi cash, të cilat i mbaj për çdo të papritur, sëmundje, fatkeqësi, etj. - 300,000 lekë”.*

**5.5** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Kam gjendje cash në shtëpi 300,000 lekë”.*

**5.6** Për të saktësuar gjendjen *cash* dhe likuiditetet në bankë për vitin 2009 – 2010 u pyet subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: *“Në vitin 2009 dhe 2010 është pasqyruar gjendja e parave cash në shtëpi në shumën 1,200,000 lekë, që përbëhet nga kursimet e pagës, qirasë së lavazhit e të lokalit dhe të ardhurave nga kultivimi i tokës etj. Kjo nuk do të thotë se gjendja cash në vitin 2008 ka qenë zero lekë, sepse çdo familje ndan para mënjane për ndonjë të papritur, por gjendja në vitin 2008 e në vitet kur nuk ka deklarim ka qenë nën një milion lekë, e për rrjedhojë nuk ishte e detyruar për deklarim sipas legjislacionit në fuqi. Këto kursime janë përdorur pjesërisht për kryerjen e punimeve të brendshme (suvatime, instalime etj.) në banesën në K; për pagesën e shumës 4,500 euro në vitin 2011 për blerjen e makinës “\*\*\*” me targë \*\*\*; për marrjen e vizës amerikane në vitin 2011, si dhe për nevoja tjera personale e familjare”.*

**5.7** Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti lidhur me gjendjen dhe ndryshimet e kursimeve *cash* deklaroi: *“Për t’iu përgjigjur pyetjes tuaj më duhet t’u referohem deklaratimeve vjetore periodike të pasurisë: në vitin 2010 është deklaruar cash në shumën 1,200,000 lekë. Burimi i krijimit është deklaruar si kursim nga paga ime, e bashkëshortes, si dhe të ardhura qiraje etj., për vitet 2009 dhe 2010”. Për vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 subjekti ka deklaruar se nuk është deklaruar cash sepse gjendja nuk duhet të ketë qenë mbi një milion lekë, shifër kjo e detyrueshme për deklarim. Ndërsa për vitet 2015 dhe 2016 subjekti deklaroi se është deklaruar cash në shumën 300,000 lekë, në secilin vit.*

**5.8** Në analizën financiare, kursimet *cash* janë përfshirë sipas deklaratimit të subjektit në deklaratat periodike vjetore. Për të parë mundësinë e subjektit dhe bashkëshortes për krijimin e gjendjeve të kursimeve *cash* ndër vite, Komisioni duhet t’i referohet analizës financiare të viteve 2010 – 2016 në rezultatet e hetimit.

**5.9** Sa më sipër, Komisioni konstatoi se ka pasaktësi në deklarim nga subjekti lidhur me kursimet familjare/*cash*, ndryshimet e këtyre kursimeve, sqarimin e burimit dhe përdorimit të tyre ndër vite dhe, për këtë arsye, iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**5.10** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Në lidhje me deklaratimin e gjendjes cash është munduar të jetë i saktë, por, formati i DPV-ve nuk ka qenë unik, por ka qenë i ndryshëm në vite të ndryshme. Në vitin 2003 formati kërkonte deklaratimin e gjendjes cash mbi 1 milion lekë, më pas shuma ndryshoi. Herë formati kërkonte deklaratimin vetëm të shtesave*

*e pakësimeve, herë të tjera kërkonte gjendjen cash gjithsej dhe jo veç shtesat e pakësimit. Këto ndryshime të formatit kanë çorientuar subjektet deklaruese, përfshirë mua”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

**5.11** Subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka shpjeguar vështirësitë e të plotësuarit ndër vite të deklaratave periodike, duke mos sqaruar burimin dhe përdorimin e tyre, si dhe ndryshimet e gjendjes *cash* përgjatë viteve.

**5.12** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të pamjaftueshme mbi gjendjen *cash* dhe ndryshimet e saj ndër vite. Lidhur me mundësitë financiare për krijimin e gjendjes *cash* dhe ndryshimet ndër vite, referohuni në analizën financiare për vitet 2003 – 2016, në pikën 13 të këtij vendimi.

## **6. Të ardhurat nga prodhimet bujqësore (pemëtari e serrë) dhe blegtorale në K dhe Gj, Dibër**

**6.1** Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar:

- *Të ardhura për periudhën 1997 – 2016 nga kultivimi i perimeve në serrë dhe në kopsht, nga mbarështimi i shpendëve dhe kafshëve shtëpiake, nga pemët frutore në kopshtin në K në vlerën 8,000,000 lekë (20 vite x 400,000 lekë/vit).*

- *Të ardhura nga kultivimi i perimeve, si dhe të ardhura nga pemët frutore në tokën në Gj, mesatarisht 100,000 lekë/vit që nga vitet 1992 – 2016 në vlerën 2,400,000 lekë (24 vite x 100,000 lekë/vit).*

**6.2** Subjekti dhe bashkëshortja, përveç deklarimit të këtyre të ardhurave, nuk ka paraqitur dokumentacion provues ligjor.

**6.3** ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar se: *“Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat bujqësore e blegtorale në K dhe Gj në shumën totale 10,400,000 lekë, si dhe për këto të ardhura nuk është paguar detyrimi tatimor përkatës”.*

## **Hetimi i Komisionit për krijimin e këtyre të ardhurave**

**6.4** Subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar të ardhura nga prodhimet bujqësore në DPV-të e viteve 2003, 2004 dhe 2005. Për herë të parë, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 të ardhura në vlerat 200,000 dhe 300,000 lekë, përkatësisht nga bahçja në K e Gj. Në deklaratat periodike nga viti 2006 e deri në vitin 2016, këto të ardhura llogariten përkatësisht në 3,200,000 në K dhe 2,000,000 në Gj, Dibër, duke arritur një total prej 5,200,000 lekësh.

**6.5** Pra, të ardhurat e pretenduara në deklaratën *Vetting* nuk përkojnë me të ardhurat e deklaruara në DPV-të deri në deklaratën *Vetting*. Bazuar në këtë konstatim, rezultoi deklarim i pasaktë dhe i pamjaftueshëm në lidhje me vlerat dhe kohën e deklarimit të të ardhurave nga kultivimi i bahçeve në K dhe Dibër.

**6.6** Ndërsa në lidhje me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, Komisioni konstatoi se:

- Në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka nënvizuar: *“Për të ardhurat e tjera nuk më është kërkuar të paguaj tatime”* (duke nënkuptuar, përveç të ardhurave nga paga).

- Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja jam në dijeni se nuk janë paguar tatimet për të ardhurat e siguruara nga*

*kultivimi i fruta-perimeve. Kjo ka ndodhur sepse nuk i është kërkuar që të paguajë taksa për frutat e perimet që kultivon”.*

**6.7** Me qëllim vlerësimit e këtyre të ardhurave, Komisioni i kërkoj subjektit që të saktësonte vlerën e përfituar të këtyre të ardhurave sipas viteve, si dhe të provonte me dokumentacion pagesën e taksës bujqësore, si dhe kopje të mandateve të shitjeve të produkteve bujqësore e blegtorale, që ata kishin realizuar ndër vite.

**6.8** Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar: *“Sa i përket të ardhurave nga kultivimi i tokës në K e Gj, sqaroj se deklarimi në DPV-të është bërë me përafërsi sepse unë nuk kisha mbajtur shënim sasinë e perimeve e frutave që kisha marrë çdo ditë për konsumin e familjes sime sepse nuk e imagjinoja se do më kërkohej ndonjëherë një gjë e tillë. Po kështu, ndonjë vit të ardhurat nga kultivimi i tokës janë harruar të deklarohen në DPV për shkak të pakujdesisë në plotësimin e deklaratës. Për këtë shkak mendoj se për të përcaktuar saktë vlerën e të ardhurave vjetore nga kultivimi duhet marrë në konsideratë akti i ekspertimit teknik vlerësues i datës 10.7.2021 dhe shtesës së aktit të ekspertimit datë 10.8.2021. Sipas këtyre akteve është përcaktuar edhe vlera përkatëse.*

*Produktet e mësipërme nuk janë shitur, por janë përdorur për konsumin e familjes. Nga të gjitha llojet e pemëve frutore dhe perimeve sigurojmë nevojat tona me këto produkte, por nuk kemi shitur në treg. Taksat e pushtetit lokal në K që janë faturuar janë derdhur rregullisht prej nesh, nuk jemi debitorë. Nuk jam në dijeni nëse pjesë e taksave të paguara ka qenë apo jo taksa e tokës, por nëse është faturuar një taksë e tillë është paguar, sepse unë nuk jam debitor pranë Bashkisë K dhe as pranë Bashkisë Bulqizë”.*

**6.9** Në përgjigje të këtij pyetësori subjekti deklaroi se produktet i kanë përdorur për konsumin e familjes dhe nuk kanë shitur në treg. Pra, nuk kanë krijuar të ardhura në vlera monetare, megjithëse ky qëndrim i subjektit është i ndryshëm nga deklarata Vetting dhe përgjigjja e pyetësorit standard.

**6.10** Sa më sipër, vlerat monetare të deklaruara nga subjekti nga të ardhurat bujqësore, për sa kohë janë të pavërtetueshme, si dhe nga fakti se vetë subjekti ka deklaruar se nuk janë përdorur për t’u shitur në treg, ato nuk u bënë pjesë e analizës financiare. Lidhur me provueshmërinë e burimit të ligjshëm të këtyre të ardhura, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**6.11** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Komisioni duhet t’i përfshijë në analizën financiare të ardhurat nga prodhimet bujqësore në K e Gj. sepse ato janë përlllogaritur me ekspert dhe sepse nëse ato nuk do prodhoheshin, do të bliheshin. Kësisoj, mua e familjarëve të mi kjo shumë duhet të na zbritet nga shpenzimet e ushqyerjes. Të mos harrojmë se fruta-perimet zënë rreth 30-40% të shpenzimeve për ushqim të një familjeje”.*

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**6.12** Komisioni, pasi konsideroi shpjegimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit për të ardhurat bujqësore në K e Tiranë, vlerësoi se këto të ardhura të përfituara nuk mund të përfshihen në analizën financiare për shkak se ato janë të pamatshme dhe të pavërtetueshme duke mos plotësuar kushtet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.



**6.13** Gjithashtu, sjellja e akteve të ekspertimeve nuk mund të jetë provë në kuptimin e një prove ligjore, për sa kohë është një dokument i njëanshëm dhe i paraqitur për efekt të procesit të *Vetting*-ut e, për më tepër, kur vetë subjekti ka deklaruar se nuk ka shitur në treg nga këto prodhime.

**6.14** Por, për sa kohë subjekti ka pretenduar se ka përfituar të ardhura bujqësore nga pemëtaria dhe serra, si dhe në shpjegimet përfundimtare të tij të paraqitura para Komisionit ka pretenduar edhe zbritjen nga shpenzimet ushqimore, Komisioni krijoi bindjen se me punën bujqësore, subjekti dhe familja e tij kanë siguruar fruta dhe perime për konsum familjar, prandaj Komisioni mori parasysh dhe përllogariti një reduktim të shpenzimeve jetike<sup>32</sup>.

**6.15** Komisioni reduktoi këtë pjesë të shpenzimeve të jetesës që nga viti 1998, vit në të cilin subjekti ka përfituar tokën bujqësore në Gj., Dibër, sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”.

## **7. Të ardhura nga qiradhënia e lavazhit për periudhën 2004 – 2009 dhe nga qiradhënia e godinës për periudhën 2010 – 2013**

**7.1** Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar:

- *Të ardhura nga qiraja e lavazhit në K., për periudhën 2004 – 2009, në shumën 30,000 në muaj x 12 muaj = 2,160,000 lekë.*

- *Të ardhura nga qiraja e godinës së shërbimit, që ndodhet përballë banesës në K, për periudhën 2010 – 2013 x 600,000 lekë/vit ose 50,000 lekë/muaj për katin e parë e të dytë së bashku. Shuma 2,400,000 lekë.*

**7.2** Subjekti, përveç deklaramit të këtyre të ardhurave, nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion shkresor provues.

**7.3** ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar se: *“Mungon dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e deklaruara në shumën 4,560,000 lekë nga dhënia me qira e lavazhit dhe e godinës në K, si dhe për këto të ardhura nuk është paguar detyrimi tatimor përkatës”.*

### **Hetimi i Komisionit për krijimin e këtyre të ardhurave**

**7.4** Në DPV-të e viteve 2006 – 2009, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e lavazhit, që administron bashkëshortja 360,000 lekë/vit.

**7.5** Në DPV-të e viteve 2010 – 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e lokalit, që administron bashkëshortja 600,000 lekë/vit.

**7.6** Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *“Kam deklaruar në deklaratat periodike vjetore të ardhura nga lavazhi e, më pas, nga lokali që u ndërtua në vend të lavazhit, aktivitetet këto që janë kryer nga bashkëshortja ime, sepse mua si gjyqtar më lejohej vetëm mësimdhënia.*

*Për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja jam në dijeni se nuk janë paguar tatimet as për të ardhurat e siguruar nga kultivimi i fruta-perimeve e as sa i përket qirasë mujore të marrë nga lavazhi e më pas nga lokali. Kjo ka ndodhur sepse nuk i është kërkuar që të paguajë taksë për frutat e perimet që kultivon. Po kështu, në kohën që merrte të ardhura nga qiraja e lavazhit*

---

<sup>32</sup> Shihni rubrikën e shpenzimeve tek pika 14 e këtij vendimi (Metodologjia).

*dhe dyqanit nuk ka pasur kontratë qiraje të shkruar dhe nuk i është kërkuar nga zyra tatimore që të paguajë tatime në një zonë informale sikurse ishte K. Prej 8 vitesh lokali është mbyllur dhe nuk ushtrohet aktivitet e nuk është vjelur qira”.*

**7.7** Komisioni, pas përgjigjes së dërguar nga Drejtoria e Tatimeve<sup>33</sup>, nuk konstatoi pagime të detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e pretenduara nga dhënia me qira e lavazhit. Ndodhur në kushtet kur këto të ardhura nuk janë të vërtetueshme për shkak të mosdeklarimit në organet tatimore e, për pasojë edhe të mosshlyerjes së detyrimeve përkatëse, Komisioni nuk i përfshiu në analizën financiare këto të ardhura të deklaruara për këto vite.

**7.8** Komisioni nënvizon faktin se ushtrimi i një aktiviteti apo lënia me qira e një objekti me qëllim fitimi nga ana e subjektit, në mungesë totale të një kontrate dhe pagimit të detyrimeve financiare pranë organeve tatimore, shihet si veprim i qëllimshëm dhe i kundërligjshëm që në dukje cenon figurën e magjistratit.

**7.9** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**7.10** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar se: *“Të ardhurat nga qiraja e lavazhit dhe godinës janë ato që janë deklaruar. Mosnjohja e këtyre të ardhurave për shkak se nuk janë paguar taksat mendoj se nuk duhet të më penalizojë. Kujtoj se këto pasuri kanë qenë në K, e cila ka qenë e njohur për informalitetin e saj. Në kushtet kur nuk kërkohej e nuk faturohej nga pushteti vendor a qendror detyrim tatimor, nuk kisha sesi t’i kryeja ato pagesa. Me vërtetimin e lëshuar nga Bashkia K. provoj se nuk jam debitor e nuk kam taksa të papaguara, por kjo nuk do të thotë se ato aktivitete nuk kanë ekzistuar e se nuk janë siguruar të ardhura. Të ardhura kam siguruar edhe nga kursi i anglishtes që bënte E, vërtetuar kjo me këtë certifikatë të lëshuar në datën 22.6.2012.*

*Mungesa e kontratës së shkruar të qirasë nuk mendoj se cenon figurën e magjistratit sepse edhe kontrata verbale apo me veprime konkludente janë mënyra të ligjshme kontraktimi të njohura nga Kodi Civil, i cili në nenin 80 përshkruan format e veprimit juridik (kontratës) “Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdolloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit. Shkresa mund të jetë e thjeshtë ose akt noterial”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**7.11** Pas shpjegimeve përfundimtare të subjektit në lidhje me të ardhurat e përfituara nga qiraja e lavazhit dhe më pas e lokalit, Komisioni, nga pikëpamja administrativo-ligjore, nuk mund të pranojë argumentimin që subjekti paraqet duke deklaruar vetëm se *“...nuk jam debitor e nuk kam taksa të papaguara”.*

**7.12** Sigurisht që Komisioni vlerëson se mungesa e kontratës së shkruar të qirasë nuk cenon figurën e magjistratit, por ky mosveprim ka sjellë shmangien dhe mospagimin e detyrimeve

---

<sup>33</sup> Shihni përgjigjen e Drejtorisë së Tatimeve në dosjen e Komisionit.

financiare pranë organeve tatimore (subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar të ardhurat e përfituara në mënyrë që të paguheshin edhe detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit).

**7.13** Legjislacioni fiskal përcakton se subjektet fizike dhe/ose juridike, të cilat krijojnë të ardhurat në Republikën e Shqipërisë, duhet t'i deklarojnë ato dhe për to duhet të paguajnë një detyrim tatimor të caktuar, sipas nivelit të të ardhurave që ata realizojnë.

**7.14** Komisioni e konsideron të papranueshëm faktin që subjekti i rivlerësimit (magjistrat) justifikohet me mosrespektimin e detyrimeve ligjore, duke marrë në konsideratë informalitetin e ndeshur në Shqipëri, kur ai duhet të ishte modeli i respektimit të ligjit.

**7.15** Në përfundim, Komisioni vlerëson se për sa kohë këto të ardhura nuk plotësojnë kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ato nuk mund të jenë pjesë e analizës financiare të subjektit dhe, si të tilla, nuk mund të kategorizohen si të ardhura të ligjshme.

## **8. Deklarimi i vajzës së subjektit, znj. E.R (S)**

**8.1** Vajza e subjektit ka deklaruar të ardhura nga punësimi si pedagoge që nga viti 2013, ndërsa shuma e kursyer është deklaruar vetëm në vitin 2016, gjendje *cash* më 31.12.2016, shuma 1,400,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Ajo nuk ka pasuri të paluajtshme e as të luajtshme të regjistruara në emrin e saj. Ajo ka deklaruar se banon me qira në rrugën “\*\*\*\*”, përballë shkollës “\*\*\*\*”, Tiranë.

**8.2** Të ardhurat nga puna e saj si pedagoge<sup>34</sup> në Universitetin \*\*\* (2014 – 31.12.2016) dhe në universitetin “\*\*\*\*” (tetor 2013 – 31.12.2016) janë përkatësisht në shumat 1,670,327 lekë dhe 694,256 lekë, në total 2,364,583 lekë.

**8.3** ISSH-ja ka konfirmuar periudhë kontributive për znj. E.S (R) për periudhën mars 2014 – prill 2017, pranë universitetit “\*\*\*\*” dhe Fakultetit të \*\*\*.

**8.4** Subjekti ka deklaruar se vajza e tij E është martuar në vitin 2011 dhe shkëputur nga trangu familjar<sup>35</sup> në datën 4.5.2012.

**8.5** I pyetur nga Komisioni, nëse ai dhe bashkëshortja e tij kanë kontribuar për krijimin e likuiditetit (gjendje *cash* 1,400,000 lekë) të deklaruar nga vajza e tij e martuar dhe, nëse po, sa ka qenë kontributi i shoqëruar me dokumentacion provues, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se nuk kanë kontribuar më, pasi vajza e tyre ka dalë si familje më vete.

**8.6** I pyetur rreth burimit të ligjshëm të vajzës për krijimin e pasurisë gjendje *cash* në datën 31.12.2016 në shumën 1,400,000 lekë, subjekti deklaron: “*Nga deklaratat periodike e vitit 2016, konstatoj se E. është paguar për punën në shumat 642 mijë lekë dhe 210 mijë lekë, pra gjithsej 852 mijë lekë. Gjendja cash ishte e E. dhe e bashkëshortit, pra pjesa e E. 50% = 700 mijë lekë, është e justifikuar me pagat e mësipërme. Shpjegime më të detajuara ka dhënë vetë E. në deklaratën noteriale të datës 18.5.2023 nga E.S*”. Në këtë deklaratë noteriale vajza e subjektit konfirmon thëniet e subjektit.

<sup>34</sup> Shihni në dosjen e ILDKPKI-së: vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017 të UT-së dhe vërtetimin nr. \*\*\*, datë 4.11.2016, të \*\*\* dhe dokumentin nxjerrje llogarie të Alpha Bank datë 24.1.2017.

<sup>35</sup> Shihni certifikatat e sjella nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 (certifikatë martesë të vajzës E. me Xh. R. dhe certifikatë familjare të subjektit).

**8.7** Komisioni analizoi mundësinë e vajzës së subjektit E.R për të krijuar kursimet e deklaruara *cash* në shumën 1,400,000 lekë. Në analizën e kësaj mundësie janë përfshirë të ardhurat neto nga puna e vajzës së subjektit që rezultojnë nga përgjigjja e ISSH-së<sup>36</sup> në hetimin e Komisionit.

#### **Analiza e mundësisë së vajzës E.R për kursim, në vlerën 1,400,000 lekë**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura nga puna E. 2014 – 2016	2,070,092
Shpenzime jetese 2 persona 2014 – 2016	1,358,732
Kursime <i>cash</i> - 31.12.2016	1,400,000
<b>Pamundësia për kursim</b>	<b>-688,640</b>

**8.8** Bazuar në analizën financiare, rezultoi se personi i lidhur, vajza e subjektit, nuk kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash* në shumën 1,400,000 lekë dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për të dhe bashkëshortin e saj.

**8.9** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**8.10** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Lidhur me deklaratimet e vajzës sime E.S (R) kam dhënë shpjegime ku kam deklaruar se vajza ime që nga dita që është martuar ka shkëputur çdo lidhje ekonomike me ne, familjen e saj të origjinës. Megjithatë, sot, në përmbushje të barrës së provës së caktuar nga Komisioni, po ju paraqes vendimin e Gjykatës Administrative Tiranë, i cili u ka dhënë përgjigje shteruese këtyre pretendimeve dhe ka pranuar kërkesëpadinë e sime bije”*.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**8.11** Komisioni doli në konkluzionin se pamundësia financiare e vajzës dhe familjes së saj nuk ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Subjekti deklaroi dhe provoi se vajza e tij ishte e shkëputur nga trangu i familjes dhe se ai e bashkëshortja e tij nuk kishin kontribuar për krijimin e pasurisë të bijës së tyre.

#### **9. Deklarimi i djalit të subjektit, z. E.S**

**9.1** Djali i subjektit, E.S, ka deklaruar se nuk ka pasuri të paluajtshme e as të luajtshme të regjistruar në emrin e tij. Ai ka deklaruar adresë banimi \*\*\* (\*\*\*), \*\*\*, New York, SHBA.

**9.2** Shtetasi E.S ka deklaruar gjendje *cash* me datë 31.12.2016, në vlerën 10,000 USD, gjendje e cila është pjesë e huas që ka marrë nga vjehri i tij B.M, si dhe nga puna e kryer në SHBA. Pjesa takuese: 50%.

**9.3** Gjithashtu ka deklaruar se në datën 31.12.2016 kishte gjendje depozite në ABI Bank 50 USD dhe në Ch. Bank në SHBA, përafërsisht 3,700 USD. Deklaron se zotëron 50%. Në momentin e plotësimit të deklaratës ai deklaroi se ka qenë në Shqipëri dhe e ka pasur objektivisht të pamundur të paraqiste *statement* bashkëngjitur për këto dy depozita.

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.7.2022, nga ISSH-ja.

**9.4** Të ardhurat e djalit E.S janë deklaruar nga paga në shumat 240 euro dhe 7,000 USD, për të cilat ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor.

**9.5** Subjekti ka deklaruar se djali i tij E. është martuar në vitin 2015 dhe është shkëputur nga trangu familjar në datën 28.9.2015.

**9.6** Subjekti është pyetur edhe për djalin në lidhje me kontributin për krijimin e likuiditetit (gjendje *cash* 10,000 USD) të deklaruar nga djali i tij i martuar dhe, nëse po, sa ka qenë kontributi i subjektit, shoqëruar me dokumentacion provues. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja e tij nuk kanë kontribuar më, pasi ai ka dalë si familje më vete.

**9.7** Por, në deklaratën *Vetting*, djali i subjektit E.S ka deklaruar në seksionin “Detyrime financiare” huan në vlerën 34,000 USD dhe Komisioni, gjithsesi, për shkak të kohës së afërt nga shkëputja nga trangu familjar me subjektin, por, edhe duke u bazuar në deklarinimin e këtij të fundit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 deklaron se *paratë në formë dhurate (12,000 euro dhe 1,500,000 lekë, të dhuruara respektivisht në dasmat e fëmijëve të tij) janë depozituar në bankë apo përdorur nga fëmijët sipas nevojave të tyre si familje të reja*, hetoi në lidhje me këtë hua.

**9.8** Në deklaratën *Vetting*, djali i subjektit ka deklaruar se në datën 31.12.2016 ka të pashlyer detyrimin në shumën 34,000 USD, marrë hua sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 7.12.2015, me qëllim vazhdimin e studimeve master.

**9.9** ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të huadhënësit B.M për huan në shumën 34,000 USD, dhënë për studime master në SHBA djalit të subjektit, E.S.

**9.10** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 7.12.2015, sipas së cilës shtetasi B.M, me aktivitet tregtar në supermarketin “M” në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, deklaron se i jep shtetasit E.S hua në shumën 34,000 USD për të financuar studimet master 2-vjeçar në SHBA, me të drejtë kthimi pas 7 vitesh.

**9.11** DRT-ja Tiranë<sup>37</sup> ka konfirmuar se shtetasi B. Xh. M. rezulton i regjistruar me NIPT \*\*\*, “B.M” person fizik me aktivitet “kafene dhe bar-bufë”. Vërtetimi jep informacion mbi xhiron e deklaruar ndër vite nga të dhënat e disponuara në sistemin tatimor C@TS në lidhje me deklaratën e Tatimit të Fitimit të Thjeshtuar.

**9.12** Subjekti nuk shpërndan dividend bazuar në UMF-në nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, sepse është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin<sup>38</sup>.

**9.13** ISSH-ja ka konfirmuar periudhë kontributive për shtetasin B.M për periudhën janar 2012 – janar 2017, pranë personit fizik “B.M” me NIPT \*\*\*, me pagë neto minimale.

**9.14** Nga përpunimi i të dhënave që vijnë nga organet tatimore për subjektin privat “B. M.” person fizik, Komisioni analizoi mundësinë e shtetasit B. M. që me të ardhurat nga biznesi i tij

<sup>37</sup> Nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>38</sup> Bashkëlidhur: vendim për regjistrimin si person fizik, datë 14.9.2006 + kërkesë e datës 12.9.2006, i B.M për regjistrim si person fizik dhe formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël për vitet 2008 – 2016; formulari i detyrimeve në kohë reale të aktivitetit me NIPT \*\*\*, me adresë në rruga “\*\*\*”, Tiranë.

t'i japë hua djalit të subjektit E.S shumë 34,000 USD në dhjetor të vitit 2015, paraqitur në tabelën si më poshtë:

#### **Analiza e mundësisë së huadhënies B. M - 34,000 USD**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhura nga biznesi 2008 – 2015	3,121,414 lekë
Shpenzime jetese 2008 – 2015	1,271,326 lekë
Huadhënie E.S - 34,000 USD	4,305,760 lekë
<b>Pamundësia financiare</b>	<b>-2,455,672 lekë</b>

**9.15** Sipas analizës financiare rezultoi se shtetasi B. M. nuk kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas prej 34,000 USD djalit të subjektit të rivlerësimit në dhjetor të vitit 2015, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të jetesës.

**9.16** Lidhur me pasuritë (likuiditete) të deklaruara nga djali i subjektit në deklaratën *Vetting*, përkatësisht 10,000 USD *cash* dhe 3,700 USD në Ch Bank, SHBA, subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Vlera 10,000 USD deklarohet si tepricë e huas së marrë nga djali i subjektit vjehrrit të tij B. M., mundësia e të cilit për huadhënie nuk u vërtetua me dokumentacion.

**9.17** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**9.18** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Prej 6 vitesh, që nga dita që është martuar E., bashkë me familjen e tij ka shkëputur çdo lidhje ekonomike me ne si prindër. Ata jetojnë e punojnë në Finlandë. Në lidhje me pamundësinë e vjehrrit të tij për të financuar pjesërisht studimet e E., theksoj se supermarketi “M” nuk është e vetmja pasuri e tij, pasi ai ka banesë e prona tjera. Mundësia apo pamundësia financiare nuk mendoj se mund të matet mbi bazën e taksave të paguara, po të mbajmë parasysh informalitetin e ekonomisë shqiptare. Kam paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj me shkresën e datës 13.6.2023. Në lidhje me gjendjen e parave të E. në bankë, ato janë deklaruar periodikisht në deklaratat vjetore”.*

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**9.19** Komisioni vlerësoi se subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit nuk arriti të vërtetonte mundësinë e huadhënësit B. M për dhënien e hua të shumës 34,000 USD në vitin 2015.

**9.20** Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion bankar të vërtetimit të llogarisë së deklaruar në emër të djalit të tij pranë Ch Bank në SHBA. Ai ka paraqitur vetëm dokumentacion për kostot e studimit të djalit E.S në SHBA, si dhe dokument mbi një garanci të dhënë për të nga shtetasi J. S. A.

**9.21** Subjekti nuk arriti të vërtetojë as ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara nga djali E.S në SHBA, por Komisioni vlerëson se këto pamundësi nuk afektojnë drejtpërdrejt subjektin e rivlerësimit, për sa kohë u vërtetua se djali i tij ka qenë i ndarë nga trangu familjar, si dhe subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë kontribuar në krijimin e këtyre të ardhurave të djalit të tyre.

## 10. Dhuratat nga dasmat e fëmijëve E.R.S (2011) dhe E.S (2015)

10.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti, tek seksioni i të ardhurave, ka deklaruar:

- *Të ardhura nga dhuratat me vlerë nën 10,000 lekë secila, të mbledhura në dasmën e vajzës E në vitin 2011, në shumën 12,000 euro.*
- *Të ardhura nga dhuratat me vlerë nën 10,000 lekë secila, të mbledhura në dasmën e djalit E në vitin 2015, në shumën 1,500,000 lekë.*

10.2 ILDKPKI-ja ka konstatuar se mbeten të padokumentuara shumat 12,000 euro dhe 1,500,000 lekë, të deklaruara si dhurata me rastin e martesës së fëmijëve E dhe E.

10.3 Për të vlerësuar këto të ardhura me burim nga dhuratat e dasmave të fëmijëve, duke qenë se subjekti ka deklaruar se këto shuma i ka depozituar në bankë dhe pastaj ia ka dhënë fëmijëve, Komisioni bëri një hetim lidhur me këtë çështje.

10.4 Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *“Dhurata me vlerë deri në 10,000 lekë secila nga dasma datë 6.8.2011 e vajzës E, të cilat i kam depozituar në emrin e saj në Alpha Bank. Këto dhurata janë sjellë nga të afërm, miq e kolegë të mi, bashkëshortes e vajzës ditën e dasmës dhe para saj kur vinin për të na uruar 12,000 euro”*.

10.5 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura nga dasma e djalit, E, të krijuara nga darovitjet para dhe gjatë banketit, si dhe peshqeshet me vlerë nën 10,000 lekë, sjellë nga të afërm, shokë, miq, e kolegë që vinin për urim 1,500,000 lekë”*. Po në këtë DPV subjekti ka deklaruar: *“Kam kryer shpenzime për dasmën e djalit tim E. 1,000,000 lekë”*. Ndërsa nuk ka deklaruar shpenzime me vlerë të caktuar për dasmën e vajzës.

10.6 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se i ka dhënë vajzës shumën 1,200,000 lekë, që u mbledhën ditën e dasmës, të cilat i ka përdorur për qëllime shkollimi.

10.7 Nga dokumentacioni bankar u evidentua se subjekti në vitin 2011 ka bërë veprimet e mëposhtme bankare në llogarinë e tij, në monedhën euro, pranë Alpha Bank, përkatësisht:

- 7,915 euro derdhur nga subjekti në datën 30.11.2011;
- 3,955 euro derdhur nga subjekti në datën 12.12.2011;
- 12,000 euro kalim nga subjekti tek E.S për shkollim, me datë 12.12.2011.

10.8 I pyetur që të deklaronte dhe provonte burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre shumave të depozituara, subjekti në përgjigje të pyetësorit<sup>39</sup> ka deklaruar: *“Darovitjet dhe qokat nga dasma e vajzës së madhe E. në shumën 12,000 euro ia kemi lënë asaj si pjesë e pajës. Këtë shumë parash e kam depozituar në Alpha Bank në dy këste, në shumat 7,915 euro dhe 3,955 euro. Për të provuar këto të ardhura i janë vënë në dispozicion ekspertit kriminalist disqet e dasmave dhe ai ka përpiluar aktet e ekspertimit teknik nr. \*\*\*, datë 17.12.2021 dhe nr. \*\*\*, datë 19.1.2022<sup>40</sup>”*.

<sup>39</sup> Shihni përgjigjen mbi pyetësorin nr. 2 të dërguar nga subjekti.

<sup>40</sup> Shihni aktet e ekspertimeve të sjella nga subjekti bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit nr. 2. Subjekti ka paraqitur dy akt ekspertime (për dy dasmat e fëmijëve), të cilat kanë të bëjnë me ekspertimin teknik të DVD-ve të pamjeve filmike të dy dasmave të fëmijëve. Nëpërmjet këtyre dy akt ekspertimeve të përgatitura nga eksperti kriminalist Xh. Ç. deklarohet se nga regjistrimet video (foto të ekzaminuara) të ruajtura në kompakt disk të dasmave të E (2011) dhe E (2015) janë konstatuar dhe evidentuar disa momente në të cilat vihen re dasmorë që hedhin kartëmonedha të prerjeve të ndryshme.

**10.9** Duke parë këto dy akte ekspertime nga pikëpamja teknike dhe ligjore, të paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerësoi se një gjë e tillë nuk përbën provë për dokumentimin e vlerave reale të përfituara.

**10.10** Referuar parimit të deklaramit të të ardhurave në mënyrë të dokumentuar e për të cilat të jenë paguar detyrimet tatimore, si dhe referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, këto të ardhura të deklaruara nga dasmat e fëmijëve, për sa kohë mbeten të padokumentuara, nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.

**10.11** I pyetur për shpenzimet e kryera për dasmën e vajzës E.S në vitin 2011, subjekti deklaroi: *“Shpenzimet e banketit për dasmën e E. kanë qenë afërsisht në shumën 300 mijë lekë. Shpenzimet e tjera nuk kanë kaluar shumën 200 mijë lekë, pra në total kanë qenë më pak se 500 mijë lekë. Nuk janë deklaruar në deklaramin e vitit 2011 sepse deklarata e atij viti kërkonte deklaramin vetëm të shpenzimeve me vlerë mbi 500 mijë lekë”.*

**10.12** Vlerat e deklaruara nga subjekti si të dhuruara vajzës (12,000 euro) në vitin 2011 dhe djalit (1,500,000 lekë) në vitin 2015 janë përfshirë si shpenzime në vitet përkatëse të analizës financiare, meqë subjekti i deklaroi vetë si shuma të paguara prej tij në ato vite.

**10.13** Vlerat e deklaruara nga subjekti si shpenzime të bëra për dasmat e vajzës (500,000 lekë) në vitin 2011 dhe djalit (1,000,000 lekë) në vitin 2015, janë përfshirë si shpenzime në vitet përkatëse të analizës financiare, meqë subjekti i deklaroi vetë si shpenzime të kryera në ato vite.

**10.14** Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se nuk vërtetohet burimi i ligjshëm i derdhjeve bankare të bëra nga subjekti në shumat 7,915 euro dhe 3,955 euro, të cilat kanë shërbyer për shumat e kaluara vajzës së tij, në vlerë totale prej 12,000 euro, në datën 12.12.2011. Për Komisionin nuk dukej bindës fakti se paratë e dhuruara nga të ftuarit në dasmën e bërë në gusht të vitit 2011 janë depozituar në bankë disa muaj më vonë.

**10.15** Gjithashtu, Komisioni konstatoi se nuk vërtetohet ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara nga dhurimet e bëra nga qokat e dasmave të vajzës dhe djalit të subjektit në vitet 2011 dhe 2015.

**10.16** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**10.17** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Me të drejtë ILDKPKI-ja ka nënvizuar se mbeten të padokumentuara këto të ardhura, sepse aktin e ekspertimit kriminalistik të kryer nga eksperti Xh. C. e kam depozituar vetëm pranë jush dhe jo në ILDKPKI. Në lidhje me barrën e provës së kaluar nga Komisioni për këto të ardhura, deklaroj se provë janë dy aktet e ekspertimit kriminalistik të ekspertit Xh. C. që kam paraqitur, dokumentet bankare për derdhjen e këtyre shumave që në atë kohë, deklaramet periodike vjetore, ku i kam deklaruar këto shuma në kohë reale e jo pas fillimit të Vetting-ut. Shpresoj që këto prova të gjenden të mjaftueshme nga ju”.*



## Vlerësimi i Komisionit

**10.18** Pas shpjegimeve përfundimtare të subjektit, Komisioni arriti në vlerësimin dhe përfundimin se nuk vërtetohet ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara nga dhurimet e bëra nga qokat e dasmave të vajzës dhe djalit të subjektit në vitet 2011 dhe 2015 dhe, si të tilla, ato nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare.

**10.19** Nuk u vërtetua burimi i derdhjeve bankare të bëra nga subjekti në shumat 7,915 euro dhe 3,955 euro, të cilat kanë shërbyer për shumat e kaluara vajzës së subjektit në vlerën totale prej 12,000 euro, në datën 12.12.2011, duke mos bindur Komisionin se paratë e dhuruara nga të ftuarit në dasmën e bërë në gusht të vitit 2011 janë depozituar në bankë disa muaj më vonë.

## GJETJE TË TJERA

### 11. Lidhur me dy automjete

**11.1** Subjekti, në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003, ka deklaruar: *“Autoveturë \*\*\* \*\*\*, e regjistruar në emër të shitësit B.S, kontratë shitjeje materiale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.5.2002, 0,5 milion lekë, blerë në vitin 2002 në vlerën 100,000 lekë (ishte e dëmtuar dhe me rregullimet 400,000 lekë, vlera totale vajti 500,000 lekë). Burimi: kursimet nga paga ime dhe e bashkëshortes”*.

**11.2** Komisioni konstatoi se subjekti në vitin 2001 ka blerë edhe një automjet tjetër me targë \*\*\*, të cilin nuk e ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2003.

**11.3** Për të saktësuar çështjen lidhur me këto dy pasuri automjete, u pyet subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 3 deklaroi: *“Automjeti tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\* është i njëjti automjet që më parë kishte targën \*\*\*. Ky automjet i përdorur më është shitur nga shtetasi E. Q., në shumën 500,000 lekë. Në kontratën nr. \*\*\*, datë 26.12.2001, është shënuar si dhurim dhe kjo është bërë me kërkesë të shitësit, gjë që nuk u kundërshtua prej meje sepse për mua e rëndësishme ishte të më kalonte pronësia e mjetit. Rreth 1 vit pasi e kam blerë automjetin, kam kërkuar të bëj kontrollin teknik dhe kam konstatuar se targa \*\*\* nuk i përkiste automjetit që kisha blerë unë. Kërkova të kontaktoj me shitësin për t’i kthyer makinën e për të anuluar shitjen, por ai ndodhej në emigracion. Pronari i servisit ku i bëja shërbimet makinës mori përsipër që të gjente dokumentet e sakta të mjetit dhe pas asaj dite makina ime (e njëjta makinë që kisha blerë nga E. Q.) kishte targën \*\*\*. Këtë targë kishte edhe ditën kur e shita për skrap te shtetasi A. L., në datën 24.10.2007. Së fundmi, nga email-et e shkëmbyera me DPSHTRR-në kam mësuar se edhe kjo targë \*\*\* nuk paska qenë targa e saktë e se unë nuk kam figuruar si pronar i asaj makine”*.

**11.4** DPSHTRR-ja<sup>41</sup> nuk i ka konfirmuar këto dy pasuri automjete si pasuri të subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi (duket se nuk janë regjistruar asnjëherë në emër të subjektit pranë DPSHTRR-së).

---

<sup>41</sup> Shihni përgjigjet e DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit dhe dosjen e ILDKPKI-së.

**11.5** Komisioni, nga përgjigja e subjektit dhe mungesa e informacionit për pasurinë automjet me targë \*\*\*, ripyeti subjektin sipas pyetësorit nr. 4.

**11.6** Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti deklaroi: *“DPSHTRR-ja refuzoi të më japë informacion në lidhje me automjetin \*\*\*, për shkak se ky automjet nuk figuronte në emrin tim. Bashkëlidhur po ju nis dokumentacionin e plotë dhe origjinal të automjetit me targë \*\*\*...”*.

**11.7** Gjithashtu, Komisioni i kërkoi shpjegime dhe kopje të dokumentacionit (kontratën e blerjes) për pasurinë automjet me targë \*\*\*, blerë në vitin 2002 nga shtetasi B. S. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit kopje të kontratës së kërkuar.

**11.8** Bazuar në përgjigjen me *email* të DPSHTRR-së<sup>42</sup>, datë 18.5.2023, dërguar subjektit të rivlerësimit, konstatohet se automjeti me targë \*\*\* nuk ka qenë dhe nuk është regjistruar asnjëherë në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

**11.9** Në datën 22.6.2023, subjekti ka paraqitur prova shtesë për pyetësorin nr. 4, si vijon:

- Deklaratë noteriale<sup>43</sup> datë 16.6.2023, të shtetasit B. S., i cili deklaroi se nuk kujtohet se ka pasur ndonjë automjet me targë \*\*\*, por që është kujtuar pas konsultimit me shoferët që ka pasur. Gjithashtu, sipas shtetasit B. S. deklarohet: *“...mbaj mend që në vitin 2002 më ka ardhur një pronar servisi nga Vlora, i cili më shpjegoi se ka në servisin e tij një \*\*\* të cilit po i kryen disa shërbime, por është pa dokumente të rregullta. Pronari i servisit kishte marrë dijeni se dokumentet e rregullta të \*\*\* që kishte në servis ndodheshin në magazinën e biznesit tim. Ai kërkoi t'i blinte dokumentet dhe targat e automjetit \*\*\* dhe unë mbaj mend që ia kam shitur në vlerën 100,000 lekë. Nuk mbaj mend nëse kam bërë ndonjë kontratë për këtë shitje të dokumenteve dhe të targave apo jo”*.
- Akt ekspertimi autoteknik të ekspertit, ing. N.H<sup>44</sup>.

**11.10** Me analizimin edhe të përgjigjes së pyetësorit nr. 4, Komisioni ka vlerësuar se:

- Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë veprimet e kryera dhe blerjen e këtyre dy pasurive.
- Veprimet dhe deklaratimet e tij janë kontradiktore mbi këto pasuri. Subjekti ka pasur dy pasuri të ndryshme automjete, një të përfituar me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.5.2002, në vlerën 100,000 lekë, nga shtetasi B. S. dhe tjetrën të përfituar me kontratën e dhurimit nr. \*\*\*, datë 26.12.2001, nga shtetasi E. Q.
- Subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit kontratën e blerjes së automjetit të vitit 2002 me shtetasin B. S. Subjekti nuk provoi që bëhet fjalë për të njëjtën pasuri automjet.
- Këto dy pasuri automjete duken se janë pasuri të ndryshme dhe subjekti është munduar ta shfaqë si një pasuri të vetme.
- Subjekti nuk ka bërë asnjë përpjekje për regjistrimin e këtyre dy pasurive pranë DPSHTRR-së në emër të tij dhe nuk ka paguar as detyrimet në buxhetin e shtetit për këto pasuri automjete. Subjekti duket se ka përdorur disa vite automjete të paregjistruara

<sup>42</sup> Shihni përgjigjen me *email* të DPSHTRR-së në praktikën e pyetësorit nr. 4 dërguar nga subjekti.

<sup>43</sup> Shihni deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 16.6.2023.

<sup>44</sup> Shihni aktin e ekspertimit autoteknik të provat shtesë për pyetësorin nr. 4, paraqitur nga subjekti në datën 22.6.2023.

dhe me targa dhe dokumentacione të rreme dhe nuk ka paguar as detyrimet vjetore financiare pranë institucione shtetërore (shitur njërin automjet në datën 24.10.2007).

- Subjekti, edhe pse është vënë në dijeni, nuk ka vepruar për t'ia adresuar zgjidhjen organeve shtetërore lidhur me marrjen dijeni të veprimeve të pasakta dhe të pavërteta mbi këto dy automjete. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur asnjë kallëzim, edhe pas vënies në dijeni të targave dhe dokumenteve false ndaj palëve shitëse të automjeteve (që nga viti 2002).
- Subjekti nuk ka paraqitur asnjë të dhënë apo shpjegime lidhur me servisin që pretendon se i ka përgatitur letrat dhe targën \*\*\*, si dhe shpjegime pse i drejtohet një servisi për pajisje me targë automjeti dhe jo organit shtetëror kompetent (DPSHTRR).

**11.11** Rezultoi se subjekti ka bërë veprim fiktiv, duke deklaruar kontratën nr. \*\*\*, datë 26.12.2001, si kontratë dhurimi dhe jo kontratë shitjeje, siç e deklaroi edhe vetë. Subjekti nuk ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në vlerën 500,000 lekë. Subjekti pranon që të paktën 1 vit që nga momenti i blerjes së kësaj pasurie në vitin 2001 nuk ka bërë asnjë veprim për ta regjistruar në emër të tij pranë DPSHTRR-së.

**11.12** Subjekti ka bërë deklarime të pasakta mbi këto dy pasuri automjete, si dhe me veprimet dhe mosveprimet e tij të qëllimshme dhe të kundërligjshme ka kryer shkelje që komprometojnë figurën e tij si magjistrat i Republikës së Shqipërisë.

**11.13** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**11.14** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Në lidhje me këto dy pasuri automjete: \*\*\* dhe \*\*\*, theksoj se ka qenë vetëm një automjet që fillimisht e kishte targën \*\*\* dhe më pas i njëjti automjet mori targën \*\*\*. Një fakt i tillë nuk duhet besuar thjesht dhe vetëm pse e deklaroj unë dhe e kam deklaruar edhe në kohën e plotësimit të DPV-ve respektive, por vërtetohet edhe me aktin e ekspertimit të ekspertit, ing. N. H., i cili ka krahasuar fotot e mjetit me targa të ndryshme dhe ka gjetur 9 karakteristika të njëjta. Ishte ky shkaku që eksperti konkludoi se nuk ka pasur dy automjete, por vetëm një. Ky akt ekspertim ishte në harmoni me deklaratën noteriale të shtetasit B. S. dhe me deklaratimet e mia”.*

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**11.15** Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti nuk përmbysi barrën e provës, si dhe nuk shpjegoi bindshëm arsyet që kanë çuar në këtë situatë konfuze dhe komprometuese të tij në lidhje me dy pasuritë automjete të blera në vitet 2001 e 2002, të cilat i ka mbajtur pa dokumentacion dhe pa regjistruar pranë DPSHTRR-së, si dhe pa kryer veprimet përkatëse kur ka konstatuar problematika për këto dy automjete.

**11.16** Në përfundim, Komisioni, bazuar në rezultatet e hetimit mbi këtë pasuri, vlerësoi se subjekti ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për pasuritë automjet dhe ka vazhduar të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë veprimet e kryera. Veprime të tilla të kryera nga subjekti i rivlerësimit komprometojnë figurën e tij në cilësinë e gjyqtarit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në vlerësimin përfundimtar të tij.

## **12. Pasuri automjet në përdorim**

**12.1** Subjekti në deklaratën *Vetting* nuk ka deklaruar pasuri automjet në përdorim.

**12.2** Nga të dhënat e sistemit TIMS<sup>45</sup> rezultoi se subjekti dhe persona të lidhur kanë dalë jashtë vendit me automjetin me targë \*\*\*. Përkatësisht, subjekti ka dalë jashtë vendit, duke qenë edhe drejtues i këtij automjeti, në datat 27.11.2009, 30.11.2009, 11.12.2009, 22.3.2011 dhe 28.7.2014. Gjithashtu, ky automjet është përdorur edhe nga familjarët e subjektit dhe djali i tij E.S.

**12.3** Bazuar në të dhënat e nxjerra nga AMF-ja<sup>46</sup>, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është mbajtes i policës së sigurimit si përdorues i automjetit tip “\*\*\*\*” me targë \*\*\*, për disa vite.

**12.4** Lidhur me përdorimin e këtij automjeti, mosdeklarimin në përdorim, pronarin dhe burimin e krijimit, është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 4<sup>47</sup> deklaroi: *“Automjeti me targë \*\*\* ka qenë në pronësi të vëllait tim I.S. Ai dhe bashkëshortja janë në profesion mjekë dhe puna ku punon i siguron automjet dhe karburant falas. Për rrjedhojë, automjetin \*\*\* e përdor rrallë. Kur kisha nevojë të udhëtoja në Kosovë e Maqedoni, vëllai më ofronte makinën e tij. Në policën e sigurimit vëllai kishte shënuar edhe emrin tim, me qëllim që nëse ndodhte ndonjë aksident në ato ditë që unë mund ta përdorja automjetin, të isha i siguruar si drejtues mjeti.*

*Në përdorimin për 10-15 ditë në vit nuk e kam konsideruar si përdorim të asaj pasurie, aq më tepër që unë nuk kisha ndonjë kontratë huapërdorjeje apo qiraje me vëllain tim”.*

**12.5** Në përfundim të hetimit, Komisioni doli në konkluzionin se subjekti duhej të deklaronte në deklaratën *Vetting* pasurinë në përdorin automjet me targë \*\*\*, detyrim i përcaktuar në pikën 11 të neni 3 të ligjit nr. 84/2016.

**12.6** Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**12.7** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka deklaruar: *“Automjeti \*\*\*, sikurse kam deklaruar, është në pronësi të vëllait tim I. S. Pika 11 e neni 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe neni 4 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, përcaktojnë se kush është pasuri, por në rastin konkret kjo pasuri është poseduar nga unë vetëm në ditë të shkëputura kur kam dalë jashtë shtetit në Kosovë e Maqedoni (kam sqaruar se banesa ime në Gj është 5 km larg nga Dibra e Madhe) mesatarisht 4-5 ditë në vit dhe prandaj nuk është deklaruar si pasuri në përdorim”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**12.8** Komisioni vlerësoi se subjekti duhej të kishte deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën *Vetting*, sipas përcaktimit të pikës 11 të neni 3 të ligjit nr. 84/2016. Megjithatë, kjo

<sup>45</sup> Shihni të dhënat nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë në dosjen e Komisionit.

<sup>46</sup> Shihni të dhënat e nxjerra nga sistemi elektronik i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

<sup>47</sup> Shihni përgjigjen e plotë të subjektit mbi pyetësorin nr. 4 në dosjen e Komisionit.

mangësi në deklaram nuk mund të ndikojë në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit, pasi nuk rezultoi se ishte bërë me qëllim fshehjen e një fakti të tillë.

### **13. Analiza financiare**

**13.1** Analiza financiare është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë përfshin periudhën 1994 – 2002, e cila është bërë në bllok për subjektin për shkak se ai ka deklaruar për herë të parë në vitin 2003 pranë ILDKPKI-së. Subjekti është emëruar në detyrë në vitin 1999, por të ardhurat e mëparshme deklarohen prej tij si burim për krijimin e pasurive të paluajtshme në K.

**13.2** Analiza financiare fillon nga viti 1994, pavarësisht se të ardhurat e dokumentuara nga subjekti fillojnë që në vitin 1991, sepse sipas vendimit të Kolegjit<sup>48</sup> periudha deri në vitin 1993 është konsideruar si një periudhë ku kursimi ishte praktikisht i pamundur për shkak të zhvlerësimit të lekut nga inflacioni i lartë, prandaj mosnjohja e këtyre të ardhurave nuk ka një ndikim domethënës në analizën financiare.

**13.3** Pjesa tjetër e analizës është bërë për periudhën 2003 – 2016 dhe në këtë periudhë subjekti është deklarues pranë ILDKPKI-së, prandaj edhe analiza financiare është bërë vit pas viti për këtë hark kohor.

**13.4** Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin një pamundësi financiare totale prej -20,620,879 lekësh për periudhën 1994 – 2016 dhe për këtë gjetje Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**13.5** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>49</sup>, subjekti ka shpjeguar se: *“Të ardhurat e dokumentuara të miat e të bashkëshortes time fillojnë që nga viti 1983.*

*Banesa në K ekzistonte si karabina dykatëshe në datën 16.2.2003, së bashku me garazhin dhe ahurin e bagëtive, ndodhur në veri të banesës. Këto ndërtime kanë ekzistuar që në vjeshtën e vitit 2002.*

*Duhen shënuar të ardhurat nga toka e sera, ku janë kultivuar perimet e pemët frutore të përdorura për konsum familjar, të cilat janë përlllogaritur me ekspert agronom dhe vlerësues të pasurive, duke shtuar se, meqë nuk janë njohur si e ardhur, së paku mund të pakësoheshin shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, referuar INSTAT-it.*

*Të përfshihen të ardhurat nga qiraja e lavazhit e lokalit, nga kursi i anglishtes.*

*Të hiqen shpenzimet nga dasma dhe të përfshihen të ardhurat e përfituara nga dasma.*

*Për vlerën e ndërtimeve në K e Gj duhet marrë në konsideratë vlera mbi bazën e akteve të ekspertimit, ku duhet të zbritet puna e krahu<sup>50</sup> që e ka kryer vetë me vëllezërit e tij.*

*Në përfundim, rezultati do jetë pozitiv në shumën 20,620,879 lekë”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**13.6** Pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni la të pandryshuar vlerën e ndërtimeve të bëra nga subjekti sipas EKB-së, duke mos konsideruar pretendimin e tij për

<sup>48</sup> Shihni vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit.

<sup>49</sup> Shihni përgjigjen e detajuar të subjektit mbi rezultatet e hetimit.

<sup>50</sup> Për këtë subjekti ka sjellë deklaratë noteriale të datës 14.7.2023, ku subjekti dhe dy vëllezër të tij deklarojnë se kanë ndërtuar vetë me punë krahu banesat dhe murin rrethues të tyre.

reduktim shpenzimesh nga puna e krahut, si një fakt i pavërtetueshëm, si dhe pretendimin e tij lidhur me periudhën e ndërtimit, bazuar në ortofotot e viteve.

**13.7** Lidhur me kërkesën e subjektit për zbritje të shpenzimeve të jetesës për të dhe familjen e tij për shkak të shfrytëzimit të produkteve bujqësore për nevojat familjare, Komisioni krijoi bindjen se duhen reduktuar shpenzimet e jetesës në analizën financiare të subjektit dhe familjes së tij për pjesën e fruta-perimeve, që duken se kanë prodhuar në tokat e tyre bujqësore në Gj dhe K. Referuar “Rezultateve të anketës së buxhetit të familjeve në Shqipëri 2006 – 2007”, realizuar nga INSTAT-i, zbritja duhet bërë referuar përqindjes që zënë zërat e frutave dhe perimeve në totalin e konsumit mujor të një familje. Referuar këtyre të dhënave, perimet dhe frutat zënë përkatësisht 14% dhe 8.8% të grupit të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike dhe në total zënë 22.8%. Ky grup në vetvete zë 47.6% të konsumit total të një familjeje. Si rrjedhim, zbritja e shpenzimeve për grupin e fruta-perimeve do jetë në masën 10.8% ( $22.8\% \times 47.6\% = 10.8\%$ ) të shpenzimeve të jetesës.

**13.8** Komisioni reduktoi këtë pjesë të shpenzimeve të jetesës që nga viti 1998, vit në të cilin subjekti ka përfituar tokën bujqësore në Gj, Dibër, sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën” dhe deri në vitin 2016.

**13.9** Lidhur me pretendimin e subjektit se duhen përfshirë në analizën financiare edhe të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes që nga viti 1989, Komisioni vëren se qëndrimi i Kolegjit është i konsoliduar lidhur me këtë çështje. Inflacioni dhe zhvlerësimi i madh i monedhës së lekut ishte aq i lartë sa bëhej i pamundur kursimi në atë periudhë. Gjithsesi, edhe po t’i konsideroheshin këto të ardhura, të cilat në total shkojnë në vlerën 106,345 lekë paga bruto, pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës do të mbeteshin 70,188 lekë, të cilat nuk përmbysin dot rezultatin negativ të periudhës, që është në vlerën 841,365 lekë.

**13.10** Në lidhje me pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga qiraja e lavazhit dhe më pas e lokalit, Komisioni është shprehur më sipër në pikën 7 të këtij vendimi.

**13.11** Në lidhje me pretendimin e subjektit për të përfshirë në analizën financiare të të ardhurave nga kurset e anglishtes së dhëna nga vajza e tij E., Komisioni vlerëson se këto të ardhura nuk konsiderohen të ligjshme, sepse nuk plotësojnë kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, ato nuk mund të jenë pjesë e analizës financiare.

**13.12** Lidhur me pretendimin e subjektit se nuk duheshin përfshirë në analizën financiare shpenzimet e dasmave të fëmijëve, për sa kohë nuk janë përfshirë të ardhurat nga dhurimet, Komisioni vlerëson se këto shpenzime janë deklaruar nga vetë subjekti, prandaj nuk ka arsye që të mos përfshihen në analizë. Ndërkohë, të ardhurat nga dhurimet e deklaruara nga subjekti nuk arriti t’i provojë.

**13.13** Komisioni hartoi analizën financiare pas përgjigjeve të subjektit mbi rezultatet e hetimit, paraqitur në tabelën si vijon:

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: VLADIMIR M. SKENDERI																
PERSHKRIMI	1994-2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
<b>PASURI</b>	<b>1,982,771</b>	<b>1,162,771</b>	<b>7,082,041</b>	<b>522,654</b>	<b>4,055,928</b>	<b>38,999</b>	<b>-52,845</b>	<b>-1,341</b>	<b>1,336,783</b>	<b>2,036,113</b>	<b>-22,857</b>	<b>-48,393</b>	<b>-2,952</b>	<b>-900,085</b>	<b>3,471</b>	<b>16,889,189</b>
Toke bujqesore 1,000 m2, Gjorice, Diber - 100%																0
Shtepi banimi 32 m2, Gjorice, Diber - 100%																0
Trualli 1,000 m2, Gjorice, Diber - 100%																0
Toke bujqesore 1,000 m2, Kamez, Tirane - 50%																0
Shtepi banimi Kamez, Tirane - 50% - 2002 - 2006	1,162,771	1,162,771	5,141,029	500,000	50,000											8,016,571
Lavazh per larje makinash - 50% - 1998	120,000															120,000
Ahur, Kamez - 50% - 1998	200,000															200,000
Garazh, + lokal Kamez - 50% - 2004 - 2006			1,941,012		4,011,606											5,952,618
Autoveture **** - 100% - 2001 - 2002	500,000															500,000
Autoveture Renault **** - 15,000€ - 2011										2,100,000						2,100,000
<b>Ndryshim ne likuiditet</b>		0	0	22,654	-5,678	38,999	-52,845	-1,341	1,336,783	-63,887	-22,857	-48,393	-2,952	-900,085	3,471	
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,363,574</b>	<b>-164,966</b>	<b>-182,273</b>	<b>-199,161</b>	<b>-214,295</b>	<b>-230,455</b>	<b>372,424</b>
Hua nga kunati P. K. - 10,000€ - 2006																0
Kredi Alpha Bank - 2011 - 10,500€										1,363,574	-164,966	-182,273	-199,161	-214,295	-230,455	372,424
Hua djali nga B. M. per studime - 34,000\$ - 2015 - E. S.																0
<b>PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>1,982,771</b>	<b>1,162,771</b>	<b>7,082,041</b>	<b>522,654</b>	<b>4,055,928</b>	<b>38,999</b>	<b>-52,845</b>	<b>-1,341</b>	<b>1,336,783</b>	<b>672,539</b>	<b>142,109</b>	<b>133,880</b>	<b>196,209</b>	<b>-685,790</b>	<b>233,927</b>	<b>16,516,764</b>
<b>TE ARDHURA dokumentuar</b>	<b>2,770,526</b>	<b>771,930</b>	<b>979,839</b>	<b>932,718</b>	<b>1,109,922</b>	<b>1,359,298</b>	<b>1,198,849</b>	<b>1,349,454</b>	<b>1,352,426</b>	<b>1,392,458</b>	<b>1,467,569</b>	<b>1,489,911</b>	<b>1,771,455</b>	<b>1,743,749</b>	<b>1,810,992</b>	<b>21,501,096</b>
Te ardhura nga pagat subjekti	2,213,799	579,312	765,272	773,408	824,865	836,521	819,686	932,635	904,550	924,701	983,351	995,189	1,238,262	1,208,009	1,272,701	15,272,261
Te ardhura nga pagat b/shortja	556,727	192,618	214,567	159,310	285,057	322,777	379,163	416,819	447,876	467,757	484,218	494,722	533,193	535,740	538,291	6,028,836
Te ardhura nga shitja e autovetures **** - 2007						200,000										200,000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1,829,120</b>	<b>507,879</b>	<b>607,879</b>	<b>829,430</b>	<b>900,149</b>	<b>1,269,990</b>	<b>1,069,141</b>	<b>1,818,699</b>	<b>1,213,332</b>	<b>3,764,027</b>	<b>1,342,462</b>	<b>1,363,120</b>	<b>1,302,852</b>	<b>4,419,651</b>	<b>1,509,601</b>	<b>23,747,332</b>
Shpenzime jetese	1,595,520	419,079	419,079	545,630	586,349	731,190	731,190	731,190	731,190	680,413	622,384	628,967	981,191	908,579	838,808	11,150,762
Shpenzime shkollimi femijet			100,000	100,000	100,000	300,000	221,155	374,446	386,201	273,172	100,000		100,000	400,000	456,000	2,910,973
Shpezime per kualifikime subjekti							25,532			149,739	167,664					342,935
Shpenzime per dasmat e femijeve										500,000				1,000,000		1,500,000
Shpenzim per dhurim vajzes - 12,000€ - 2011 dhe 1,500,000 leke djalit - 2015										1,659,600				1,500,000		3,159,600
Shpenzime per legalizim ndertimesh dhe per regjistrim pasurie toke ne Kamez 2013												310,887	18,500			329,387
Shpenzime qiraje subjekti ne Vlore	140,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	15,000							575,000
Shpenzime mobilimi				95,000	125,000	100,000			50,000					200,000	100,000	670,000
Shpenzime interesi, komisione dhe siguracion per kredi tek Alpha Bank										103,371	175,867	148,678.68	127,015.32	97,262.11	72,739	724,933
Shpenzime per transport nderqytetas	93,600	28,800	28,800	28,800	28,800	28,800	28,800	28,800	24,000							319,200
Shpenzime udhetimi				0	0	50,000	2,464	624,263	6,941	397,731	276,547	274,587	76,146	313,809	42,054	2,064,541
<b>Analiza dokumentuar</b>	<b>-1,041,365</b>	<b>-898,720</b>	<b>-6,710,082</b>	<b>-419,367</b>	<b>-3,846,155</b>	<b>50,309</b>	<b>182,553</b>	<b>-467,904</b>	<b>-1,197,689</b>	<b>-3,044,107</b>	<b>-17,002</b>	<b>-7,089</b>	<b>272,394</b>	<b>-1,990,111</b>	<b>67,464</b>	<b>-19,066,870</b>
																<b>Pamundesia financiare totale</b>
																<b>-19,639,589</b>

Nga analiza financiare e periudhës 1994 – 2016, subjekti dhe bashkëshorti rezultuan me një pamundësi financiare totale prej -19,639,589 lekësh.



## 14. METODOLOGJIA

### Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare është bazuar në:

- a. **Gjendjet e likuiditeteve** të subjektit dhe bashkëshortes, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga BKT, Raiffeisen Bank, Credins Bank, Tirana Bank, Intesa Sanpaolo Bank, Alpha Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

Djali i subjektit E.S kishte deklaruar në deklaratën *Vetting* gjendje bankare jashtë Shqipërisë. Në rezultatet e hetimit, subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion *statement*-in e llogarisë, në mënyrë që të provohet mundësia e tij për krijimin e këtyre likuiditeteve deri në datën e deklaratës *Vetting*. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk solli dokumentacion provues për këto llogari.

b. **Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:**

- i) të ardhurat nga pagat e subjektit tek M.K. Bulqizë (1994 – 1997), Shkolla e Magjistraturës, bursë (1997 – 1999) dhe lehtësues e autor (2014 – 2015) tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (1999 – 2000) dhe (2010 – 2016) tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë (2000 – 2010), si dhe tek Akademia Profesionale e Biznesit (2012 – 2014);
  - ii) të ardhurat nga bashkëshortja e subjektit tek M.K. Bulqizë (1994 – 1997), tek Bashkia K. (1998 – 2007), DAR Qarku K (2008 – 2010), Zyra arsimore K. (2011 – 2016);
  - iii) të ardhura nga shitja e automjetit tip “\*\*\*” (2007).
- Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti në *Vetting* nga kultivimi i perimeve në serrë dhe kopsht, nga mbarështimi i shpendëve dhe kafshëve shtëpiake dhe nga pemë frutore në kopshtin në K, për arsye të mosvërtetimit të këtyre të ardhurave, mospagimit të detyrimeve tatimore përkatëse dhe për arsye se subjekti në përgjigje pyetësori deklaroi se nuk ka siguruar të ardhura nga shitja e tyre, por produktet janë përdorur për nevoja familjare.
  - Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga kultivimi i perimeve etj., si dhe të ardhura nga pemët frutore në tokën në Gj, për arsye të mosvërtetimit të këtyre të ardhurave, mospagimit të detyrimeve tatimore përkatëse dhe për arsye se subjekti në përgjigje pyetësori deklaroi se nuk ka siguruar të ardhura nga shitja e tyre, por produktet janë përdorur për nevoja familjare.
  - Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga qiraja e lavazhit në K, për periudhën 2004 – 2009, për arsye se nuk janë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura.
  - Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhura e pretenduara nga subjekti nga qiraja e godinës së shërbimit që ndodhet përballë banesës në K, për periudhën 2010 – 2013, për arsye se nuk janë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura.
  - Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga dhuratat e dasmave të vajzës (2011) dhe djalit (2015), për shkak të mosvërtetimit të tyre.
  - Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e pretenduara nga subjekti nga kurset e anglishtes së zhvilluara nga vajza E në vitin 2009, për arsye se nuk janë paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura.

### **c. Shpenzimet, ku përfshihen:**

- i) shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i) – shpenzimet e jetesës janë reduktuar sipas pikës 13.7 të këtij vendimi;
- ii) shpenzime për shkollimin e fëmijëve sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit dhe dokumenteve provuese të institucioneve arsimore;
- iii) shpenzime kualifikimi të subjektit sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit dhe transfertave bankare;
- iv) shpenzimet për dasmat e fëmijëve (në vitet 2011 dhe 2015) sipas deklaramit të subjektit në DPV-të dhe përgjigjet e pyetësorëve;
- v) shpenzime për dhurimet e bëra fëmijëve me rastin e martesave në vitet 2011 dhe 2015, sipas deklaramit të subjektit në DPV dhe përgjigjet e pyetësorëve;
- vi) shpenzime për legalizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme në K (2013);
- vii) shpenzime interesi dhe komisione, si dhe për shlyerje principali për kredinë e marrë nga subjekti në Alpha Bank, sipas vërtetimeve dhe *statement*-eve bankare përkatëse (2011 – 2016).
- viii) shpenzime transporti ndërqytetës (1999 – 2010), sipas deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit;
- ix) shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshortja kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm;
- x) shpenzime qiraje në Vlorë (1999 – 2010) sipas deklaramit të subjektit në përgjigje pyetësori;
- xi) shpenzime mobilimi (2005 – 2007, 2010, 2015 – 2016) sipas deklaramit të subjektit në përgjigje pyetësori.

**ç.** Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive<sup>51</sup>.

**d.** Vlerat e ndërtimeve të bëra nga subjekti janë llogaritur bazuar në sipërfaqen e ndërtuar dhe kostos së ndërtimit sipas EKB-së. Vitet e ndërtimit janë vlerësuar sipas ortofotove të pasurive ndër vite, si dhe deklarimeve të subjektit.

**dh.** Huamarrjet nga shtetasit P. K. në vitin 2006 dhe B. M. në vitin 2015 nuk janë përfshirë në analizën financiare, për shkak se subjekti nuk arriti të vërtetonte burimin e ligjshëm të huadhënësve për shumat e deklaruara.

Për sa më sipër, lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi ka bërë deklaramit të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive prej -19,639,589 lekësh, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera, duke mos u gjendur në kushtet e përcaktuara në gërmën “a” dhe gjendur në kushtet e gërmës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>51</sup> Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK), në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenet 37 e 38 të ligjit nr. 84/2016.

2. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar pranë Komisionit raportin<sup>52</sup> për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi.

3. AKSIK-ja, me shkresën<sup>53</sup> e dërguar në vitin 2017, ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, me konstatimin për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

4. Në vijim, pas kërkesës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit<sup>54</sup> për përditësim dhe deklasifikim të informacioneve, janë përcjellë dy raporte nga AKSIK-ja në vitin 2022: raporti i përditësuar dhe deklasifikuar plotësisht<sup>55</sup> dhe raporti i deklasifikuar pjesërisht<sup>56</sup>.

5. Në raportin e AKSIK-së<sup>57</sup> konstatohet se:

- *Subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si të deklaruara apo paraqitura nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës.*
- *Për subjektin e rivlerësimit rezulton të jetë regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2016, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Ky procedim është transferuar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, mban cilësinë e personit nën hetim në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.*
- *Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas kërkesave dhe parashikimeve të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016.*
- *Por në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit apo pastërtisë së figurës së një funksionari publik, në rastin tonë, gjyqtar, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje apo moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërputhje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime material ose jomateriale të padrejta për vetë si funksionar publik apo persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm*

<sup>52</sup> Shihni raportin përfundimtar të DSIK-së dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.10.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.10.2022, të KDZH-së.

<sup>53</sup> Shihni raportin dërguar nga DSIK-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017.

<sup>54</sup> Shihni kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2022, të Komisionit.

<sup>55</sup> Shihni raportin e deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 14.10.2022 (datë 25.10.2022).

<sup>56</sup> Shihni raportin e deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH nr. \*\*\*, datë 25.10.2022 (datë 28.10.2022).

<sup>57</sup> Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10/2023, datë 2.2.2023, “Për informacionin e klasifikuar”, më datë 9.3.2023, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, bazuar në nenin 63 të këtij ligji emërtimi i DSIK-së ka ndryshuar në Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

*të shtetit apo personave të tjerë, cenojnë figurën e tij, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimeve të germës "c" të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.*

- *Bazuar në kërkesat e nenit 36, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, Grupi i Punës nëpërmjet AKSIK-së është informuar se, në datën 26.1.2017, subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, i është revokuar viza amerikane, gjë që nuk është pasqyruar në deklaratën për kontrollin e figurës. Theksohet se deklarata për kontrollin e figurës nga subjekti i rivlerësimit është plotësuar në datën 26.1.2017, ndërsa revokimi i vizës është në datën 26.1.2017, kështu që subjekti i rivlerësimit nuk ishte në dijeni të këtij fakti në momentin e deklarimit.*
- *Në kompleksitetin e vlerësimit të figurës së z. Vladimir Skënderi ky fakt duhet të merret në konsideratë, pasi shqyrtimi i aplikimit për vizë të SHBA-së shoqërohet me verifikim të besueshëm dhe profesional të aplikantit. Marrja e vizës së SHBA-së kuptohet si standard për pastërtinë e figurës, ku aplikanti i nënshtrohet një procedure të intësishtme dhe të besueshme Vetting. Ndërkohë që refuzimi/revokimi mund të bëhet për disa arsye. Sjellim në vëmendje se Ambasada e SHBA-së ka deklaruar se do të përdorë të gjitha mjetet ligjore që ka në dispozicion për refuzimin/revokimin e vizave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të korrumpuar. Kjo praktikë është ndjekur nga SHBA-ja për promovimin e luftës kundër korrupsionit anëmbanë botës. Refuzimi i vizës përkon në periudhë me deklaratën e Ambasadës së SHBA-së. Në këtë kontekst rekomandohet vlerësimi i këtyre rrethanave në dritën e informacioneve të tjera.*
- *Sa më sipër, Grupi i Punës konstatoi papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi.*
- *Edhe në raportin e deklasifikuar pjesërisht të datës 2.11.2022, konstatohet se: Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, në më shumë se një rast rezulton se për subjektin e rivlerësimit disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e ndërveprimit korruptiv gjatë gjykimit në disa procese gjyqësore.*
- *Për subjektin e rivlerësimit, z. Skënderi, disponohen të dhëna se persona të ndryshëm, me profesion avokat, kanë shfaqur predispozitën të ushtrojnë ndikim të paligjshëm ndaj tij, me qëllim favorizimin/lehtësimin e pozitës së përfaqësuesve të tyre. Gjithashtu, mund të jetë përfshirë në ushtrim ndikimi të paligjshëm ndaj ekspertëve që hartojnë akt ekspertizën, me qëllim përfitimin e të mirave materiale.*
- *Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit z. Vladimir Skënderi, arsyetohet të merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e tij në veprime korruptive, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit.*
- *Mbështetur në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese, merret në konsideratë kohëzgjatja e veprimeve të kundërligjshme në më shumë se një rast dhe fakti se janë marrë nga burime të besueshme dhe me akses.*
- *Në përfundim, Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, konfirmon konstatimin fillestar për papërshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi.*

6. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese<sup>58</sup>, me qëllim evidentimin e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme.

7. Lidhur me 4 çështjet gjyqësore, për të cilat janë administruar dosjet përkatëse të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ato janë trajtuar më poshtë në këtë vendim, te rubrika “TË TJERA”.

8. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për çështjet e konstatuara më sipër mbi vlerësimin e figurës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

9. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shprehur:

- *Mirënjohjen për objektivitetin në pasqyrimin e fakteve, por jo me konkluzionin e mbërritur nga AKSIK-ja, duke shpjeguar se është regjistruar më shumë se një herë procedimi penal që lidhet me gjykime të kryera prej meje, për të cilat është bërë edhe ankim në ILD dhe çështjet janë arkivuar sepse nuk është konstatuar shkelje nga ana ime. Është praktikë për palët që mbeten të pakënaqura mundohen të ushtrojnë presion e të hakmerren përmes kallëzimeve, ankesave etj. Nuk besoj se në të ardhmen mund të vihem nën presion nga strukturat kriminale, sepse u kam qëndruar gjithmonë larg. Për më tepër nuk më duket e drejtë që vlerësimi të mbështetet në supozime se çfarë mund të ndodhë në të ardhmen.*
- *Në lidhje me revokimin e vizës amerikane, deklaroj se ky revokim u bë në grup për disa gjyqtarë e prokurorë në fillimin e procesit të Vetting-ut. Nuk e kam deklaruar sepse s’kisha dijeni. Saktësoj se data 26.1.2017 e shënuar në relacion nuk është e saktë se ky revokim më është komunikuar në banesën time me datë 3.2.2017, sipas zarfit me vulë nga Ambasada Amerikane në Tiranë, kurse deklaratën tek AKSIK-ja e kam plotësuar me datë 27.1.2017, pra 7 ditë më parë. Ky revokim nuk e di se mbi çfarë kriteresh u bë, por në atë shkresë ftohesha të riaplikojta në çdo kohë dhe të paraqisja prova se rrethanat tashmë kanë ndryshuar. Nuk jam dakord me përgjithësimin se kjo ka ndodhur për shkak të dyshimeve për korrupsion. Korrupsioni provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe jo me thashetheme. Ekzistenca e rrethanave të mësipërme, nuk vlerësoj se më bën person të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

10. Në përfundim të hetimit administrativ, pas analizimit të shpjegimit të subjektit dhe ballafaqimit me fakte të tjera të mbledhura nga institucionet ligjzbatuese për vlerësimin e kontrollit të figurës, Komisioni doli në konkluzionin se:

- Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.
- Nuk u gjetën elemente që vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve e kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, duke përfshirë edhe lëvizjet e subjektit për hyrje-daljet jashtë vendit, sipas informacionit nga sistemi TIMS.

---

<sup>58</sup> Komisioni hetoi lidhur me 4 çështje gjyqësore në aspektin e vlerësimit profesional, të cilat janë trajtuar në kreun “TË TJERA”, pjesë e këtij relacioni.

**Sa më sipër, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.**

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**1.** Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit Vladimir Skënderi është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2.** Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

#### **Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**Dokumenti 1** – Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 24.3.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që i përket paditësit F. F, me të paditur A. D, me objekt “Detyrimi për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale dhe dëmi moral, në shumën...”.

**Dokumenti 2** – Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 2.2.2015, që i përket paditësve Sh. K, D. K etj., me të paditur S. H e R. H, persona të tretë N. G, R. L etj., me objekt “Detyrimi i të paditurve të njohin pronarë paditësit mbi apartamentin me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup> në lagjen “\*\*\*\*\*” Durrës...”.

**Dokumenti 3** – Vendimi civil nr. \*\*\*, datë 21.4.2016, që i përket paditësit të kundërpaditur K. A, me të paditur kundërpaditës A. B etj., persona të tretë shoqëria “P” sh.p.k., Zyra Përmbarrimore \*\*\*, M. T, shoqëria “T” sh.p.k. e \*\*\* Bank, me objekt “Detyrimi i të paditurve të lirojnë e dorëzojnë apartamentet që mbajnë në mënyrë të paligjshme etj...”.

**3.** Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se kohëzgjatja e gjykimit për çështjen e parë civile me palë kundërshtare është 9 muaj e 22 ditë (*shihni* dokumentin 1), për çështjen e dytë civile me palë kundërshtare është 1 vit e 16 ditë (*shihni* dokumentin 2), ndërsa për çështjen e tretë civile me palë kundërshtare afati është 1 vit, 5 muaj e 28 ditë (*shihni* dokumentin 3).

**3.1** Në asnjë nga 3 dokumentet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, duket se nuk është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor.

**4.** Lidhur me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit ka shpjeguar se përzgjedhjen e këtyre tri çështjeve e ka bërë nisur nga fakti që çështjet ishin të komplikuar dhe kërkonin njohuri për dhënien e një zgjidhjeje ligjore për to. Subjekti ka deklaruar se mund të kishte zgjedhur një çështje që ishte mbaruar brenda një muaji dhe të tilla ka shumë, por ka zgjedhur 3 çështjet më të komplikuar me një sërë problematikash. Zgjatja e gjykimit asnjëherë nuk është shkaktuar nga trupi gjykues, por për shkak të palëve, të cilat jo rrallë e përdorin këtë taktikë për të dekurajuar palën kundërshtare.

**5.** Komisioni vlerësoi se problematikat në lidhje me mosrespektimin e afatit të gjykimit në këto 3 çështje janë komplekse dhe kërkonin njohuri për dhënien zgjidhje të tyre, duke përfshirë edhe vonesat e bëra nga palët ndërgjyqëse. Prandaj vlerësohet se këto vonesa nuk ndikojnë në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit.

## **Pesë dosjet gjyqësore për gjyqtarin Vladimir Skënderi, të përzgjedhura me short**

**Dosja 1** – Çështja civile nr. \*\*\*/\*\* regj., datë 22.10.2015, që i përket paditëses M.K, me të paditur DRSSH \*\*\*, me objekt “Njohjen e vjetërsisë në punë në NBSH Lushnjë, në \*\*\* \*\* etj., për periudhën...”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.4.2016.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Vladimir Skënderi në kryesekretari në datën 16.5.2016, 27 ditë pas shpalljes, jashtë afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Nga aktet në dosje rezulton se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur DRSSH \*\*\* dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.4.2017, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 19.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

**Dosja 2** – Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 18.2.2015, që i përket paditëses H.M, me të paditur DRSSH Durrës, me objekt “Deklarimin e pavërtetësisë së dokumentit, librezës së punës etj...”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.2015.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Vladimir Skënderi në kryesekretari në datën 2.6.2015, pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 10 ditë, në intervalin kohor 18.2.2015 – 28.5.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, duke respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.\*\*\*, datë 29.2.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 28.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

**Dosja 3** – Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 27.2.2014, që i përket paditëses A.M, kundër të paditurit Fondacioni “\*\*\*\*”, me objekt “Dëmshpërblim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.2014.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi ka zgjatur gjithsej 3 muaj e 1 ditë, në intervalin kohor 27.2.2014 – 28.5.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në respekt të standardit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Nga aktet në dosje rezulton se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim paditësja dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2015, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 28.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

**Dosja 4** – Çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 20.3.2015, që i përket paditësit M.T, kundër të paditurit Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me objekt “Pagimin e dëmshpërblimit për zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës, në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.6.2015.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga gjyqtari Vladimir Skënderi në kryesekretari në datën 15.6.2015, pas 14 ditëve nga shpallja, jashtë afatit procedural civil 10-ditor të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi ka zgatur gjithsej 2 muaj e 11 ditë, në intervalin kohor 20.3.2015 – 1.6.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit 6-mujor të caktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Rrjedhimisht, kohëzgjatja e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor, të përcaktuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

Nga aktet në dosje rezulton se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit civil nr. \*\*\*, datë 1.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

**Dosja 5** – Çështja administrativo-penale nr. \*\*\* regj., datë 19.8.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, ndaj të dyshuarit Xh. T. për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 20.8.2016”.

Dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar për masën e sigurimit, është depozituar nga subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi në sekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 26.8.2016, pas 6 ditëve nga shpallja, jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga palët ndërgjyqëse dhe dosja aktualisht ndodhet e arkivuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

### **Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së**

**6.** Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Vladimir Skënderi ka marrë titullin “Jurist” nga universiteti “\*\*\*\*” në Shkodër, në datën 31.7.1997 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2000. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.9.1999, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kur është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe me Dekretin nr. \*\*\*, datë 27.9.2000, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.4.2010, të KLD-së është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku vazhdon aktualisht.

**7.** Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Vladimir Skënderi janë paraqitur gjithsej 17 ankesa (6 të vitit 2014, 7 të vitit 2015, 4 të vitit 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së.

**8.** 10 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimet se:

- 6 ankesa (3 të vitit 2014, 2 të vitit 2015, 1 e vitit 2016) janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. 3 ankesa (1 e vitit 2014, 2 të vitit 2015) janë arkivuar me arsyetimin se ankesat janë të përsëritura dhe 1 ankesë e vitit 2015 është arkivuar si ankesë e paplotë.
- 3 ankesa të tjera (1 e vitit 2015, 2 të vitit 2016) janë bashkuar me ankesat bazë, ndër të cilat ankesa bazë e vitit 2015 është mbajtur në verifikim në vijim dhe më pas është përcjellë pranë ILD-së, 1 ankesë bazë e vitit 2016 është arkivuar pas shqyrtimit paraprak, si dhe 1 ankesë bazë e vitit 2016 është verifikuar por ka mbetur e pa miratuar nga titullari dhe i është përcjellë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



- 4 ankesa (2 të vitit 2014, 1 e vitit 2015, 1 e vitit 2016) janë verifikuar dhe ka rezultuar se 3 ankesa (1 e vitit 2014, 1 e vitit 2015, 1 e vitit 2016) janë verifikuar për mosrespektim formal të ligjit dhe në përfundim është vendosur: Për 1 ankesë arkivimi, pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtarit Vladimir Skënderi, ndërsa 2 të tjerat (njëra mbajtur në verifikim në vijim, ndërsa tjetra e pamiratur nga titullari në kohën e kalimit nga KLD-ja në KLGJ) i janë përcjellë për kompetencë ILD-së, me shkresën përcjellëse nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020. 1 ankesë e vitit 2014, e verifikuar për zvarritje gjykimi, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtarit.

9. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Vladimir Skënderi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

### **Analiza e gjetjeve**

10. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, ka aftësi në drejtim të interpretimit, arsyetimit dhe zbatimit të ligjit. Niveli i arsyetimit të vendimeve gjyqësore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

11. Gjatë tri viteve të fundit (2013 – 2016) i janë caktuar gjithsej 989 çështje, ka përfunduar gjithsej 1049 çështje për tre vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 105 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 106%.

12. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Sipas të dhënave nga regjistri i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Vladimir Skënderi. Ai komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse.

### **DENONCIME**

13. Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur gjithsej 19 denoncime (disa prej tyre janë të përsëritura).

#### **13.1 Denoncim i përsëritur i shtetasit S.R me nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2019**

Ky shtetas ka denoncuar vite më parë shumë subjekte rivlerësimi, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, gjyqtarin Vladimir Skënderi, i cili ankohet se bashkëshortja e tij D.R prej vitesh ka konflikt pronësie me të vëllanë Z.SH dhe nipin e tij E.SH, të cilët në fshehtësi kanë përpiluar një tapi fallco me inxhinierë të inkriminuar, duke bërë dy plane rievrimi të pambështetur në asnjë të vërtetë. Seancat gjyqësore janë zhvilluar me dokumente fallco nga pala kundërshtare.

Komisioni, duke parë përmbajtjen e dy ankesave të tij, të dorëzuara në vitet 2017 dhe 2018, i cili përmend vendime gjyqësore, por pa i cituar ato me numra e data, vlerësoi t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesën për vënie në dispozicion të vendimeve gjyqësore me palë paditëse dhe palë të paditura D.R (Sh) e S.R dhe Z e E.SH, gjyqtar ose anëtar trupe gjyqtarin Vladimir Skënderi.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka sjellë vendimin nr. \*\*\*, datë 27.1.2012, ku paditësja D.Sh (R) ka paditur shtetasin E.Sh (nipin e saj), duke i kërkuar gjykatës “*Detyrimin e palës së paditur të njohë të drejtën e pronësisë në favor të paditëses mbi një sipërfaqe trualli 87 m<sup>2</sup> dhe detyrimin e ZVRPP-së Durrës të regjistrojë këtë pasuri...*”. Në fund të gjykimit, gjykata me gjyqtar V. Skënderi ka vendosur *rrëzimin e kësaj kërkesëpadie* sepse pavarësisht pretendimit të palës paditëse për falsifikim kontrate dhurimi të vitit 1982 nga pala e paditur, nga e cila buronte origjina e pronës së dy palëve në proces, këtë pretendim pala paditëse e ka ngritur vetëm në konkluzionet përfundimtare dhe për të cilin nuk ka kërkuar kryerjen e një akti ekspertimi grafik. Gjithashtu, pronat e palëve në proces ishin të regjistruara në ZVRPP-në Durrës vite më parë dhe kjo çështje ishte gjykuar që në vitin 2009 nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në këto kushte, nuk u evidentuan shkelje procedurale nga ana e gjyqtarit të çështjes në drejtim të ezaurimit të të gjitha veprimeve në drejtim të plotësisimit të kërkesave të palëve në proces gjyqësor.

### **13.2 Denoncim i përsëritur i av. I.M, me nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2018, nr. \*\*\* prot., datë 13.7.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2021**

Denoncuesi ankohet për subjektin e rivlerësimit dhe për shumë subjekte të tjerë dhe paraqet kopje të kallëzimit penal të paraqitur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ILD-së. Ky kallëzim ka për objekt kërkesën për marrjen të pandehur dhe arrestimin e disa subjekteve dhe avokatit të palës Z. Gj., të cilit i kanë dhënë 3 ha tokë, të hipotekuar ligjërisht, që iu përkiste kallëzuesit I. M. dhe bujkut Z. K., duke i akuzuar për shpërdorim detyre, pasi duke bashkëpunuar së bashku në formën e organizatës së strukturuar kriminale ata kanë shpërfillur Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me hetimet kundër shtetasit të dënuar për falsifikim dokumentesh Z.Gj. Sipas ankuesit, këta magjistratë nuk kanë marrë parasysh prova të rëndësishme në proces dhe duke dhënë vendime haptazi kriminale: vendimin nr. \*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Referuar ankimit të shtetasit I.M, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për t’i vënë në dispozicion vendimin nr. \*\*\*, datë 7.2.2018, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, si dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qëllim evidentimin e kryerjes së shkeljeve disiplinore nga ana e z. Vladimir Skënderi, në cilësinë e gjyqtarit të kësaj çështjeje.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka sjellë vendimin nr. \*\*\*, datë 7.2.2018. Sipas këtij vendimi, ankuesi, në cilësinë e të paditurit/kundërpaditës i ka kërkuar gjykatës: Lirim e dorëzim sendi, pasurinë (tokë arë me sip. 10921 m<sup>2</sup>) dhe njohjen pronar për këtë pasuri. Ndërsa shtetasi Z.Gj i ka kërkuar gjykatës: Detyrimin e njohjes pronar nëpërmjet parashkrimit fitues dhe konstatimit të pavlefshmërisë dhe anulimit të kontratave të shitblerjes së kësaj toke bujqësore në vitin 2013, si dhe detyrimin e ZVRPP-së të anulojë dokumentet e pronësisë të lëshuara mbi këto kontrata, në kundërshtim e mashtrim me ligjin.

Pas shqyrtimit gjykata ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë së Z. Gj me të paditur Th. B etj., duke e detyruar këtë të fundit për ta njohur si pronar... etj.” dhe rrëzimin e kundërpadisë së ankuesit I.M. Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi këtë vendim.

Nga vendimmarrja e mësipërme, duke qenë se ankesa e shtetasit I. M lidhej me procesin vendimmarrës të gjyqtarit dhe jo me shkelje direkte procedurale të kryera prej tij në procesin

civil, Komisioni nuk mund të gjykonte mbi mënyrën e vlerësimit të provave e fakteve konkrete nga ana e gjyqtarit, mbi të cilat ky i fundit ka dalë në një vendimmarrje të caktuar.

Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kthyer përgjigje kërkesës së Komisionit në lidhje me ecurinë dhe vendimmarrjen e saj, në lidhje me ankimin e shtetasit I. M, ku me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 3.6.2022, ILD-ja ka vendosur “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi I.M ”.

Sa më sipër, referuar edhe vendimmarrjes së ILD-së, Komisioni vlerësoi se nuk mund të hetohej më tej për subjektin e rivlerësimit.

### **13.3 Denoncim anonim nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2018**

Denoncimi anonim mban shënimin në fund të letrës “Populli”, në të cilën thuhet: “*Verifikoni pasuritë e gjyqtarit të gjykatës së Durrësit F. H., i cili së bashku me gjyqtarët V. Skënderi dhe Dh. B. dhe Sh. P. e kanë kthyer gjykatën në sipërmarrje tregtie në shitblerjet e vendimeve*”.

Pavarësisht sa thuhet në letër, nuk citohet një akt apo proces gjyqësor konkret e, në këto kushte, nuk mund të hetohej më tej.

### **13.4 Denoncim i shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., me nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2018**

Nëpërmjet administratorit të saj, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i kërkon ndihmë Komisionit të *Vetting*-ut për përgjegjësinë si sipërmarrës punimesh apo “lojë gjykatash”, siç e quan ankuesi faktin se vendimi i Gjykatës së Apelit është ankimuar dhe Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin duke ia rikthyer për rigjykim gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit, pa i vënë në dijeni ata.

Ankuesi, administratori i shoqërisë R. J, bashkëlidhur ka sjellë 5<sup>59</sup> vendime gjykatash dhe vetëm vendimi nr. \*\*\*, datë 19.12.2011, lidhet me subjektin e rivlerësimit, i cili ka qenë gjyqtari i çështjes dhe sipas këtij vendimi duket se i ka dhënë të drejtë ankuesit. Ndërsa në lidhje me pretendimet e tjera të subjektit për mosvënie në dijeni për ankim e prishje vendimi<sup>60</sup>, duket se ankimi nuk lidhet me vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Në këto kushte, nuk kishte *indicie* për hetim të mëtejshëm për subjektin e rivlerësimit.

### **13.5 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2018, i shtetasit S.S**

Denoncuesi ankohet për gjyqtarin Vladimir Skënderi dhe kërkon *fillimin dhe finalizimin e procedurave për shkarkimin e tij nga detyra*. Në ankesën e tij ai trajton vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.2018, ku subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së ngritur nga ankuesi dhe bashkëpronarëve të tjerë lidhur me një pronë të ndodhur në qytetin e Durrësit, me objekt “Kthim sendi (një sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>) dhe rregullim pasojash ligjore”. Ankuesi, në cilësinë e paditësit në vendimin e sipërcituar, ankohet ndaj paditësve se një pjesë nga prona e tyre e përbashkët (150 m<sup>2</sup> nga 2150 m<sup>2</sup>) është zënë me ndërtime të paligjshme nga shtetasi I.S. Gjykata ka arsyetuar se të paditurit janë pronarë dhe kjo pronë u është dhënë me VKM-në Nr. 490, datë 18.6.2013 dhe paditësit përpara se të bënin padi rivendikimi në gjykatën civile duhej

<sup>59</sup> Shihni vendimet bashkëlidhur: vendimi nr. \*\*\*, datë 19.12.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendimi nr. \*\*\*, datë 21.1.2014, i Gjykatës së Apelit Durrës; vendimi nr. \*\*\*, datë 3.3.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendimi nr. \*\*\*, datë 13.7.2016, i Gjykatës së Lartë; vendimi nr. \*\*\*, datë 6.7.2028, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

<sup>60</sup> Shihni vendimet e sipërcituara (të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Administrative të Apelit).

t'i drejtoreshin paraprakisht Gjykatës Administrative për kundërshtimin e kësaj VKM-je dhe vetëm nëse do anulohet kjo VKM mund t'i drejtoreshin Gjykatës Civile me padi rivendikimi.

Sa më sipër, evidentohet se ky vendim është në proces ankimimi në Gjykatën e Apelit (referuar ankimit të depozituar nga ankuesi S. S.), si dhe bazuar në përmbajtjen e ankimit të shtetasit S. S, i cili ka pretenduar “shkelje të rënda” të kryera nga subjekti i rivlerësimit, ato në fakt lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave dhe zgjidhjes gjyqësore të çështjes në themelin e saj dhe jo me kryerje të shkeljeve procedurale ose etike nga ana e gjyqtarit Vladimir Skënderi.

Kështu, Komisioni vlerëson se nuk mund të marrë atributet e gjykatave respektive e, për këtë shkak, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

### **13.6 Denoncim nr. \*\*\* prot., 12.10.2018, i shtetasit E.Sh**

Ky shtetas bashkë me vëllain e tij A.Sh denoncojnë shumë subjekte në lidhje me problemin e konfliktit të pasurisë, pronë të tyre që prej viteve '90 e deri tani në Durrës. Shtetasi E.Sh dhe familja e tij kanë përfituar me vendim të Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave në vitin 1995 pasurinë e tyre tokë dhe objekte të ndërtuara para viteve '90. Përgjatë trazirave të viteve '96 - '97, një pjesë e sipërfaqes së tokës dhe objekteve të tyre është zaptuar nga disa shtetas, të cilët kanë ndërtuar dhe vazhdojnë e gëzojnë këtë pronë. Shtetasi E.Sh në denoncimin e tij të paraqitur në tetor të vitit 2018 pranë Komisionit denoncon subjekte – gjyqtarë të Rrethit Gjyqësor dhe të Gjykatës së Apelit Durrës për gjykim të padrejtë të tyre, të njëanshëm, duke bërë të mundur tjetërsimin e pronës së tyre pranë \*\*\*, Durrës, e duke ua dhënë njerëzve të tjerë. Bashkëlidhur formularit të denoncimit gjendet një akt ekspertimi i muajit shtator 2016, ku vërehet se Gjykata e Apelit Durrës ka kërkuar kryerjen e aktit të ekspertimit në lidhje me padinë e ngritur nga vëllai i denoncuesit A.Sh, me objekt “Lirim dhe dorëzim trualli”. Por, duke mos pasur mundësi informimi për ecurinë e një procesi gjyqësor apo vendimi konkret, ku gjyqtar të ketë qenë subjekti i rivlerësimit, u telefonua denoncuesi për një informacion më tepër në lidhje me përcaktimin e një intervali kohor të zhvillimit të një gjyqi të mundshëm, ku Komisioni të mund të kërkonte vendime gjyqësore konkrete. Nga numrat telefonikë të shënuar në formularin e denoncimit u mundësia komunikimi telefonik me denoncuesin, i cili theksoi se me shtetasit “zaptues të pronës” vazhdon konflikti ende edhe sot dhe janë në pritje të Gjykatës së Lartë për t'u shprehur në lidhje me rekursin e paraqitur aty. Denoncuesi sqaroi se ky konflikt në rrugë gjyqësore ka filluar që në vitin 2002 me një kalvar gjyqesh, të cilat janë përsëritur e rikthyer disa herë. Ndërsa, për sa i përket subjektit të rivlerësimit (i përmendur krahas shumë subjekteve të tjerë në formularin e denoncimit), ai ka qenë gjyqtar në çështjen me objekt “Korrigjim të palëve ndërgjyqëse”, rreth vitit 2016, por, ndërkohë nga komunikimi me të, ai ankohej për shumë subjekte në Gjykatën dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, por pa adresuar ankesë të drejtpërdrejtë për subjektin Vladimir Skënderi.

Ndodhur në këto kushte, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

### **13.7 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2018, i shtetasit Ll.Z**

Denoncuesi i drejtohet në vitin 2018 Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe për dijeni Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe shumë instancave shtetërore e organizmave ndërkombëtarë. Ai ankohet për gjyqtarin Vladimir Skënderi në lidhje me një çështje të shqyrtuar prej tij, ku ankuesi ka qenë në cilësinë e palës paditëse dhe palë e paditur ka qenë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Gjyqtari Vladimir Skënderi ka shqyrtuar kërkesën me objekt “Zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes së datës 31.3.2010, të realizuar mes palëve ndërgjyqëse. Detyrimin e palës së

paditur t'i kthejë shumën prej 60,000 euro, si dhe kamatëvonesat që nga dita e bërjes së pagesës së të paditurit...". Në fund të shqyrtimit, gjykata e ka rrëzuar këtë kërkesë me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2018. Ankuesi pretendon se, pavarësisht se ai ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi, vlerëson se procedura e ndjekur gjyqësore në shkallë të parë duhet hetuar.

Referuar ankesave të shtetasit Ll. Z, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për vënien në dispozicion vendimin e sipërcituar, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, si dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim evidentimin e kryerjes së shkeljeve disiplinore nga ana e z. Vladimir Skënderi, në cilësinë e gjyqtarit të kësaj çështjeje në shkallë të parë Durrës.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka sjellë vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2018. Sipas këtij vendimi, ankuesi Ll. Z i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë, me objekt "Zgjidhjen e kontratës së sipërmarrjes të realizuar mes tij dhe shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k. dhe detyrimin e këtij të fundit për t'i kthyer 60,000 euro, si dhe kamatëvonesat që nga dita që i është bërë pagesa të paditurit e deri në ditën e ekzekutimit të kthimit të shumës, si dhe marrjen e masës provizore të sigurimit të padisë...".

Rezultoi se palët kanë nënshkruar kontratë sipërmarrjeje në vitin 2010 për një dyqan me sip. 60 m<sup>2</sup> dhe dy garazhe me sip. 46 m<sup>2</sup>, në shumën 156,800 euro, shumë të cilën do ta likuidonte me këste brenda vitit 2011. Në zbatim të kontratës është paguar nga pala blerëse, ankuesi, vlera 60,000 euro dhe ka mbetur pa u paguar vlera 96,800 euro. Pala e paditur pretendoi se ndërtimi kishte mbaruar dhe paditësi nuk ka dashur të marrë në posedim sipërfaqet e prenotuara. Paditësi (ankuesi) ka pretenduar se projekti ka pësuar ndryshime dhe, për rrjedhojë, ai ka kërkuar zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e parave sipas objektit të kërkesëpadisë. Gjyqtari, pasi ka dëgjuar palët, në përfundim të shqyrtimit të padisë ka arsyetuar se nuk konstatohet mospërbushje e kontratës nga ana e të paditurit, për shkak se dyqani i ndërtuar është më i madh se 60 m<sup>2</sup> (nga parashikimi i kontratës), dy garazhet janë ndërtuar në përputhje me kontratën dhe rruga e hyrjes në bodrum nuk është parashikuar në kontratë dhe këto nuk përbëjnë shkak për zgjidhjen e kontratës nga palët. Për më tepër, gjykata ka arsyetuar se pala paditëse (ankuesi) nuk ka përmbushur detyrimin kontraktor (kryerjen e pagesës së plotë brenda afatit). Në këto kushte, shihet se gjykata me vendimin e datës 12.3.2018 ka pranuar kërkesën për sigurimin e objektit të padisë, ku ka vendosur sekuestrimin pasurive dhe kredive të të paditurit në masën 60,000 euro, por me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2018, ka rrëzuar kërkesëpadinë e paditësit (ankuesit Ll. Z). Gjykata e Apelit ka ndryshuar këtë vendim, duke pranuar kërkesëpadinë e ankuesit dhe duke e detyruar përmbarimin për zbatimin e tij.

Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kthyer përgjigje kërkesës së Komisionit në lidhje me ecurinë e vendimmarrjes së saj, në lidhje me ankesën e shtetasit Ll. Z. Me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2022, ILD-ja ka vendosur arkivimin e ankesës së shtetasit Ll. Z.

Sa më sipër, referuar edhe vendimmarrjes së ILD-së, por duke parë edhe që ankesa e shtetasit Ll. Z lidhej me procesin vendimmarrës të gjyqtarit dhe jo me shkelje direkte procedurale të kryera prej tij në procesin civil, Komisioni vlerësoi se nuk kishte shkak për hetimin e mëtejshëm për subjektin e rivlerësimit.

### **13.8 Denoncim i përsëritur i shtetasit G.T me nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2018**

Në datën 15.11.2018, denoncuesi ka paraqitur pranë Komisionit një kopje të kallëzimit të tij penal, të paraqitur përpara Prokurorisë së Krimeve të Rënda në datën 14.11.2018, i cili ka kallëzuar subjektin e rivlerësimit dhe disa subjekte të tjerë, si avokatë, noterë e nëpunës shtetërorë për veprat penale, parashikuar nga neni 333/a i Kodit Penal dhe neni 283 i Kodit të Procedurës Penale.

Ndërsa, në datën 16.11.2018 (1 ditë më pas), denoncuesi paraqet përpara Komisionit një denoncim ku denoncon gjyqtarin Vladimir Skënderi *për marrje ryshfeti, për dhënie vendimesh me dokumente të Tiranës, që nuk kanë lidhje me pronën në Durrës*. Bashkëlidhur, denoncuesi ka sjellë 3 vendime për të njëjtën çështje dhe tek vendimi i tretë, sipas denoncuesit, gjyqtari ka ndryshuar vendimmarrjen pasi ka marrë ryshfet.

Rrethanat e çështjes: Denoncuesi bashkë me familjarët e tij janë paditur nga kushërinjtë e tyre (fëmijët e xhaxhait), të cilët kanë kërkuar detyrimin për njohjen bashkëpronar të paditësve në pjesë të barabarta për truallin me sip. 400 m<sup>2</sup>, që ndodhet në qytetin e Durrësit etj. Gjykata me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.5.2017, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit Vladimir Skënderi, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë objekt gjykimi, duke i njohur bashkëpronësinë paditësve në pasurinë truall objekt gjykimi.

Në vështrim të dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit, sidomos vendimit nr. \*\*\*, datë 8.5.2017, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit Vladimir Skënderi, evidentohet se denoncuesi në cilësinë e palës së paditur, bashkë me të tjerët, ka kundërshtuar vendimmarrjen e subjektit dhe, për këtë, në datën 25.5.2017 i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë me ankesë ndaj vendimmarrjes së gjyqtarit në lidhje me vendimin e sipërcituar. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2017, KLD-ja, nëpërmjet Inspektoratit ka njoftuar denoncuesin G.T në lidhje me arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, për shkak se pretendimet e denoncuesit lidhen me ligjshmërinë e vendimit dhe, si të tilla, ato mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet apelimit gjyqësor.

Denoncuesi ka sjellë edhe kopje të kërkesës ankimore ndaj vendimit të sipërcituar me gjyqtar Vladimir Skënderi dhe kopje të vendimit nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 3.12.2018, të Gjykatës së Apelit, i cili ka rrëzuar vendimin nr. \*\*\*, datë 8.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me gjyqtar V. Skënderi. Pavarësisht faktit se Gjykata e Apelit ka rrëzuar vendimin e shkallës së parë me gjyqtar Vladimir Skënderi, duke i dhënë të drejtë ankuesit, vlerësohet se nuk është detyrë e Komisionit të gjykojë në lidhje me bazueshmërinë ligjore të një vendimi të caktuar, për sa kohë ajo është atribut vetëm i gjykatës.

Ndërsa, në lidhje me vendimet e gjyqtarit Vladimir Skënderi “Për plotësimin e të metave”, datë 28.4.2015 dhe “Pushimin e gjykimit të kërkesëpadisë”, datë 12.1.2016, si dhe referuar procesverbaleve të këtyre proceseve gjyqësore, nuk u konstatuan shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të shortuar për çështjen në fjalë.

### **13.9 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2019, i shtetasit A.B**

Në vitin 2019, denoncuesi A. B ka paraqitur kallëzim penal përpara Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, z. Vladimir Skënderi, dhe gjithashtu ka bërë me dije edhe Komisionin.

Në kallëzimin e tij, ai akuzon subjektin e rivlerësimit për kryerjen e veprave penale “shpërdorimi i detyrës”, “kryerje e veprimeve arbitrare”, “falsifikim i dokumenteve” etj. Këtë kallëzim ai e lidh me procesin e gjyqimit dhe me vendimmarrjen e z. Vladimir Skënderi në cilësinë e gjyqtarit në çështjen me objekt “Lirim dhe dorëzim të pasurisë së paluajtshme, apartament banimi”.

Sipas denoncuesit, gjyqtari me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2019, ka favorizuar palën me të cilën ishte në konflikt, duke i tejkaluar edhe kufijtë e kërkimeve të palës kundërshtare, duke mos pranuar kërkesat e palës paditëse dhe duke mos lejuar marrjen e provave me dëshmitarë dhe marrjen e provave të reja; duke i pranuar prova të reja vetëm njëherë palë (palës së paditur); duke mos respektuar të drejtën e fjalës dhe të shprehjes, të drejta të cilat mbrohen nga Kushtetuta dhe Konventa për të Drejtat e Njeriut.

Gjithashtu, denoncuesi vazhdon ankesën e tij, duke thënë se gjyqtari ka shkelur nenin 304 të Kodit të Procedurës Civile duke riçelur hetimin dhe duke mos respektuar të drejtat e palëve në proces. Ai është treguar i njëanshëm dhe ka mbajtur qëndrim abuziv dhe ky qëndrim është shprehur në të gjitha seancat gjyqësore (duke ndryshuar të dhënat e seancave gjyqësore).

Me qëllim verifikimin e shkeljeve të mundshme të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës vendimin nr. (\*\*\*) \*\*\*, datë 31.1.2019 dhe procesverbalin e seancave gjyqësore të këtij procesi gjyqësor, si dhe informacionin për ecurinë e këtij procesi në shkallë të tjera të gjyqësorit.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka sjellë vetëm vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2019 dhe jo procesverbalin e seancave gjyqësore, duke sqaruar se çështja është për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe, në këto kushte, përcjellja e procesverbaleve është objektivist e pamundur.

Nga verifikimi i vendimit të sipërcituar, rezulton se denoncuesi A. B i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë për lirim sendi (apartamenti) nga ish-bashkëshortja e tij, R. B. Ndërkohë, ish-bashkëshortja i është drejtuar gjykatës me kundërpadi, duke kërkuar që A. B. ta njohë si bashkëpronare në apartamentin e banimit, me pretendimin se është një pasuri e vënë pas martesë dhe për të cilën ajo ka kontribuar. Gjithashtu, pala e paditur/kundërpaditëse R. B. argumenton se në vendimin e zgjidhjes së martesës ndërmjet saj dhe ankuesit A. B., gjykata, ndër të tjera, i ka dhënë të drejtë R. B. të jetojë bashkë me vajzën e mitur në apartamentin e blerë gjatë martesës dhe ish-bashkëshorti ka qenë dakord për këtë fakt, duke lidhur edhe aktmarrëveshje noteriale për pjesëtim vullnetar të apartamentit. Gjykata në përfundim ka rrëzuar kërkesën e ankuesit A. B. dhe i ka dhënë të drejtë ish-bashkëshortes R. B., duke e njohur këtë të fundit si bashkëpronare në apartamentin në të cilin kanë jetuar të martuar.

Nga sa u relatua më sipër, nuk vihen re shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit. Por, referuar pretendimit të ankuesit se gjyqtari ka shkelur nenin 304 të Kodit të Procedurës Civile duke riçelur hetimin dhe duke mos respektuar të drejtat e palëve në proces, Komisioni nuk mund të hetonte më tej, për shkak se çështja është duke u gjykuar në Gjykatën e Apelit dhe është ajo gjykatë që do mund të shprehet për çdo shkak ankimi të denoncuesit.

### **13.10 Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2019, të shtetasit K.N**

Denoncuesi i është drejtuar Komisionit me ankim ndaj z. V. Skënderi, gjyqtar në çështjen me objekt “Anulimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 11.11.1993, të KKKP-së Durrës (sot Agjencia e

Trajtimit të Pronave); zgjidhjen e pasojave, duke fshirë e çregjistruar pronësinë e të paditurve K.N etj.”, duke e bazuar këtë kërkesëpadi kryesisht në faktin se, sipas tij, vendimit të sipërcituar të KKKP-së nr. \*\*\*, datë 11.11.1993, i ishte shfuqizuar baza ligjore nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.4.2000 (i cili shfuqizon me shtesën e bërë me ligjin nr. 7916, datë 12.4.1995, në nenin 1 të ligjit nr. 7698/1993..., duke përfshirë edhe ligjin nr. 37, datë 13.1.1945 “Për tatimin e jashtëzakonshëm”).

Bashkëlidhur këtij ankimi, gjendet vendimi nr. \*\*\*, datë 19.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili ka vendosur “Anulimin pjesërisht të vendimit nr. \*\*\* të KKKP-së për pjesën që i ka njohur pronësinë të paditurve...” (ku bën pjesë edhe denoncuesi”).

Në ankimin e tij, ankuesi pretendon se ky vendim është absurd dhe gjyqtari nuk mban përgjegjësi për veprimet e tij, duke vendosur vetëm mbi bindjen e tij të brendshme.

Gjithashtu, disa javë më vonë, në datën 13.5.2019, denoncuesi paraqet një kopje të kërkesës ankimore të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, ku kjo e fundit ankimon vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Sa më sipër, Komisioni vlerëson se nuk mund të bëhet pjesë e shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të Shkallës së Parë Durrës, përderisa ky është atribut i një gjykate më të lartë, siç është Gjykata e Apelit në rastin konkret. Në këto kushte kur palët mund të ankimojnë vendimin e një shkalle sipas hierarkisë gjyqësore në gjykatën më të lartë, Komisioni nuk kryen hetim të mëtejshëm administrativ.

### **13.11 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2019, i shtetasit F.Rr**

Ky shtetas kërkon t’i bëjë prezent Komisionit “shkeljet e lejuara” nga gjyqtari V. Skënderi në një gjykim ku ai ka qenë si i kundërpaditur, të cilat vijjnë si *rrjedhojë e mungesës së profesionalizmit të këtij gjyqtari*, por edhe si *rrjedhojë e bindjes së tij të brendshme*.

Ankuesi shpjegon se ka qenë në rolin e qiradhënësit referuar një kontrate qiraje me qiramarrësin (S.Sh) dhe, një muaj para përfundimit të kontratës, ankuesi F. Rr. i dërgon njoftim noterial se marrëdhënia kontraktore pas skadimit të afatit nuk do të vazhdonte më tej. Por, qiramarrësi pas skadimit të afatit nuk e dorëzon sendin, çka e detyron ankuesin t’i drejtohet Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në gjykim, pala e paditur S. Sh. është mbrojtur me kundërpadi të ngritur në datën 13.2.2015, ku të kundërpaditur, përveç ankuesit, janë thirrur edhe tri subjekte të tjera, P. S., G. Gj. dhe N. P., nga të cilët vetëm ankuesi kishte ngritur padi. Në përfundim të gjykimit, gjykata ngarkon ankuesin F. Rr. me detyrimin ndaj të paditurit/kundërpaditës në vlerën 250,000 lekë (si fitim i munguar i S. Sh nga restaurimi i pallatit prej N. P.). Referuar pjesës arsyetuese të vendimit, sipas gjyqtarit, ky detyrim i ngarkohej F. Rr., sepse ai kishte bashkëpunuar me të kundërpaditurin N. P. për restaurimin e pallatit, ku ka biznesin edhe i padituri S. Sh. dhe se nga punimet e N. P. në këtë pallat S. Sh. i është dëmtuar aktiviteti tregtar.

Sipas gjykatës, bashkëpunimi i denoncuesit me N. P. provohet me deklaratën noteriale të datës 28.1.2014, ku denoncuesi shpreh dakordësinë që pallati të restaurohet, por sipas denoncuesit kjo deklaratë është nënshkruar prej tij 4 muaj pas ndërprerjes së punimeve në pallat. Denoncuesi ankohet se rrethana të tilla janë dëshmi e një gjykimi të padrejtë e të njëanshëm nga ana e një gjyqtari, që vërtetojnë kapjen e tij nga korruptimi.



Komisioni vlerësoi se ankesa e shtetasit F. Rr lidhet direkt me vendimmarrjen e gjyqtarit dhe, për këtë shkak, nuk mund të hetohet më tej për subjektin e rivlerësimit.

### **13.12 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2019, i shtetasit V.B**

Ky shtetas denoncon subjektin e rivlerësimit për fshehje pasurie dhe korrupsion. Ai vazhdon duke thënë se *në gjyqin që ka 5 vite që ka filluar dhe akoma vazhdon, ai është i njëanshëm, sepse ka bërë gjyqin e divorcit dhe të ndarjes së pasurisë, duke mos marrë për bazë provat e prokurorisë, për shkak se bashkëshortja e tij ka falsifikuar firmën dhe ka mashtruar duke shitur tokën dhe duke privatizuar shtëpinë e prindërve të ish-bashkëshortit.*

Por, denoncuesi V. B. nuk citon asnjë vendim apo akt shkresor të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, i cili të mund të bëhet edhe objekt hetimi administrativ në këtë proces rivlerësimi të subjektit. Dhe, për këtë shkak, nuk mund të vazhdohet më tej me hetimin për këtë ankesë të shtetasit V. B.

### **13.13 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2019, i shtetasit E.D**

Ky shtetas ankohet se gjyqtari Vladimir Skënderi dhe av. Sh. L. po mundohen t'i heqin të drejtën e pronës të dhënë nga ligji nr. 7501, duke rihapur dosjet dhe duke marrë një vendim të dytë në kundërshtim me vendimin e dhënë në vitin 2014, i cili kishte marrë formë të prerë. Bashkëlidhur formularit të denoncimit, denoncuesi ka sjellë një kopje dokumenti AMTP të vitit 1995 në emër të denoncuesit, një certifikatë pronësie për këtë pasuri 4.000 m<sup>2</sup> tokë arë, si dhe faqen e fundit (pjesën vendimmarrëse të një vendimi të Gjykatës së Apelit). Ky vendim duket se ka ndryshuar vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) datë 19.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili mund të jetë dhënë nga gjyqtari Vladimir Skënderi.

Në analizë të dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit, vërehet se AMTP-ja dhe certifikata e pronësisë janë në emrin e shtetasit E. D (denoncuesit), ndërsa duke parë dispozitivin e vendimit të Gjykatës së Apelit (faqja e fundit e vendimit të Gjykatës së Apelit, sjellë nga denoncuesi) përmenden disa emra, por jo emri i denoncuesit. Në këto kushte, me këtë informacion shkresor jorelevant me subjektin e vlerësimit nuk mund të hetohet më tej.

### **13.14 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2021, i shtetasit A.M**

Denoncuesi përmend tre emra subjektsh, ku njëri prej tyre është subjekti i rivlerësimit V. Skënderi, për të cilët thotë: *“Ata janë kthyer në makth për të gjithë jo vetëm për ryshfetet, por edhe për aftësitë e tyre profesionale. Ata janë të paaftë dhe kryejnë shkelje profesionale”*. Denoncuesi nuk përmend çështje konkrete ku mund të shtrihet hetimi administrativ i Komisionit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, kjo ankesë pa emër duhet të arkivohet pranë Komisionit.

### **13.15 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2021, i shtetasit B.K**

Ky shtetas, në formularin e denoncimit të tij për subjektin Vladimir Skënderi, ka nënvizuar se: *“Nuk bën gjyq pa marrë ryshfet...”*, por nuk paraqet asnjë situatë apo rrethanë konkrete ku mund të shtrihet hetimi administrativ.

### **13.16 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2021, i shtetasit F. D**

Ky shtetas ka denoncuar faktin se gjyqtari Vladimir Skënderi në datën 7.12.2016 ka marrë vendimin (\*\*\*) \*\*\* për tjetërsimin e pronës së tij prej 2.400 m<sup>2</sup> në 400 m<sup>2</sup> në mungesë të tij,

duke mos e informuar atë me kërkesën për njohje pronarë të “trashëgimtarëve” të I. D, pa autorizimin e tyre, në konflikt interesi. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.11.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të sipërcituar dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë me një tjetër trup gjykues (me gjyqtar M. K.).

Me qëllim investigimin e këtij denoncimi, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku ka kërkuar kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.12.2016, të kësaj Gjykate, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit (vendimin e sipërcituar në denoncim).

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka sjellë vendimin e sipërcituar nr. \*\*\*, datë 7.12.2016, me gjyqtar Vladimir Skënderi, me të cilin është pranuar padia e paditësit G.D, për njohjen pronar si trashëgimtar të I. D mbi truallin me sip. 400 m<sup>2</sup>, në Durrës. Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur prishjen e vendimit të sipërcituar dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Nga denoncimi dhe nga vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës (ardhur nga gjykata sipas kërkesës së Komisionit) me gjyqtar Vladimir Skënderi evidentohen këto fakte: Denoncuesi F.I.D nuk është palë në këtë vendim gjyqësor; pala kërkuese në vendim quhet G.D, i biri i A.I. D, pra G.D është nip me denoncuesin F.D.

Shtetasi G.D i është drejtuar Gjykatës me kërkesën “njohje pronar”, referuar dëshmisë së trashëgimisë ligjore të dy gjyshërve të tij dhe babait të tij (dëshmi të dhënë nga gjykata në vitin 2010). Gjykata ka pranuar këtë kërkesë të shtetasit G.D dhe ka vendosur njohjen pronar si trashëgimtar të I. D. Prishja e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.12.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit dhe kthimi i çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, çon në dyshimin se Gjykata e Apelit ka konstatuar shkelje procedurale të kryera nga gjyqtari i çështjes, z. Vladimir Skënderi. Kjo referuar praktikës gjyqësore, që kur një gjykatë më e lartë kthen një çështje për rigjykim në gjykatën që ka shqyrtuar çështjen në themel, më së shumti arsyet që gjykata të marrë këtë vendim lidhen me mangësitë dhe defektet procedurale të zhvillimit të procesit gjyqësor.

Sa më sipër, në funksion të qartësimit të situatës për këtë çështje, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime të mëtejshme në lidhje me këtë proces gjyqësor dhe ecurinë e tij të mëpasshme.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“F. dhe G. Gj. janë trashëgimtarë të I. Gj. Në datën 28.1.2016, G. Gj., në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve të I. Gj., i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për njohjen e pronësisë mbi truallin 400 m<sup>2</sup>. Në përfundim të gjykimit kam pranuar kërkesëpadinë, duke detyruar palën e paditur që të njohë ish-pronar të ndjerin I. Gj., pra edhe të birin e tij F. Gj., krahas trashëgimtarëve të tjerë. Kërkesëpadinë dhe ndërgjyqësinë e rregullon paditësi. Gjykata nuk ndërhyri, sepse ajo mënyrë e shënimit të ndërgjyqësisë ishte në përputhje me nenin 296 të Kodit Civil. Pra, kërkesëpadinë mund ta ngrejë njëri nga bashkëpronarët dhe nuk është kusht që të ishin të gjithë të pranishëm. Ata nuk kishin konflikt me njëri-tjetrin (në këtë rast do të ishte e detyrueshme prania e tyre), por kërkonin njohjen pronar nga shteti. Megjithatë, edhe në rigjykim gjyqtari M. K. ka marrë të njëjtin vendim sikurse unë, pra zgjidhja në themel nuk ka ndryshuar”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

Në shpjegimet përfundimtare, subjekti ka cituar nenin 296 të Kodit Civil, me argumentimin se *“...çdonjëri nga bashkëpronarët mund ta kërkojë sendin me qëllim që ai t’u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve”*.

Gjithashtu, subjekti ka sjellë vendimin e gjyqtarit M. K., nr. \*\*\*, datë 11.11.2019, duke argumentuar se edhe një gjyqtar tjetër ka marrë të njëjtin vendim për sa i përket themelit të tij. Por, nga leximi i këtij vendimi evidentohet se Gjykata e Apelit ka prishur vendimin e Shkallës së Parë me gjyqtar V. Skënderi, duke lënë detyra për gjykatën dhe ka nënvizuar shkeljet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në kuptimin e shkeljeve procedurale, atë të mosthirrjes së trashëgimtarëve të tjerë të I. Gj., veçanërisht duke shtuar edhe faktin se palët bashkëpronare ishin në konflikt me njëra-tjetrën.

Referuar nenit 189 e vijues të Kodit të Procedurës Civile , gjyqtari V. Skënderi duhej të kishte thirrur si palë të interesuara në proces edhe bashkëpronarët e tjerë të paditësit G. D (shihni vendimin nr. \*\*\*, datë 7.12.2016). Vërtet, gjyqtari M. K. ka dhënë të njëjtin vendim për sa i përket zgjidhjes në themel të tij, por ai duket se ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit.

Sa më sipër, për Komisionin rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer shkelje procedurale në gjykimin e çështjes, në vendimin nr. \*\*\*, datë 7.12.2016, shkelje të cilat bien ndesh me nenin 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe që konsiderohen nga trupi gjykues në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit në lidhje me aspektin e vlerësimit profesional.

### **13.17 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2022, i shtetasit L.S**

Ky shtetas i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për dijeni Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe ankohet për dhënie vendimi në kundërshtim të hapur me ligjin dhe gjithashtu se gjyqtari Vladimir Skënderi ka gjykuar një çështje të gjykuar më parë, por këtë e ka bërë vetëm për t’i shkuar për shtat interesave të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Rrethanat e çështjes: Denoncuesi L. S dhe shtetasi S. M kanë nënshkruar në vitin 2012 me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. në cilësinë e porositësve kontratën e sipërmarrjes, ku kanë porositur ndërtimin e 4 apartamenteve, për të cilat kanë rënë dakord për çmimet e shitjes, vlera të cilat janë likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës. Me përfundimin e ndërtimit të tyre, rezultoi se ato janë regjistruar në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. në vitin 2014. Shtetasit L. S dhe S. M. i janë drejtuar me kërkesëpadi gjykatës që të detyrojë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. të përmbushë kontratën e sipërmarrjes, duke iu dorëzuar atyre 4 apartamentet e porositura. Gjykata ka pranuar kërkesën dhe ka vendosur detyrimin e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. t’u dorëzojë atyre apartamentet e porositura dhe t’u paguajë dëmin e shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit të vendimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

Ndërsa paditësit E. C. etj. kanë kundërshtuar ekzekutimin e vendimit të mësipërm, me pretendimin se ata kishin lidhur kontrata sipërmarrjeje dhe kishin kryer pagesat për 4 apartamentet (të njëjtat) me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., para se shtetasit L. S. dhe S. M. të kontaktonin me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Bashkëlidhur ankimit të shtetasit L. S. gjenden vendimet e gjykatave, duke filluar nga vendimi nr. \*\*\*, datë 5.3.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendimi nr. \*\*\*, datë 26.9.2019, i Gjykatës së Apelit Durrës; vendimi nr. \*\*\*, datë 30.9.2020, i Gjykatës së Lartë; dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 14.2.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me gjyqtar V. Skënderi, i cili

duket se u ka dhënë të drejtë kërkuesve E. C. etj., duke detyruar shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k dhe palët L. S. (ankuesin) dhe S. M. që të njohin pronarë paditësit E. C. etj., si dhe ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të kontratës së sipërmarrjes ndërmjet të paditurve L. S. e S. M. dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, Komisioni, pasi verifikoi vendimin nr. \*\*\*, datë 5.3.2018, me gjyqtare B. G. dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2020, me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, arriti në konkluzionin se nuk jemi para “gjësë së gjykuar” dhe, për këtë arsye, nuk rezulton që subjekti të ketë kryer shkelje procedurale në gjykimin e kësaj çështjeje.

Ndërsa për sa i përket pretendimit se vendimi i dhënë nga subjekti është në kundërshtim të hapur me ligjin, ky pretendim i ankuesit mbetet në kufijtë e gjykimin të tij personal dhe nuk mund të jetë objekt hetimi nga ana e Komisionit.

### **13.18 Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2023, i \*\*\* (\*\*\*)**

Kjo kërkesë për verifikim ka mbërritur pranë Komisionit nga kryetari i kësaj shoqate, përfaqësuesi i saj N.P, i cili ka nënvizuar si objekt të saj përcjelljen e informacionit lidhur me veprimet e kryera nga gjyqtari Vladimir Skënderi dhe prokurori E. K., në lidhje me procedimin penal të vitit 2022 për transportimin e një sasive të dyshuar kontrabandë me anijen “\*\*\*\*”. Sipas ankuesit, ky rast po zvarritej qëllimisht, duke mbajtur nën masën e sigurimit “arrest në burg” një shtetas të huaj pa asnjë mbështetje dhe që për disa muaj me radhë çështja ishte lënë pa veprime dhe se dyshimet u përforcuan, pasi vendimi gjyqësor për caktimin e masës së sigurimit personal nuk ishte zbardhur dhe njoftuar të arrestuarve në IEVP Durrës që prej muajit shtator, kur ishin ndaluar, deri në dhjetor të vitit 2022. Sipas këtyre konkluzioneve, ankuesi pretendon se konstatohen veprime, të cilat janë në kundërshtim me ligjin nga ana e gjyqtarit dhe prokurorit të çështjes, të cilët ishin dakordësuar në mënyrë të heshtur për një çështje e cila, ndonëse ishte ankimuar, ishin pranuar dy kërkesa të reja për zëvendësim mase sigurimi, çka krijonte dyshime për implikim në paligjshmëri, veprime të cilat cenojnë besimin e publikut tek drejtësia.

Me qëllim vlerësimit objektiv të këtyre ankesave të kryetarit të shoqatës “\*\*\*\*”, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesën<sup>61</sup> për vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve të çështjes në hetim, të regjistruar në datën 14.9.2022, me objekt transportimin e një sasive naftë të dyshuar kontrabandë me anijen “\*\*\*\*”, nr. (\*\*\*), datë 27.2.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që kanë të bëjnë me kërkesat për zëvendësim mase sigurimi. Për këto vendime është kërkuar edhe informacion për ecurinë e tyre në shkallët e tjera të gjyqësorit.

Me shkresën kthim përgjigjeje<sup>62</sup> të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës Komisioni informohet me vendimet (8) e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të procesit të hetimit të çështjes në ngarkim të 4 shtetasve të arrestuar: Z.A, A.A dhe M.A.A, të dyshuar për kryerjen e veprës penale “tregtim dhe transportim i mallrave që janë kontrabandë”, parashikuar nga neni 178/3 i Kodit Penal.

Nga rrethanat e çështjes konstatohet se nga ana e organeve ligjzbatuese është marrë informacioni se anija naftëmbajtëse “\*\*\*\*” është ngarkuar me hidrokarbure të dyshuara kontrabandë dhe është nisur nga porti i \*\*\*, Libi dhe pritej të përpunohej në \*\*\* Durrës, e cila është nisur në datën 9.9.2022 dhe pritej të mbërrinte në datën 12.9.2022, me qëllim shitjen e saj subjektit tregtar shqiptar “\*\*\*\*” sh.a. Pavarësisht njoftimit dhe vënies në dispozicion të

<sup>61</sup> Shihni kërkesën për informacion të Komisionit nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2023, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

<sup>62</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 1.6.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

dokumentacionit 24 orë përpara mbërritjes, anija nuk kishte ancoruar në \*\*\* për të shkarkuar ngarkesën sipas deklaramit të bërë, por ka kërkuar të largohet përsëri nga territori shqiptar. Nga ana e organeve ligjzbatuese është vendosur që anija t'i nënshtrohet një kontrolli të plotë si nga ana e dokumenteve, ashtu edhe nga ana fizike, duke e ancoruar anijen në \*\*\*, në kalatën nr. \*\*\*. Nga ana e kontrollit doganor është marrë dokumentacioni, nga ku është konstatuar se sasia e ngarkesës naftë në tonë nuk lejohet për përdorim në tregun shqiptar, por lejohet për rieksporim dhe furnizim për anijet dhe mjetet lundruese, që udhëtojnë jashtë territorit shqiptar. Gjithashtu, nga matja e sasisë së karburantit kanë rezultuar disa tonë më pak naftë sesa sasia e dokumentuar. Katër personat e arrestuar/ekuipazhi i anijes cisternë ishte i përbërë nga kapiteni i anijes “\*\*\*\*”, oficeri i sigurisë dhe 2 përgjegjës ngarkim-shkarkimi.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.9.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur të vlerësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të të arrestuarve të sipërpërmendur për kryerjen e veprës penale, parashikuar nga neni 178/3 i Kodit Penal dhe caktimin ndaj tyre të masës shtrënguese “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit Penal. Nga shënimi rezulton se vendimi mori formë të prerë në datën 19.12.2022, d.m.th. 3 muaj pas miratimit të vendimit.

Ndërsa në datën 4.1.2023 njëri prej të arrestuarve nën masën shtrënguese “arrest në burg” ka kërkuar revokimin e masës së sigurimit, referuar nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të gjendjes së emergjencës ku ndodhet anija e sekuestruar “\*\*\*\*”, e ndodhur në Portin Durrës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.1.2023, ka vendosur të deklarojë të papranueshme kërkesën e kërkuarit Z. A. me objekt “Revokim mase sigurimi” për shkak të heqjes dorë nga kërkesa. Nga shënimi rezulton se “Vendimi mori formë të prerë në datën 6.2.2023”, d.m.th. 1 muaj pas miratimit të vendimit.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesës (referuar nenit 260 e vijues të Kodit të Procedurës Penale) së kërkuarve, duke mos pranuar kërkesën për zëvendësim mase sigurimi.

Nga shënimi në vendim rezulton se palët i janë drejtuar Gjykatës së Apelit, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.3.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit të bërë nga kërkuarit (4 të arrestuarit) kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 6.2.2023.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.2.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesës (referuar nenit 260 e vijues të Kodit të Procedurës Penale) së kërkuarve, duke mos pranuar kërkesën për zëvendësim mase sigurimi.

Nga shënimi rezulton se vendimi mori formë të prerë në datën 4.4.2023, pra 1 muaj e gjysmë pas miratimit të vendimit.

Por, në vazhdimësi rezultojnë dy vendime me të njëjtën datë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përkatësisht:

- Vendimi nr. \*\*\*, datë 15.3.2023, me kërkuar Prokurorinë pranë kësaj gjykate, prokuror E. K., i cili kërkoi zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, e vendosur me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.9.2022, ndaj të dyshuarve Z. A., A. A., M. A. dhe B. T. me “detyrim i qëndrimit në një vend të caktuar”, konkretisht në territorin ku është ancoruar anija “\*\*\*\*” në Durrës, për shkak të humbjes së fuqisë së paraburgimit (kalimit 6 muaj nga ndalimi).

- Vendimi nr. \*\*\*, datë 15.3.2023, me kërkues të dyshuarit, me objekt konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal “arrest në burg” dhe lirimin e menjëhershëm të tyre, ose zëvendësimin me një masë më të butë, në referim të neneve 260 e 263 të Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata ka vendosur deklarinimin e papranueshmërisë së kërkesës, për shkak të heqjes dorë nga kërkesa.

### **Konstatime të Komisionit**

Referuar ecurisë së kësaj çështjeje konstatohet se prokurori i çështjes dhe subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të hetimit paraprak, e kanë zvarritur hetimin dhe përfundimin e hetimit të këtij procedimi penal.

Referuar shënimeve për marrjen formë të prerë në vendimet e gjykatës nr. \*\*\*, datë 16.9.2022, nr. \*\*\*, datë 4.1.2023 dhe nr. \*\*\*, datë 4.1.2023, konstatohet se këto vendime janë arsyetuar nga subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi jashtë afatit 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Për këto konstatime, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime në rezultatet e hetimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Në fakt, denoncimi është bërë nga av. N.P (i cili ishte avokat i çështjes dhe u zëvendësua nga kolegë të tij, shkak që mund të jetë arsyeja e vërtetë e ankesës), sepse nuk rezulton të jetë bërë ndonjë mbledhje e \*\*\*, ku të jetë marrë vendim nga ajo shoqatë për bërjen e këtij denoncimi. Sa i përket pretendimit të avokatit për zvarritje të hetimeve, ky pretendim nuk qëndron. Prokurori përgjigjet vetë për veprimet e tij, por në cilësinë e gjyqtarit të hetimeve paraprake jam në dijeni të mosardhjes së përgjigjeve për letërporositë e nisura në drejtim të Ministrisë së Drejtësisë së Libisë, si dhe të moskthimit të përgjigjeve as nga Ambasada Libiane. Avokati ishte i pakënaqur pse ndaj të mbrojturve prej tij u caktua masa shtrënguese “arrest në burg”, por kjo masë ishte në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale të kontrabandës së naftës, që dyshohet se kishin kryer të arrestuarit. Në momentin kur u ndryshua masa, kjo ndodhi për shkak të përfundimit të afatit 6-mujor të paraburgimit dhe jo për shkaqe korruptive, siç aludon avokati P.*

*Sa i përket pretendimit për zbardhjen me vonesë të vendimeve, sqaroj se nëse vendimi ka marrë formë të prerë pas tre muajsh, kjo datë nuk korrespondon me datën e arsyetimit të vendimit. Afati njëmuajor apo tremujor përmban në vetvete edhe kohën që i duhet postës për të dërguar vendimin tek avokati, i cili mund të mos “gjendet” në zyrë dhe mund të vonojë me keqdashje marrjen dijeni për vendimin. Pas nënshkrimit të avokatit, duhet të kalojnë edhe 15 ditë të tjera që vendimi të marrë formë të prerë. Megjithatë, për shkak të ngarkesës me 800 dosje në atë periudhë, nuk pretendoj që të kem respektuar çdo afat procedural, por e vërteta është se kur ishte fjala për masat e arrestit, ato trajtoheshin me përparësi.*

*Ekzistenca e dy vendimeve në të njëjtën datë ka ndodhur sepse shuarja e masës shtrënguese “arrest në burg” për shkak të mbarimit të afatit 6-mujor, ishte kërkuar njëkohësisht edhe nga mbrojtja, edhe nga prokurori. Për secilën kërkesë ishte hapur fashikull i veçantë. Fillimisht u shqyrtua kërkesa e prokurorit dhe u pranua. Për rrjedhojë, kërkesa e dytë mbeti pa objekt, ajo ishte përsëritje e kërkesës së prokurorit dhe, sipas nenit 471 Kodit të Procedurës Penale, u deklarua e papranueshme”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni vlerësoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit ishin të mjaftueshme në lidhje me afatin e arsytimit, kjo edhe për shkak të ngarkesës së madhe të çështjeve për gjyqtarin Vladimir Skënderi, informacion i marrë ky nga analiza e gjetjeve më sipër, tek vlerësimi profesional i gjyqtarit.

Sa më sipër, Komisioni nuk evidentoi shkelje konkrete në aspektin procedural, të kryera nga ana e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje, që të mund të ndikonin në aspektin e vlerësimit profesional të tij, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

## **TË TJERA**

**14.** Nga *indicie* të mbërritura pranë Komisionit në lidhje me ushtrimin e funksionit si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2023, për kopje të praktikave gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasit K.M, F.Gj, F.K dhe M.Xh.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar pranë Komisionit kopje të vendimeve gjyqësore të kërkuara, të cilat Komisioni i analizoi si vijon:

### **14.1 Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.3.2020, ku palë e pandehur është shtetasi K.M**

Rrethanat e çështjes: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i është drejtuar gjykatës kompetente me gjyqtar subjektin e rivlerësimit me kërkesën “Dërgimin e çështjes për gjykim të shtetasit K. M dhe 7 shtetasve të tjerë”, akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 279/2, 278/6, 300 dhe 283/2 të Kodit Penal. Shtetasi K. M, akuzuar për kryerjen e veprave penale “prodhimi, mbajtja pa leje e armëve të ftohta” dhe “prodhimi, shitja, blerja, tregtimi i armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuara nga nenet 279/2 dhe 278/6 të Kodit Penal.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe provave bashkëlidhur saj, bazuar në nenet 327 dhe 331 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari i seancës paraprake z. Vladimir Skënderi ka vendosur “Pranimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin për gjykim të procedimit penal të vitit 2019, në ngarkim të K. M dhe 7 shtetasve të tjerë”, së bashku me kërkesën për gjykim të shkurtuar. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim (sipas Kodit të Procedurës Penale).

Duket se gjyqtari i çështjes (i seancës paraprake) ka vepruar konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, duke pranuar kërkesën për gjykim të procedimit penal.

Nuk u evidentua mosrespektim apo shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të seancës paraprake.

### **14.2 Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2020, ku palë e pandehur është shtetasi F.Gj**

Rrethanat e çështjes: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës i është drejtuar gjykatës kompetente me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, me kërkesën “Dërgimin e çështjes për gjykim të shtetasit F. Gj dhe 8 shtetasve të tjerë”, akuzuar për kryerjen e veprave penale “shpërdorimi i detyrës”, “falsifikimi i dokumenteve” dhe “ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 248, 186 dhe 199/a të Kodit Penal dhe pushimin e ndjekjes penale për tre persona të tjerë nën hetim.

Në përfundim të gjykimit të seancës paraprahe, Gjykata, pasi dëgjoi kërkesën e prokurorit për pranimin e kërkesës së mësipërme, si dhe pasi dëgjoi kërkesat e avokatëve, arsyetoi si vijon:

*Avokati i F. Gj (dhe 5 të tjerë të pandehur) nuk kishte pretendime për pavlefshmëri e marrje provash të reja, por kërkoi pushimin e akuzës, sepse fakti nuk përbën veprën penale dhe, në rast se gjykata do e kalojë çështjen për gjykim, pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar. Ndërsa tre shtetasit e tjerë ishin dakord me kërkesën e prokurorit, i cili kishte kërkuar pushimin e akuzës për këta shtetas.*

Ka rezultuar nga hetimi se disa shtetas (D. M., A. B., A. B., B. B., K. K., M. D. dhe Y. K.) kanë kryer ndërtime pa leje. N. I. rezulton të ketë kryer dhe dorëzuar tek ALUIZN-i ekspertim të rremë. Ndërsa të pandehurit A. Ç., H. H., S. B. dhe F. Gj akuzohen për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”.

Në kuadër të procedimit penal të vitit 2018 është hetuar në lidhje me punimet pa leje në një objekt ekzistues, që konsistonin në një shtesë anësore në tri katet e poshtme të objektit (pallatit) dhe shtesë në tri kate lartësi (kati 9, 10 dhe 11). Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, gjykata ka vlerësuar se duhet të pranohet kërkesa për dërgimin në gjyq të të pandehurve (7, nga 8 të pandehur), përveç të pandehurit F.Gj, për shkak se në vlerësimin e gjykatës ky i fundit nuk ka kryer veprën penale “shpërdorimi i detyrës”. Organi i akuzës ka pretenduar se shtetasi F. Gj, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së ALUIZNI-t Durrës, ka nënshkruar lejen e legalizimit, datë 21.1.2017, për objektin godinë e kombinuar 10 kate + 1 kat nën tokë, në emër të “\*\*\*\*” sh.p.k., në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9842/2005, i ndryshuar, aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe urdhrin 37/2016 të drejtorit të përgjithshëm të ALUIZNI-t, duke legalizuar një objekt informal, i cili edhe sot rezulton të jetë 9 kate mbi tokë dhe jo 10 kate mbi tokë, sa rezulton leja e legalizimit.

Në vlerësimin e gjyqtarit V. Skënderi, nënshkrimi i lejes së legalizimit datë 21.1.2017 për objektin godinë e kombinuar 10 kate + 1 kat nën tokë nuk është një veprim i kundërligjshëm dhe nuk passjell përgjegjësi penale për shtetasin F. Gj. Ai ka nënshkruar në mirëbesim mbi bazën e verifikimeve dhe akteve të përpiluara nga punonjësit e ALUIZNI-t H. H. dhe S. B., si dhe mbi bazën e aktit të ekspertimit të realizuar nga ekspertja N. I. Nga organi i akuzës nuk është arritur të provohet se shtetasi F. Gj kishte dijeni për rrethanat e rreme të pasqyruara në aktet e përpiluara nga personat e sipërpërmendur, si dhe nuk provohet se F. Gj kishte bashkëpunuar me tre të pandehurit për të legalizuar katin e dhjetë, i cili nuk ekzistonte.

Gjyqtari gjithashtu ka vlerësuar se nuk ishte detyra e drejtorit të ALUIZNI-t që të verifikonte në terren nëse objekti ishte 9 apo 10 kate e as të verifikonte nëse akti i ekspertimit ishte i saktë apo i rremë. Në rastin konkret, është e vërtetë se F. Gj ishte punëdhënës i H. H. dhe S. B., por këta dy shtetas, ashtu si edhe ekspertja N. I., mbajnë përgjegjësi personalisht për shkeljet e ligjit të kryera prej tyre. Për këto shkelje nuk mund të ketë përgjegjësi penale F. Gj vetëm për shkak se ai është titullar i institucionit. Në detyrat e listuara të drejtorit të drejtorisë së ALUIZNI-t nuk përfshihen verifikimi në terren i objektit e as verifikimi i dokumentacionit hartografik apo të pronësisë.

Në këto kushte, gjyqtari ka vendosur se çështja ndaj shtetasit F. Gj duhet pushuar, sepse nuk provohet që ai të ketë kryer veprën penale “shpërdorimi i detyrës” (kur ka nënshkruar lejen e legalizimit nr. xx, datë xx 2017) për objektin godinë e kombinuar 10 kate + 1 kat nën tokë në emër të “\*\*\*\*” sh.p.k.



Prokurori i çështjes e ka ankimuar këtë vendim dhe Gjykata e Apelit Durrës e ka ndryshuar këtë vendim të Shkallës së Parë me gjyqtar V. Skënderi, duke urdhëruar dërgimin e çështjes penale nr. \*\*\*/2018 në gjyq, në ngarkim të të pandehurit F. Gj, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

### **Konstatimi i Komisionit për këtë çështje**

Referuar arsyetimit që gjykata ka bërë në vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2020, ajo në fund ka vlerësuar se krahas tre shtetasve nën hetim (S. B., H. H. dhe E. P.), për të cilët organi i akuzës ka kërkuar pushim procedimi penal, çështja duhet pushuar edhe për të pandehurin F. Gj (sipas cilësimit juridik nga organi i akuzës), sepse nuk provohet që ai të ketë kryer veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, duke e përjashtuar nga përgjegjësia e drejtpërdrejtë këtë të fundit lidhur me funksionet dhe detyrat administrative për shkak të pozicionit të punës si drejtor drejtorie pranë ALUIZNI-t Durrës, përgjegjësi që kanë të bëjnë me shqyrtimin administrativ të praktikave të legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Për sa u përket të pandehurve H. H., S. B. dhe F. Gj, faktikisht organi i akuzës për shkak të pozicioneve të tyre të punës në drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, përkatësisht specialist i sektorit të hartografisë, përgjegjës i sektorit të legalizimit dhe drejtor drejtorie, ka dalë në konkluzionin se të gjithë këta punonjës që janë marrë me praktikën e legalizimit (lejen e legalizimit të objektit që i përket shtetasit A. B.), kanë konsumuar të gjithë elementet e veprës penale “shpërdorimi i detyrës”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248-25 të Kodit Penal, pasi me dashje kanë shkelur ligjin nr. 9842/2006 “Për legalizimin...”, i ndryshuar, duke legalizuar një objekt informal, i cili rezulton 9 kate dhe jo 10 kate, me qëllim krijimin e përfitimit material të kundërligjshëm.

Por, gjyqtari i seancës paraprake ka pranuar kërkesën e prokurorit për të pandehurit H. H. dhe S. B., të dy këta vartës të shtetasit F. Gj, duke i ngarkuar me përgjegjësi penale, me arsyetimin se shtetasi H. H. në cilësinë e përgjegjës të sektorit të hartografisë ka nënshkruar në gen planin bashkëlidhur lejes së legalizimit pa kryer verifikim në terren, duke konfirmuar ekzistencën e një objekti 10 kate, ndërkohë që objekti ka qenë 9 kate. Ndërsa shtetasi S. B. në cilësinë e përgjegjës të sektorit të legalizimit ka nënshkruar lejen e legalizimit në mungesë të dokumentacionit teknik e ligjor (mungesa e aktit të konstatimit në terren, foto të objektit dhe pa marrë vendim kualifikimi të objektit), duke shkelur kërkesat ligjore që përcakton ligji nr. 9842/2006, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. E për shtetasin F. Gj organi i akuzës pretendoi se ai në cilësinë e drejtorit të drejtorisë së ALUIZNI-t Durrës ka nënshkruar lejen e legalizimit për objektin 10 kate, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9842/2006, aktet nënligjore, si dhe të urdhrin nr. 37/2016 të drejtorit të përgjithshëm të ALUIZNI-t, duke legalizuar një objekt informal, i cili edhe sot rezulton të jetë 9 kate dhe jo 10 kate, sa rezulton nga leja e legalizimit.

Me dërgimin për gjykim të specialistit e përgjegjës të sektorit të kësaj drejtorie dhe përjashtimit nga përgjegjësia penale të drejtorit të kësaj drejtorie, shtetasit F. Gj, duket se gjyqtari Vladimir Skënderi ka favorizuar këtë shtetas, duke bërë të mundur shmangien e gjyqimit penal në themel ndaj tij.

Referuar detyrave funksionale të këtyre punonjësve pranë ALUIZNI-t Durrës, përfshirë edhe shtetasin F. Gj, në cilësinë e pozicionit të drejtorit, duket se gjyqtari me përjashtimin nga përgjegjësia e tij direkte administrative ka shmangur edhe përgjegjësinë penale të tij, duke

vendosur pushimin e çështjes për këtë shtetas. Arsyetimi i bërë nga subjekti për pushimin e çështjes ndaj shtetasit F. Gj nuk është zbatuar ndaj të pandehurve të tjerë, që kanë qenë në të njëjtat kushte dhe rrethana me këtë shtetas.

Sa më sipër, për sa kohë vendimi i sipërcituar është prishur nga Gjykata e Apelit, duke urdhëruar dërgimin e çështjes penale në gjyq, në ngarkim të të pandehurit F. Gj, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si dhe duke parë mënyrën e arsytimit ligjor të gjyqtarit V. Skënderi për përjashtimin nga përgjegjësia penale të shtetasit F. Gj, i cilësuar “i pandehur” nga organi i akuzës, Komisioni konstatoi shkelje të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje dhe i kaloi barrën e provës në cilësinë e gjyqtarit të çështjes, për shkak se duket se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar, shqyrtuar dhe dhënë vendim në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, nenet 328, 332/dh dhe 332/ç dhe me dosjen penale të administruar.

### **Qëndrimi i subjektit për këtë çështje**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2020, ku palë e pandehur është shtetasi F. Gj, sqaroj Komisionin se pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Apelit ka vijuar gjykimi me tjetër trup gjykues dhe, në përfundim të gjykimit në themel, F.Gj është deklaruar i pafajshëm. Sqarimet e tjera i kam dhënë në arsyetimin e vendimit dhe jam i gatshëm t'i përsëris përpara Komisionit. Mendoj se vendimmarrja ime ka qenë e bazuar në nenet 331 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave kur gjyqtari i seancës paraprake nuk bindet për ekzistencën e elementeve të figurës së veprës penale konkrete, mund të vendosë pushimin e çështjes”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në shpjegimet përfundimtare, subjekti ka sjellë si provë vendimin e Gjykatës së Rrethit Durrës nr. \*\*\*, datë 7.11.2022, vendim i cili është marrë në zbatim të urdhërimit të Gjykatës së Apelit, e cila ka vendosur dërgimin e çështjes penale nr. xx në gjyq, në ngarkim të të pandehurit F. Gj. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka deklaruar të pafajshëm shtetasin F. Gj, por për Komisionin ky nuk është argument i mjaftueshëm në kuptim të zbatimit të ligjit nga subjekti i rivlerësimit, sepse gjyqtari V. Skënderi kërkoi pushimin e gjykimit për një prej personave përgjegjës në ushtrimin e funksioneve të tij (F. Gj) me qëllim favorizimin e tij.

Gjithashtu, subjekti siguroi Komisionin se ka zbatuar nenet 331 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, por nuk arriti të argumentojë dhe të mbështesë me ligj vendimmarrjen e tij.

Në përfundim, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes ka treguar aftësi të dobët profesionale në drejtim të interpretimit të ligjit dhe identifikimit të konfliktit të normave ligjore në lidhje me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik, në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

### **14.3 Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2021, ku palë e pandehur është shtetasi F.K**

Me vendimin e sipërcituar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me gjyqtar V. Skënderi ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit F.K për kryerjen e veprës penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”, me pasojë vdekjen e shtetases A. H., parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite, dënimin e tij me 2 vite burgim; Aplikimin

e nenit 406/1 të Kodit Penal, që e dënon atë me 16 muaj...; Ndalimin e të pandehurit F. K. të drejtojë automjete për një periudhë 6-mujore, si dhe shpenzimet procedurale hetimore në shumën 63,000 lekë i ngarkohen të pandehurit F. K.”.

Nga gjykimi i kësaj çështjeje ka rezultuar se në datën 7.1.2021 automjeti tip “\*\*\*\*”, i drejtuar nga shtetasi F. K, ka aksidentuar shtetasen A. H., duke i shkaktuar asaj vdekjen. A. H. ishte punonjëse e sigurisë së \*\*\* dhe në ato momente ndodhej në postbllokun e hyrjes nr. \*\*\*, në kalatën e portit.

Gjatë hetimit të çështjes janë kryer një sërë veprimesh hetimore, nga ku ka rezultuar se F. K. nuk kishte pirë alkool dhe se nga ana e viktimës nuk ka pasur shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Nga analiza e akteve të administruara rezultoi qartësisht se nga ana e shtetasit F. K. janë konsumuar elementet e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 290 të Kodit Penal, i cili shprehimisht thotë: *“Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga 2 deri në 10 vjet. Krahas provave e fakteve, ka rezultuar se i pandehuri ka treguar pendesë dhe ka bashkëpunuar me organet e procedimit penal për zbardhjen e ngjarjes, si dhe marrëdhëniet midis të pandehurit e familjarëve të viktimës janë normalizuar.*

*Në përfundim të gjyqimit, subjekti ka dhënë vendimin përfundimtar për të pandehurin, duke e dënuar më pak se masa e dënimit minimal (për shkak të pasojave të veprës penale), e përcaktuar nga neni 290 i Kodit Penal për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen”.*

Për këtë gjetje, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime në rezultatet e hetimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2021, të formës së prerë, ku palë e pandehur është F.K, jam munduar të jem shterues në shkaqet e dhënies së atij vendimi. Nuk është dhënë dënim nën minimumin e parashikuar nga neni 290-2 i Kodit Penal, por është dënuar me minimumin për shkak të ekzistencës së një sërë rrethanash lehtësuese të trajtuara në atë vendim”.*

### **Vlerësimi i Komisionit**

Komisioni vlerësoi se subjekti ka dhënë një vendim me dënim minimal (në pragun dysHEME të sanksionit për këtë veprë penale), duke pasur parasysh pasojat e rënda (humbje jete) dhe rrezikshmërinë shoqërore të paraqitur. Por, shpjegimi i subjektit ishte i mjaftueshëm në aspektin ligjor, në kuptim të pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, duke qenë se Komisioni si institucion rivlerësimi nuk mund të gjykojë korrektësinë e vendimit të magjistratit.

### **14.4 Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2021, ku palë e pandehur është shtetasi M.Xh**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me gjyqtar V. Skënderi, referuar kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Durrës, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin M.Xh për kryerjen e veprës penale “ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite, ta dënojë atë me 5 vite burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të

Procedurës Penale, zbritet 1/3-ta e dënimit dhe i pandehuri dënohet me 3 vite e 4 muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e mbetur të pavuajtur të dënimit, duke e dënuar me kusht për një periudhë prove prej 24 muajsh, periudhë gjatë së cilës i pandehuri M. Xh të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë veprë tjetër penale. Për të pandehurin M. Xh vendimi ka marrë formë të prerë në datën 16.11.2021. Gjithashtu, bashkëlidhur vendimit të mësipërm gjendet edhe vendimi nr. \*\*\*, datë 23.6.2022, “Për ndreqje gabimi”, i cili në dispozitivin e tij përmban urdhërimin e kthimit të sendeve të sekuestruara (telefon e dokumente).

Sa më sipër, vendimi është shpallur në datën 15.6.2021, duke marrë formë të prerë më 16.11.2021 dhe Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar afatin ligjor të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale për zbardhjen e vendimit gjyqësor dhe vënien në dispozicion palëve. Për këtë gjetje Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

### **Qëndrimi i subjektit**

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Data kur vendimi ka marrë formë të prerë nuk është e njëjtë me datën e arsyetimit të vendimit. Këtu duhet të mbahet parasysh dhe koha që i duhet postës për të dërguar vendimin tek avokati i të pandehurit dhe tek palët e tjera pjesëmarrëse në gjykim. Pas nënshkrimit të avokatit duhet të kalojnë edhe 15 ditë të tjera që vendimi të marrë formë të prerë”*. Megjithatë, i vetëdijshëm për shkak të ngarkesës me shumë dosje në atë periudhë, subjekti është shprehur: *“Nuk pretendoj që të kem respektuar çdo afat procedural, pasi një gjë e tillë ishte absolutisht e pamundur”*.

### **Vlerësimi i Komisionit**

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se mosrespektimi i afateve procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk përbën justifikim në aspektin e detyrimit ligjor, por ky fakt do të vlerësohet në vlerësimin përfundimtar të kriterit të aftësive profesionale të subjektit.

## **GJETJE TË VËZHGUESIT NDËRKOMBËTAR**

**15.** Vëzhguesi ndërkombëtar në datën 7.6.2023 ka dërguar pranë Komisionit gjetje<sup>63</sup> bazuar në një çështje profesionale. Komisioni e vlerëson gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar në përputhje me nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016.

**15.1** Gjetja bazohet në faktin e ekzistencës dhe përmbajtjes së një denoncimi të gjetur nga burime mediatike nga \*\*\* në lidhje me një çështje.

**15.2** Vendimi i subjektit të rivlerësimit për të gjykuar një çështje nga e cila ai qartësisht duhej të hiqte dorë, duhet të konsiderohet sipas rrethanave një “gabim serioz... që tregon mungesën e aftësive profesionale”, që duhet të çojë në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, gjykimi i çështjes ka paraqitur edhe disa mangësi të tjera, që mbështesin këto konkluzione.

### **Përshkrimi i ngjarjeve që çuan në vendimin \*\*\*, datë 24.10.2022 dhe pretendimet e ngritura nga \*\*\***

**15.3** Sipas dokumentacionit të disponueshëm, shtetasja Dh.B pretendon se është pronare e një shtëpie ngjitur me murin e xhamisë \*\*\*, pronë e \*\*\*. Me kërkesën e saj për përdorim familjar i është dhënë me qira një truall prej 180 m<sup>2</sup>, me kontratë qiraje të noterizuar datë 31.3.2010, për një periudhë dyvjeçare ndërmjet \*\*\* në cilësinë e qiradhënësit dhe shtetasës Dh.B në cilësinë

<sup>63</sup> Shihni gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, dërguar pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2023.

e qiramarrësit<sup>64</sup>. Rezulton se qiradhënësi ka njoftuar në vitin 2013 qiramarrësin se kontrata e qirasë kishte përfunduar dhe \*\*\* kërkonte kthimin e truallit, së bashku me qiranë mujore ende të papaguar nga qiramarrësi.

**15.4** Shtetasja Dh.B nuk është larguar nga trualli dhe \*\*\* ka bërë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së \*\*\*:

- i) mbi detyrimin e së paditurës Dh.B që t'i paguajë \*\*\* qiratë mujore të papaguara;
- ii) mbi lirimin e truallit;
- iii) nuk ka pranuar kërkesën e Dh.B për ta njohur si pronare të truallit.

**15.5** Ky vendim është ankimuar dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 26.4.2022.

**15.6** Shtetasja Dh. B e ka çuar sërish çështjen në gjykatën e rrethit, por këtë herë ajo ka kundërshtuar vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nr. \*\*\*, datë 15.9.1997, i cili i kishte njohur \*\*\* si pronë të tij pasurinë në fjalë dhe ka kërkuar njohjen e znj. B si pronare e truallit prej 180 m<sup>2</sup>, si dhe sigurimin e padisë.

**15.7** Pesë gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës hoqën dorë nga gjykimi i çështjes së caktuar, me arsyetimin se paditësja është kolege magjistrate, se kanë pasur gjykime së bashku dhe se vendimi i Komisionit për shkarkimin nga detyra të Dh.B nuk ishte ende përfundimtar, sepse ishte ankimuar.

**15.8** Çështja i është caktuar me short subjektit të rivlerësimit Vladimir Skënderi në datën 20.10.2022 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (subjekti i rivlerësimit) ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2022, duke pranuar kërkesëpadinë.

**15.9** Në vendim, subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi ka deklaruar se ai supozojë të hiqte dorë nga gjykimi për të njëjtat arsye si kolegët e tij, por duke qenë se paditësi ka bërë kërkesë të ngutshme për gjykimin e çështjes, ka vazhduar me vendimin. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të pezullojë të gjitha veprimet ligjore në lidhje me tjetërsimin e pronës, si dhurimi, shitja, shkëmbimi ose veprimet përmbartimore.

**15.10** Pasi të gjithë gjyqtarët e tjerë hoqën dorë nga gjykimi, duke përfshirë edhe nënkryetarin e Gjykatës, një kërkesë u dërgua në Këshillin e Lartë Gjyqësor për caktimin e një gjyqtari për gjykimin e çështjes në themel. Ky i fundit ka vendosur në datën 4.11.2022 të caktojë gjyqtarin A. P. nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë për të shqyrtuar procedimin civil në vazhdim.

**15.11** Megjithatë, subjekti i rivlerësimit mori vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2022, i cili është prishur me vendimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. \*\*\*, datë 19.4.2023.

## **Përmbajtja e gjetjes**

**15.12** Ka një ankesë të ngritur nga ana e \*\*\* të cilën ONM-ja e disponon lidhur me mënyrën se si subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2022, e një çështje nga e cila ai duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi. Kjo çështje ka disa mangësi, të cilat do të paraqiten më poshtë.

---

<sup>64</sup> Shtetasja Dh. B është shkarkuar me vendim të Komisionit nr. 370, datë 22.4.2021 dhe ka ushtruar ankim në Kolegj kundër këtij vendimi, ende në shqyrtim edhe sot (shihni <https://kpa.al/njoftim-560/>).

**15.13** Ekziston një standard ligjor i vendosur tashmë nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 2/2017, sipas të cilit: *“54. [...] vlerësimi negativ të bëhet [...] në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”*.

**15.14** Vendimi nr. \*\*\* i datës 19.4.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm vërteton ekzistencën e gabimeve serioze në çështjen e gjykuar nga subjekti i rivlerësimit me vendimin nr.\*\*\*, datë 24.10.2022.

**15.15** Vëzhguesi ndërkombëtar beson se subjekti i rivlerësimit ka bërë një gabim serioz në gjykimin e çështjes dhe se trupi gjykues i Komisionit duhet të nxjerrë përfundimet dhe pasojat sipas rastit në procesin e rivlerësimit të subjektit, siç do të parashtrihen në këtë dokument.

### **Përmbajtja e mendimit**

**15.16** Sipas nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile, me titull “Vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake”, pika 2(ç), gjyqtari gjatë veprimeve paraprake mund të vendosë për marrjen e masave për sigurimin e padisë në raste të veçanta ose të ngutshme sipas nenit 205 të Kodit të Procedurës Civile.

**15.17** Lidhur me vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit:

- Subjekti i rivlerësimit në vendimin e tij shprehet se në përputhje me nenin 60 të Kodit të Procedurës Civile, *“[...] gjykata mund të marrë masa vetëm për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin”*, por nëse lexohet i plotë gjithë neni 60 parashikon se: *“Kur një institucion shtetëror pretendon se mosmarrëveshja që ka pranuar gjykata për një shqyrtim hyn në juridiksionin administrativ, mosmarrëveshja zgjidhet nga Gjykata e Lartë me kërkesën e institucionit shtetëror ose të prokurorit.*

*Gjykimi i filluar pezullohet derisa të jepet vendimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes për juridiksionin. Gjykata mund të marrë vetëm masa për sigurimin e padisë dhe të kryejë veprime procedurale që nuk presin”*.

- Subjekti i rivlerësimit arsyeton se për shkak të urgjencës së kërkesës lind nevoja për sigurimin e padisë, por nuk specifikohet asnjë arsyetim as për të përshkruar “urgjencën” në fjalë.
- Subjekti i rivlerësimit në vendim relacion se kërkesa për sigurimin e padisë është e bazuar në prova dhe nuk është shkaktuar asnjë dëm ndaj \*\*\*, sepse, pas gjykimit në themel të çështjes, nëse pretendimet e ngritura nga paditësi do të rezultojnë të pabazuara, atëherë \*\*\* mund të përfitonte nga dëmshpërblimi financiar i paditësit për përdorimin aktual e të mëparshëm të truallit.
- Neni 202 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se lejohet sigurimi i padisë: i) *kur padia mbështetet në prova shkresore dhe ii) kur paditësi jep garanci në masën dhe llojin e përcaktuar nga gjykata për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit.*

Subjekti i rivlerësimit nuk shtjellon mbi provat e paraqitura nga paditësi në mbështetje të vendimit dhe nuk ka një garanci të tillë nga paditësi, siç kërkohet nga ligji, të shtjelluar në vendim<sup>65</sup>.

- Subjekti e ka marrë vendimin në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve. Duhet theksuar se gjyqtari mund ta marrë këtë vendim sipas nenit 205 të Kodit të Procedurës Civile *vetëm në raste të veçanta ose të ngutshme*. Nuk ka asnjë arsytim në vendim se pse kjo çështje është e veçantë dhe e ngutshme për t'u gjykuar pa praninë e palëve dhe në dhomën e këshillimit.

**15.18** Duhet theksuar se me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.4.2023, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e ka prishur vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit Vladimir Skënderi, duke parashtruar disa mangësi në gjykimin e çështjes (një kopje e këtij vendimi i është vënë në dispozicion Komisionit dhe është pjesë e gjetjes). Më konkretisht, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm shprehet se: “[...] vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është plotësisht i pavlefshëm, pasi është shkelur parimi i paanshmërisë, kërkesa për ndryshimin e objektit të kërkesës për sigurimin e padisë është e pavlefshme dhe mungon procesverbali i seancës në dhomë këshillimi, si dhe dokumentet që ndikojnë në marrjen e një vendimi, duke rezultuar në shkeljen e procesit të rregullt ligjor dhe të së drejtës për “barazinë ndërmjet palëve në gjykim”/“mbrojtjes efektive” dhe të parimit të kontradiktoritetit”. Për rrjedhojë, vendimi duhet të priset [...]”.

**15.19** Një listë e shkeljeve të ligjit material dhe procedural, të cilat vëzhguesi ndërkombëtar i konsideron si të përmasave të atilla që do justifikonin shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për mospërmbushjen e standardeve minimale për t'u konsideruar si të kënaqshme në vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale, janë të cituara nga Gjykata e Apelit.

**15.20** Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Komisioni arriti në konkluzionin se, duke pasur parasysh standardet ligjore ekzistuese, subjekti i rivlerësimit ka bërë gabime serioze në gjykimin e një çështjeje ku në fakt ai duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi.

**15.21** Lidhur me gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të paraqitur pranë Komisionit në përputhje në nenin 49, pika 10, e ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të paraqiste shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e gjetjeve të mësipërme, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit për këtë çështje**

**15.22** Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: “Pranë Gjykatës janë gjykuar çështje civile ku paditës ose i paditur ka qenë një nga gjyqtarët e kësaj gjykate apo bashkëshortët/fëmijët e tyre dhe kjo ka qenë një praktikë<sup>66</sup> normale e jo e kundërligjshme. Gjyqtari O. S., i ndodhur në të njëjtat kushte, nuk hoqi dorë, por e shqyrtoi çështjen me të njëjtat palë e me të njëjtin objekt, duke dhënë vendimin e datës 3.7.2023 me paditëse Dh. B. dhe i paditur \*\*\* dhe me objekt “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv etj.” Kodi i Procedurës Civile, në nenin 72 të tij nuk parashikon heqjen dorë të gjyqtarit, kur palë paditëse ose e paditur është një gjyqtar i së njëjtës gjykatë. Vetëm nëse do të ishim para një çështjeje penale, heqja dorë e

<sup>65</sup> Ndërkohë që dihet se paditësi nuk i kishte paguar qiratë mujore sipas kontratës së qirasë që prej vitit 2012 dhe vendimi aktual është i vitit 2022. Lidhur me nenin 205, sigurimi i padisë mund të bëhet për gjithë padinë ose për pjesë të saj, nëse Gjykata e gjen këtë të bazuar në ligj dhe konform rregullave të përmendura në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile.

<sup>66</sup> Subjekti ka cituar 17 vendime civile, me palë subjekte dhe/ose familjarë të tyre, të dhëna ndër vite.

*gjqtarit do të ishte e detyrueshme, sepse Kodi i Procedurës Penale në nenin 78 të tij ka një rregullim të ndryshëm.*

*Dh. B. nuk ishte gjyqtare në datën 24.10.2022 kur unë gjyqtari V. Skënderi dhashë vendimin nr. \*\*\*, datë 24.10.2022, ku ajo ishte paditëse, pasi ajo ishte shkarkuar nga KPK-ja me vendimin nr. 370, datë 22.4.2021. Gjykata e Lartë, në vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11.2020, ndryshe nga sa ka vlerësuar Gjykata e Apelit në vendimin nr. \*\*\*, datë 19.4.2023, përcakton se vendimi për sigurimin e padisë nuk mund të priset e të kthehet për rigjykim. Konkretisht, në pikën 25 të vendimit, Gjykata e Lartë është shprehur "...vendimet e ndërmjetme... nuk mund të prishen dhe të kthehen për rigjykim, ...por për to duhet të konkludohet përfundimisht nga Gjykata e Lartë". Po kështu, Gjykata e Lartë në vendimin nr. \*\*\*, datë 8.6.2020, e cila ka konsideruar sigurimin e padisë si një kërkesë urgjente, e cila mund dhe duhet të shqyrtohet edhe nga gjykata jokompetente, ndryshe nga sa ka vlerësuar Apeli në rastin konkret. Konkretisht, në pikën 9 të atij vendimi, Gjykata e Lartë, ndër të tjera, shprehet: "...gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë masën e sigurimit të padisë për arsye që ajo lejohet nga ligji të mos shqyrtojë padinë në themel". Në vijim, me të njëjtën logjikë, në pikën 10 thuhet: "...gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë masën e sigurimit të padisë në rastet kur konkludon se nuk ka kompetencë për shqyrtimin e çështjes".*

*Vendimi i dhënë prej meje nuk është i formës së prerë. Sipas nenit 207 të Kodit të Procedurës Civile ai vendim mund të ndryshohet edhe nga vetë gjykata që e ka dhënë nëse vlerësohet se kanë ndryshuar rrethanat. Ai vendim nuk ka sjellë asnjë pasojë, sepse është prishur prej Gjykatës së Apelit dhe ndaj tij është ushtruar rekurs, i regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe printuar nga web-i i kësaj gjykate në datën 7.7.2023, me relatores M. B. Edhe sipas nenit 451/ç, ai vendim nuk është i formës së prerë.*

*Për rrjedhojë, propozimi për shkarkimin tim nga detyra, mbështetur në një vendim që nuk është i formës së prerë e që mund të ndryshohet nga Gjykata e Lartë, nuk më duket proporcional".*

### **Vlerësimi i Komisionit**

**15.23** Përveç qëndrimit sa më sipër, subjekti ka kërkuar edhe pezullimin e procesit të Vetting-ut derisa të përfundojë procesi i gjykimit në Gjykatën e Lartë, ku Komisioni me vendim<sup>67</sup> të ndërmjetëm ka refuzuar këtë kërkesë të subjektit.

**15.24** Argumentet që sjell subjekti i rivlerësimit nuk kanë lidhje me thelbin e çështjes dhe gjetjen e konstatuar. Në këtë aspekt, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të paraqiste dorëheqje nga çështja ku palë në gjykim ishte ish-kolegia gjyqtare për vite me radhë (pasi subjekti ka gjykuar dhe shumë çështje në përbërje trupe dhe me kolegen DH. B.). Kjo bazuar edhe në praktikën e ndjekur nga kolegët e tij, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit dhe për të garantuar paanshmërinë në gjykim, proporcionalitetin dhe seriozitetin e një gjyqtari përballë palëve pjesëmarrëse në gjykim.

**15.25** Vendimet gjyqësore të sjella si provë nga subjekti, ku palë në gjykim kanë qenë subjekte ose familjarë të tyre, me argumentimin se kjo ka qenë një praktikë normale dhe jo e kundërligjshme, nuk konsiderohet bindës nga Komisioni. Kjo dhe për faktin se çështjet gjithmonë meritojnë trajtim të veçantë dhe individual, sigurisht duke respektuar standardet e gjithëpranuara ligjore.

---

<sup>67</sup> Nr. 3, datë 12.7.2023, i trupit gjykues të Komisionit.



**15.26** Në aspektin procedural, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegonte arsyet që kanë çuar në shkeljet e evidentuara më sipër në vendimin e subjektit, sipas dokumentit “Përmbajtja e mendimit”.

**15.27** Sa më sipër, Komisioni doli në përfundimin se subjekti ka treguar aftësi të dobëta profesionale, organizative dhe etike në punë, referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, duke u ndodhur kështu edhe në situatën e konfliktit të interesit.

## **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES**

**16.** Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësim tërësor të procedurave arrin në përfundimin se:

### **Për vlerësimin e pasurisë**

**17.** Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, çmon se faktet në lidhje me kriterin e pasurisë të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe mjaftueshëm pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre për arsyet e përmendura në këtë vendim në kriterin “Vlerësimi i pasurisë”.

**17.1** Rezultoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare lidhur me pasuritë, duke mos u gjendur në kushtet e shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare për krijimin e pasurive, për të përballuar me burime të ligjshme financiare kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve ndër vite, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**17.2** Në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, për kriterin e vlerësimit të pasurisë vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**17.3** Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **Për vlerësimin e figurës**

**18.** Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **Për vlerësimin e aftësive profesionale**

**19.** Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Janë konstatuar disa mangësi procedurale dhe ligjore të subjektit të rivlerësimit për çështje të ndjekura dhe trajtuara më sipër në këtë vendim, si dhe një rast për gjykim të çështjes në kushtet e konfliktit të interesit. Këto gjetje trupi gjykues

i ka mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor për subjektin e rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi.

**20.** Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues çmon se mangësitë e evidentuara përgjatë procesit të lidhura me faktet konstatuese janë si vijon:

- a) Subjekti ka përdorur disa vite automjete të paregjistruara dhe me targa dhe dokumentacione të rreme dhe nuk ka paguar as detyrimet vjetore financiare pranë institucioneve shtetërore dhe, edhe pse është vënë në dijeni, nuk ka vepruar për t'i adresuar.
- b) Subjekti ka bërë veprim fiktiv duke deklaruar kontratën nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 26.12.2001, si kontratë dhurimi dhe jo kontratë shitjeje siç e deklaroi dhe vetë.
- c) Mangësitë profesionale të trajtuara më sipër edhe me burim mediatik, sipas gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar.
- ç) Gjykimi i një çështjeje në kushtet e konfliktit të interesit, në raport edhe me konstatimet e kriterit të pasurisë, çmohen nga trupi gjykues se duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pikat 5 dhe 4 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe se subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nga vlerësimi tërësor, bazuar në gjetjet në kriterin e pasurisë dhe atë profesional, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimi gjendet edhe në kushtet e përcaktuara nga pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi me veprimet e tij ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

### **Për këto arsye,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, referuar shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Vladimir Skënderi, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 24.7.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
Kryesuese

**Roland ILIA**  
Relator

**Pamela QIRKO**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Amela Idrizi*